

AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS

FAKULTETI I STUDIMEVE ISLAME

TERMINOLOGJIA ISLAME



PRISHTINË
2006

KOSOVA ACADEMY OF SCIENCES AND ARTS

FACULTY OF ISLAMIC STUDIES

ISLAMIC TERMINOLOGY

(Scientific round table - Prishtina, November 10th, 2005)

ORGANIZING COUNCIL

Ekrem Murtezai, president
Idriz Ajeti, member
Jashar Rexhepagiq, member
Pajazit Nushi, member
Qemajl Morina, secretary



PRISHTINA
2006

AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS
FAKULTETI I STUDIMEVE ISLAME

TERMINOLOGJIA ISLAME

(Tryezë shkencore - Prishtinë, 10 nëntor, 2005)

KËSHILLI ORGANIZUES

Ekrem Murtezai, kryetar
Idriz Ajeti, anëtar
Jashar Rexhepagiq, anëtar
Pajazit Nushi, antëtar
Qemajl Morina, sekretar



PRISHTINË
2006

P Ë R M B A J T J A

Ekrem MURTEZAI

FJALA E HAPJES7

Jashar REXHEPAGIQ

SI ËSHTË PARAQITUR TERMINOLOGJIA ISLAME NË NJË NGA
VEPRAT MË TË REJA DHE MË TË RËNDËSISHME NË GJUHËN
KROATE.....11

Pajazit NUSHI

TERMI “SHPIRT” DHE DERIVATET KONCEPTUALE E GJUHËSORE
TË TIJ NË PSIKOLOGJINË E FESË ISLAME.....27

Feti MEHDIU

PËR NJË TERMINOLOGJI ISLAME STABILE NË GJUHËN SHQIPE.....39

Ramiz ZEKAJ

TERMINOLOGJIA ISLAME NË FJALORËT E GJUHËS SHQIPE51

Qazim QAZIMI

STANDARDIZIMI I TERMINOLOGJISË ISLAME,
ÇËSHTJE QË KËRKON ZGJIDHJE57

Nexhat IBRAHIMI

ZHVILLIMI I TERMINOLOGJISË FILOZOFIKE ISLAME NË MESJETË65

Mehdi POLISI

LESIKU ISLAM PJESE PËRBËRËSE E LEKSIKUT TË SHQIPES81

Qemajl MORINA

PËRPJEKJE PËR UNIFIKIMIN E TERMINOLOGJISË ISLAME NË
GJUHËN SHQIPE91

Abdullah HAMITI

TERMINOLOGJIA ISLAME BEGATI KULTURORE97

Shefkije ISLAMAJ

KULTURA GJUHËSORE DHE SHKRIMET FETARE ISLAME.....103

Isa BAJÇINCA

PROBLEME TË TERMINOLOGJISË FETARE DHE TË KULTURËS
SË GJUHËS115

Ismail BARDHI

TERMINOLOGJIA TEOLOGJIKE SI PROBLEM119

Metin IZETI

RËNDËSIA E KRIJIMIT TË TERMINOLOGJISË ISLAME
NË GJUHËN SHQIPE129

Elez ISMAILI

TERMINOLOGJIA ISLAME ËSHTË NGULITUR THELLË
NË QENIEN E POPULLIT TONË.....141

Akademik Ekrem MURTEZAI

FJALA E HAPJES

Të nderuar kolegë,

Më lejoni që n'emër të Akademisë së Shkencave e të Arteve të Kosovës, në përgjithësi, dhe të Seksionit të saj të Shkencave Shoqërore, në veçanti, të ju dëshiroj mirëseardhje, të ju përshëndes miqësisht dhe të ju falenderoj që iu përgjigjet ftesës sonë për të marrë pjesë në Tryezën shkencore, e cila, siç është bërë e ditur më kohë, ka për qëllim dhe temë kryesore çështjen e terminologjisë islame. Në mënyrë të veçantë i përshëndes kolegët tonë, njohësit e mirë të kësaj problematike, që në këtë pjesë të vitit, i cili tanimë ka zënë të perëndojë, pjesë kjo e cila sivjet është e ngjeshur me aktivitete të shumta e nga më të ndryshme politike, kulturore, shkencore etj. gjetën kohë të udhëtojnë dhe të përgatiten për të marrë pjesë në këtë tubim të vogël për kah numri i pjesëmarrësve dhe të shkurtur për kah kohëzgjatja, por ma thotë mendja të rëndësishëm për kah tema dhe për kah mundësia e dhënies së kontributit në ndriçimin e çështjes në shqyrtim. Ideja dhe nisjativa lidhur me këtë tryezë dhe me këtë temë shqyrtimi ka rrjedhur nga Fakulteti i Studimeve Islame në Prishtinë, përkatësisht nga Kryesia e Bashkësisë Islame e Kosovës, kurse është përqafuar nga Kryetari i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës zoti Rexhep Ismajli dhe Seksioni i Shkencave Shoqërore të kësaj akademie.

Për ç'arsye pikërisht "*terminologjia islame*"? Arsytet janë të shumta dhe nga më të ndryshmet. Mirëpo, me këtë rast, unë do të thoja se të gjitha ato mund të ndahen, me kusht dhe në mënyrë mjaft joprecize, në arsye të përgjithshme dhe në të veçanta. Në arsye të para, arsye të përgjithshme, përse temë shqyrtimi të kësaj tryeze shkencor e kemi veçuar terminologjinë

islame, bën pjesë fakti se, ndryshe nga shkencat natyrore, shkencat teknike dhe disa shkenca shoqërore, në shkencat shpirtërore, shkencat spirituale (gjer. *Geistwissenschaften*), çfarë janë filozofia, teologjia, shkencat për fenë, kulturologjia, pedagogjia, etika etj. sot mbizotëron një trend semantik, gjuhësor, brendapërbrenda të cilit vend të veçantë dhe, për më tepër, vend me rëndësi të dorës së parë, zën pikërisht terminologjia çoftë si disiplinë shkencore për thelbin, natyrën, strukturën dhe topikën e termave, çoftë si një përvojë e caktuar, por prore e ndryshme dhe e llojllojshme, e përdorimit të termave. Këtu kami parasysh, para se gjitha, trendin dhe atë praktikë intelektuale e shpirtërore, e cila është mbizotëruese në vendet anglosaksone e qe është emërtuar si semanticizëm, filozofi analitike, empirizëm logjik etj, në të cilën “rol qendror luan shprehja gjuhësore”, termi, përkatësisht terminologjia. Konsekvencën skajsore të këtij trendi semanticist, përkatësisht filozofiko - analitik e shprehi filozofi bashkëkohor anglez me zanafille austriake Ludvig Vitgenshtajn, i cili në veprën e tij *Tractatus logico – philosophicus*, duke bërë fjalë për gjuhën dhe, pra, për termin, fjalën, shprehjen gjuhësore” etj. përfundon se “e tërë filozofia është një kritikë e gjuhës”(Alle Philosophie ist “Sprachkritik”), se “kufinj të gjuhës do të thënë kufinj të botës sime”(Die Grenzen meiner Sprache bedeuten die Grenzen meiner Welt) dhe se “për atë që nuk mund të flitet për atë duhet heshtur”(Wovon man nicht schprehen kann, darüber muss man schweigen). Në këtë pikëpamje puna ka vajtur aq larg saqë përfaqësuesit e kësaj pikpamje semanticiste konsiderojnë se çdo mosmarreshtje, çdo keqkuptim, qoftë ai teoriko-shkencdor, qoftë shoqëro-politik rrënjët e tij i ka pikërisht në mospërdorimin e drejtë të gjuhës dhe termave. Pa marrë parasysh se ku zuri fill dhe kush e mbështet këtë pikëpamje, jashtë këtij trendi semantiko-filozofiko-analitik nuk mund të jetë dhe, ma thotë mendja, nuk duhet të jetë as islami as si fe, as si filozofi, as si kulturë, as si histori, as si moral e etikë e as si pozicionim spirtual e shpirtëror i individit apo kolektivitetit. Përpjekja për ta përsosur gjuhën, terminologjinë, leksikun dhe sintaksisin, në instancën e fundit, për ta saktësuar mënyrën e të shprehurit dhe, pra, të komunikimit është njëri ndër tiparët thelbësorë të shpirtësisë dhe kulturës së shekullit XX, shpirtësisë bashkëkohore, të atij shekulli ku ndodhi e ashtuqujtura “kthesa linguistike” (ang. *Ligustic turn*, gjer. *die linguistische Wende*).

Edhe arsyet tjera të veçanta që determinuan mbështetjen tonë organizimit të kësaj tryeze lidhur me terminologjinë islame janë të shumta.

Njera ndër këto është fakti se pikërisht tani Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Kosovës dhe Akademia e Shkencave të Shqipërisë, sikurse edhe Instituti Albanologjik në Prishtinë, Instituti i Gjuhësisë në Tiranë, Dega e gjuhës shqipe e Fakultetit Filologjik në Prishtinë, si dhe veprimtarët e shumtë të kësaj lëmie veprimtarinë e tyre e kanë fokusuar në standardizimin dhe unifikimin e gjuhës sonë shqipe dhe në këtë pikëpamje është arritur një sukses i madh dhe i rëndësishëm. Sipas mendimit tim, kurse më mban shpresa se edhe sipas mendimit të juaj, kjo punë me shumë rëndësi jo vetëm për shkencën, e kultu tonë, por edhe për kauzën kombëtare, nuk mund të bëhet si duhet pa saktësimin dhe zhvillimin e mëtejme edhe të termave nga fushat tjera të krijimtarisë dhe të jetës shpirtërore të bashkatdhetarëve tonë. Kjo vlen edhe për jetën shpirtërore e fetare të bashkatdhetarëve tonë të cilitdo konfesion qofshin ata e para se gjithash të bashkatdhetarëve tonë që i takojnë fesë islame. Këtë po e them për këto dy arsye kryesore:një, ngas kësaj feje i takojnë rreth 70% të të gjithë shqiptarëve që jetojnë në Shqipëri, rreth 98% të shqiptarëve që jetojnë në Kosovë, kurse kjo përqindje është edhe më e madhe në Maqedoni e Luginën e Preshevës dhe, ma thotë mendje, se është me shumë rëndësi që këta bashkatdhetarë tonë të kenë nocione dhe terma adekuate në gjuhën shqipe dhe kështu të begatohet gjuha shqipe dhe të ngritet niveli i të folurit të drejtë në gjuhën tonë si pjesë e rëndësishme e kulturës si të individit, ashtu edhe të komunitetit, sepse nuk ka e as nuk mund të ketë as vetëdije të drejtë, as kulturë të mirëfillt e as komunikim të drejtë e kuptimplot midis njerëzve pa një terminologji të avansuar. Kjo arsye për të marrur në shqyrtim shkencor çështjen e terminologjisë islame ka të bëjë, para se gjithash, me çështjen e gjuhës shqipe e jo me çështjet doktrinare. Kjo çështje duhet të jetë dhe është me rëndësi si për të gjithë shqiptarët, qofshin ata myslimanë, katolikë apo ortodoksë. Këtu dua ta të përfitoj nga rasti dhe të ju lus të gjithë juve që duke bërë fjalë për terminologjinë islame të përpiqemi sa është e mundur të mos lëshohemi në çështje doktrinare, sepse, një do të “rrëshitshim” nga tema dhe, dy, do të humbim më shumë kohë aq të nevojshme për shqyrtimin e temes-bosht. Jam i vetëdijshëm se një gjë e këtillë është vështirë të bëhet, sepse termi kurrë nuk është dhe nuk mund të jetë vetëm një tërësi tingujsh pa kurrfarë domethënie e kuptimi, nuk është dhe nuk mund të jetë një formë e kulluar metafizike pa një përmbajtje të caktuar. Termi prore është një fjalë e caktuar fjalë, me të cilën shprehet një mendim, ide, domethënie, kuptim brendapërbrenda një fushe të caktuar, një fjalë apo

një shprehje, një “gurë kufitar” (çfarë është edhe domethënia burimore e fjalës latine “*terminus*”) që shenjon një gjësend të caktuar, i cili dallon nga gjësendi tjetër. Megjithëkëtë, shpresoj se do t’i përmbahemi titullit dhe do të përqëndrohemi në çështjen e terminologjisë islame. Përveç kësaj, çështja e terminologjisë islame, sikurse çështja e terminologjisë katolike, asaj ortodokse etj. është me rëndësi aktuale, ngase, pas shembjes të sistemit të “realsocializmit” dhe me krijimin e kushteve tjera shoqërore, me sigurimin e lirisë së ndërgjigjes dhe, pra, të besimit ose të mosbesimit fetar, është rritur interesimi teorik e praktik për çështje të fesë, në përgjithësi dhe kjo e dhënë, ky realitet i krijuar kohëve të fundit paraqet njërin nga megatrendet e shoqërisë bashkëkohore postsocialiste e neoliberaliste, komunitariste etj. Kjo kushtëzon nevojën e saktësisë të terminologjisë fetare, në përgjithësi, kurse asaj islame në veçanti. Po them në veçanti, sepse, ndryshe nga dy fetë tjera të shqiptarëve më parë të përmendura, në fushën shkencave fetare islame dhe lidhur me këtë në fushën e gjuhës arabe, turke, persiane, kurde etj. është arritur një sukses i rëndësishëm tek kohëve të fundit. Këtu kam parasysh kuadrat e gjeneratës së mesme dhe të gjeneratës më të re, që u shkolluan nëpër qendra të mëdha universitare në lindje e përqendrim dhe që me aftësitë e tyre kanë dhënë kontribut begatimit të gjuhës së tyre amnore shqipe dhe, si rrjedhojë, edhe terminologjisë islame në gjuhën shqipe. Detyra e jonë sot dhe në të ardhmen, këtu dhe gjatë, është që këto mbërritjeje ti bëjmë edhe me të mëdha, edhe më cilësore. Nuk kam iluzion se në bazë të një tryeze shkencore njëditore, pra brendapërbrenda disa orëve mund ti zgjidhim çështjet e shumta e të ndërlikuara, të cilat në vete i ngërthen tema, të cilën do ta shqyrtojmë sot. Kjo është e pamundur. Por nëse sot ia dalim që të mbërrimet e deritashme lidhur me terminologjinë islame, të cilat i realizuan albanologët, arabistët, turkologët, përkatësisht orientalistët tonë, pastaj veprimtarët tjerë në fushën e gjuhësisë dhe të fesë çfarë jeni shumica nga ju, t’i qojmë përpara së paku për një hap të vogël, atëherë ne do të kemi arsye të mjaftueshme të jemi të kënaqur me rezultatin e kësaj tryeze. Mua më mban shpresa dhe ma thotë mendja se kjo do të ndodhë sot, këtu në Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës.

Faleminderit!

Akademik Jashar Rexhepagiq

SI ËSHTË PARAQITUR TERMINOLOGJIA ISLAME NË NJË NGA VEPRAT MË TË REJA DHE MË TË RËNDËSISHME NË GJUHËN KROATE

Në vitet e fundit dhe në një varg vendesh ballkanike është gjithnjë më i madh interesimi për emërtime, nocione dhe përcaktime të tjera nga fusha e filozofisë, e shkencës, e kulturës, e arsimit dhe e fesë islame. Fjala është për emërtimet dhe përmbajtjen e terminologjisë islame, që është me rëndësi edhe për përdorimin e tyre në gjuhën dhe në literaturën shqipe, në komunikim të përditshëm dhe në fusha të ndryshme të jetës e të punës. Në të vërtetë, përcaktimet e përmendura janë në funksion të terminologjisë islame shqipe. Prandaj, në radhë të parë meritojnë shqyrtim të gjithanshëm.

Ndër veprat e këtij lloji veçohet “Fjalori i madh i gjuhës kroate” (“*Veliki rječnik hrvatskoga jezika*”) i autorit Vladimir Aniq. Fjalori në 1881 faqe është botuar në Zagreb në vitin 2003. Krahës këtij “Fjalori”, si burim kryesor, do të konsultohen edhe punime të tjera në gjuhët kroate, boshnjake, shqipe dhe serbe, veçmas fjalori i “Nocioneve të Islamit” (“*Pojmovnik islama*”) nga Rade Bozhoviq dhe Vojislav Simiq, vepër kjo e botuar në Beograd në vitin 2003 në gjuhën serbokroate.

Vladimir Aniq është gjuhëtar kroat dhe leksikograf i njohur, i cili, sa ishte gjallë, me dekada është marrë me shqyrtimin dhe interpretimin e jo më pak se 70.000 zërave. Më konkretisht, ky fjalor më i madh bashkëkohor i gjuhës kroate, botimi i tij i katërt më i vëllimshëm përmban 70.576 fjalë themelore dhe 125.000 derivate. Fjalori i Aniqit është vepër kapitale e botuar nga Enti Leksikografik i Zagrebit. Gjatë vitit të kaluar dhe në këtë vit ka hyrë në radhën e librave më të lexuar në Kroaci. Kjo është vepër jetësore e autorit dhe sintezë e punës së tij të tërësishme leksikografike. Autori është

marrë me kujdes e dijeni me tërësinë e emërtimeve, fjalëve dhe shprehjeve, me krijimin e nocioneve dhe domethëniet e relacionet e tyre.

Aniq, nga domeni i shkencës islame, ka zgjedhur dhe ka shpjeguar shkurtimisht këto terma:

1. **abdest (abdes, avdes)**, pers., larje rituale sipas dispozitave të Islamit para faljes, me larjen e fytyrës, duarve deri në bërryla dhe këmbëve deri te nyjat, shpëlarjen e gojës e të hundës, prekjen me dorë të lagur të qafës, të veshëve dhe të tepes së kokës. (V. Aniq, **Veliki rječnik hrvatskoga jezika**, Zagreb, 2003, 1).

Fjala vjen nga persishtja: abdest (ab=ujë, dest=dorë). Në literaturën shqipe është në përdorim nocioni **avdes**. Për shembull: **Merrnin avdes**.

2) **adet**, arabisht, zakon nga jeta popullore; shprehi, doke, zakon, e drejta zakonore. (Po aty, 3).

Mungon vetëm se adet njëkohësisht do të thotë traditë dhe se fjala ka ardhur te ne nga turqishtja. Në gjuhën dhe në literaturën shqipe fjala adet zakonisht interpretohet me fjalët: **zakon, doke, ves**. Për shembull: **Sipas adetit**.

3. **aga** (turq.), pronar i tokës së punueshme në Perandorinë Osmane, emërtim i oficerit në ushtrinë e rregullt osmane, bujar i rangut më të ulët, feudal. (Po aty, 5).

Është i domosdoshëm plotësimi se ky është pronar i madh, feudal, i parë në fshat e qytet (shiko: A. Shkaliq, **Turcizmi u sprskohrvatskom jeziku**, Sarajevo, 1985, fq. 72). Në shqip “aga” është “pronar tokash më i vogël se beu” (**Fjalor i shqipes së sotme**, Tiranë, 1984, 6).

4. **ahiret** (arabisht), bota tjetër, ajo botë. Ndahet në xhehnet dhe xhehenem.

Në të vërtetë, kjo është jeta pas vdekjes. Në literaturën shqipe dhe fetare ahireti interpretohet si **bota tjetër pas vdekjes**. (**Fjalor serbokroatisht-shqip**, Prishtinë, 1974, 969).

5. **Allah** (arabisht), tek Aniq: i vetmi perëndi, krijuesi i botës, i amshueshëm, i padukshëm, i gjithëpranishëm, i gjithëfuqishëm dhe i gjithëdijshtëm. Këtu ka munguar etimologjia e fjalës arabe “Allah” që do të thotë “zot, perëndi”, megjithëse një, i vetmi” është epiteti më i rëndësishëm. Ka munguar edhe sqarimi, sipas shpalljes kur’anore (shiko suren *Ikra*) se “Allahu është ai që njeriut ia mëson atë që nuk e di”. Nuk është shënuar as e

dhëna e rëndësishme se Allahu ka qenë hyjni edhe në periudhën paraislamike dhe se në traditën fetare popullore janë ndërtuar 99 epitete të emrit të Allahut, që përmenden në Kur'an. Për më shumë të dhëna për zotin shiko fq. 96-97. Është posaçërisht me rëndësi që autori thekson se Zoti është “krijues i botës së gjithmbarshme materiale e shpirtërore dhe zot i natyrës”. (Po aty, 96). Në gjuhën shqipe dhe në besimin e myslimanëve Allahu është **Zoti**, përkatësisht **emri i Zotit** në arabisht.

Në “Fjalorin” e Aniqit janë shpjeguar edhe shumë terma albanologjike, si **Albanac-anka, Albanija, albanizacija, albanizirati, albanolog, albanologija, albanologijski. albanoloshki, albanski, Arbanas, Arbanka, Arbanasi, arbanaski, arbanashki, Arbanija, Arnaut –tkninja, Shiptar (Shqiptar)** e të tjerë, çka gjithashtu tregon rëndësinë e shumanshme të kësaj vepre. Ky “Fjalor” mund të shërbejë edhe si shembull joekskluziviteti. Këtë do ta dëshmojmë qoftë edhe vetëm me një shembull. Kështu, për shembull, fjala **ballist** (në fq. 54) është shpjeguar me këto fjalë: “1. pjesëtar i aradheve paraushtarake të nacionalistëve shqiptarë në Kosovë dhe në Shqipëri në Luftën e Dytë Botërore; 2, aderues i lëvizjes Balli Kombëtar (që përfaqësonte idenë e shkëputjes së Kosovës dhe të bashkimit të saj me Shqipërinë)”.

6. **Beg** (turqisht), titull bujari në Perandorinë Osmane; zyrtar i lartë ushtarak ose civil; zotëri, sundimtar, njeri prestigjioz. Shtohet pas emrit personal, për shembull, Mustaj-beg, (Po aty, 66).

Duhet theksuar posaçërisht se ky titull nuk është përdorur vetëm në periudhën e Perandorisë Osmane, por edhe më vonë (p.sh. në Bosnjë: Safvet-beg; në Kosovë: Nexhib-bej; në Plavë: Shaban-beg etj.).

Edhe një plotësim i zërit “beg” do të ishte: “bujar”, që e plotëson shpjegimin e termit. Në gjuhën shqipe titulli “beg” përdoret më tepër si **bej, bejlerë** dhe ka të njëjtin kuptim.

7. **Bajram** (turqisht), ditë e madhe islame, festë fetare myslimane. Autori dallon Kurban Bajramin ose Bajramin e Haxhit, i cili fillon 70 ditë pas Bajramit të Ramazanit dhe zgjat katër ditë, nga Bajrami i Ramazanit, i cili fillon ditën e parë pas agjërimit të Ramazanit dhe zgjat tri ditë. (Po aty, 51). Kurban-Bajrami quhet kështu për arsye se për këtë bajram (festë) theren kurbanet (gjedhe ose dele), e quhet edhe i Haxhit për arsye se gjatë atyre ditëve bëhet pelegrinazhi vjetor kryesor i haxhilarëve rreth Qabes në Mekë.

Duhet theksuar se ky është emërtim me prejardhje turke dhe do të

thotë “festë fetare, festë në përgjithësi, kremtim, gëzim”. Në gjuhën shqipe të dyja këto festa të bajramit quhen edhe: **Bajrami i Madh** dhe **Bajrami i Vogël**. (Sipas Pasho Baku: **Fjalor enciklopedik**, Tiranë, 2002. 64).

8. **Berat** (arabisht), dekret i sulltanit, me të cilin ndahen titujt, dekoratat, privilegjet; dekret, kartë, leje (Po aty, 68).

Nuk duhet harruar se dekretet e veçanta të sulltanit – **fermanët** rregullonin çështje të rëndësishme në Perandorinë Osmane. Këtë urdhëresë perandorake duhej ta respektonte secili. Prej andej ka dalë në boshnjakishte folja “fermati” – respektoj, nderoj. Vetë fjala “ferman:” është me prejardhje orientale (persiane). (Sipas librit: **Da li znate? -/A e dini?/,** Beograd, 2004, fq. 50).

Në gjuhën dhe në literaturën shqipe janë në përdorim fjalë: **berat, dekret diplomë (turke)**.

9. **Qaba** (arabisht), pelegrinazh ose shenjtërore në përgjithësi; vend i shenjtë në Mekë ku shkohet në haxhillëk. (Po aty, 179).

Është dashur të shtohet se Qaba është godinë e shenjtë islame, tempull në qytetin e Mekës në Arabi. Për çdo vit, myslimanët nga të gjitha viset e botës, për Bajram të Haxhit (Bajram të Vogël) vijnë në Mekë dhe e vizitojnë Qaben. Gjithashtu nuk mund të mos përfillet e dhëna se është detyrë fetare që secili mysliman, një herë në jetë, ta vizitojë këtë tempull. (Për këtë më shumë shiko: A. Shkaliq, **Turcizmi...**, në fq. 182), natyrisht nëse gjendja ekonomike ia lejon këtë. Do ta shtonim edhe faktin se në shenjtëroren e sotme islame, gurin e zi të quajtur Qabe në Mekë, edhe në kohën paraislamike janë mbledhur arabët paganë (Sipas: Rade Bozhoviq – Vojislav Simiq: **Pojmovnik islama**, Beograd, 2003, fq. 121).

Në literaturën shqipe gjejmë emërtimet: Qabe (Kaaba).

10. **Qitab (kitab)**, arabisht, libër në përgjithësi, libër që përmban mësim dhe rregulla fetare. Në rastet më të shpeshta është edhe sinonim për Kur’anin. (Po aty, 181).

Ky libër në gjuhën shqipe quhet **qitap**. Fatkeqësisht nuk është sqaruar gati në asnjë fjalor leksikologjik shqip.

11. **Dervish** (persisht), klerik lypës, pjesëtar i rendit fetar mysliman (që nga shek. 11/12). Punon me besimtarët në rituale të veçanta (vallëzim, misticizëm). (Po aty, 205).

Sqarimi nuk është i plotë. Do të ishte më e drejtë të thuhet se dervishi

është pjesëtar i rendit të caktuar të dervishëve ose tarikatit. Ky term do të thotë gjithashtu: njeri modest, i tërhequr dhe i devotshëm.

Duhet të përmendte së paku disa rende të dervishëve: halveti, sadi, bektashi, rifai, melami etj.

Do të shtonim edhe faktin se në disa vende dervishët arsimohen në institucione të veçanta, të quajtura hanikase. Në veprat në gjuhën shqipe, ka raste kur fjala “dervish” interpretohet shumë ngushtë, si “murg i sekti bektashian”. (Shiko: **Fjalor i shqipes së sotme**, Tiranë, 1984, në fq. 192).

12. **Divan** (arabisht dhe persisht), këshill, kuvend, pleqësi; këshill perandorak (mbretëror) ose i vezirëve (i ministrave); pleqësia shtetërore; oborri perandorak (mbretëror), ose oborri, shtëpia e ndonjë veziri, pashai; kuvendimi, biseda; lloji i sofës: kolltuku, seqia (sexhadja); përmbledhja ose tufa e këngëve orientale. (Po aty, 224).

Zëri është trajtuar përpikërisht edhe sipas modelit të “Turqizmeve” të A. Shkalliqit. Edhe te ne në Kosovë shumë autorë kanë shkruar divane. Më të njohura janë divanet e Sheh Malës, nga Rahoveci. Në literaturën shqipe termi shpjegohet edhe si **këshilli i sulltanit** edhe si **përmbledhjet lirike të një poeti**. (Për shembull në: **Fjalor enciklopedik**, Tiranë, 2002, 160).

13. **Xhamia** (arabisht) është faltore myslimane me minare. (Po aty, 273).

Është i saktë zëri i xhamisë, sepse faltorja pa minare është mesxhid, do të thotë vend për falje (lutje). Xhamia rrjedh nga fjala arabe “gāmi” që do të thotë “faltore”, më saktë: tempull islamik. Pranë xhamive ndërtohen edhe kuzhinat për të varfër, udhëtarë e kalimtarë (**imaretët**). Xhamitë më të mëdha kanë edhe lokalet për nxënës të teologjisë dhe për organizimin e mësim-fesë. Sipas traditës, xhaminë e parë e ka themeluar vetë Muhamedi te Medina në vitin 622. Rrjeti i xhamive është shumë më i zgjeruar në Ballkan, ndërsa në rajonin arab ka mbizotëruar emërtimi i zakonshëm mesxhid. Literatura në gjuhën shqipe ka mjaft lëndë e njoftime mbi faltoren myslimane – xhaminë.

14. **Xhehenem** (hebraisht), ferr në doktrinën islame. (Po aty, 273).

Termi është shpjeguar shkurtimisht. Ka qenë e domosdoshme që të theksohet se kjo fjalë në Kur’an është sinonim i fjalës “nar” (zjarr, flak), por e ka edhe domethënien “ferr”. Ekzistojnë kategori të ndryshme mëkatarësh dhe ata, duke hyrë nëpër dyer të ndryshme, vendosen në anë të ndryshme. (Për këtë shiko në **Pojmovnik islama**, Beograd 2003, fq. 148).

Fjala xhehenem në shqip identifikohet me fjalën **ferr** ose **skëterrë**.

15. **Xhemat** (arabisht), tubim, shoqëri, bashkësi; komunë fetare, njësi themelore e bashkësisë fetare islame; tubim i njerëzve që falen bashkërisht. –V. Aniq, **Veliki rječnik**, Zagreb, 2003, 273.

Duhet të theksohet se xhemat quhet edhe xhama. Ky, pra, është tubim, tubim i besimtarëve. Këtë domethënie e ka termi xhemat në gjuhën fetare të Islamit.

16. **Xhenet** (arabisht xhehenet), kulminacioni i mirëqenies në Islam; parajsë, qielli. (Po aty, 274).

Në arabisht xhenet quhet #•nn•, do të thotë •parajsë•, kurse domethënie thelbore e ka fjalën “bahçe”. Gjithashtu, do ta theksonim se ky emërtim është në përdorim në traditën dhe në literaturën myslimane në Kur’an.

Në gjuhën shqipe janë në përdorim fjalët: **xhenet** dhe **parajsë**. Figurativisht ky është “vend i bukur dhe i begatë”. (**Fjalor i shqipes së sotme**, fq, 854).

17. **Haxh** (arabisht), pelegrinazh në Mekë, e bën besimtari personalisht ose me anë të zëvendësit (bedelit). (Po aty 392).

Haxhi ose haxhillëku është obligim i rregullt vjetor i myslimanëve. Për shkaqe të arsyeshme (lufta, epidemitë e mëdha) haxhillëku mund të mos bëhet. Përndryshe, secili besimtar e ka për detyrë që një herë gjatë jetës të shkojë në haxhillëk. (Më hollësisht për haxhin shiko në **Pojmovnik islama**, fq. 138-139). Besimtari mysliman që shkon (ose ka qenë) për t’u falur në Mekë në gjuhën shqipe quhet **haxhi**.

18. **Ibadet** (arabisht), gjendje e përshkimit të besimtarit në frymën e Allahut gjatë lutjes; lutje. falje; mësim i besimit, i ritualit dhe i jetës shoqërore. (Po aty, 423).

Na duket më i plotë dhe më i kuptueshëm është interpretimi i A. Shkaliqit në fjalorin e tij **Turcizmi u srpskohvartkom jeziku** (Turqizmat në gjuhën serbokroate, Sarejvë, 1985), i cili, për fjalën “ibadet” në fq. 338 thotë kështu: 1. lutje Zotit, falje dhe mësim, 2. “të bësh ibadet”, t’i lutesh Zotit, të falesh e të mësosh.

19. **Islam** (arabisht), religjion monoteist i bazuar në besimin në Allahun sipas mësimi të profetit të tij Muhamedit (shek. 7), mbështetet në Kur’anin. Termi ka edhe domethënie tjetër - kjo është bota islame, tërësia e

qytetëtimeve dhe e popujve islamikë. (Po aty, 463).

Po theksoj se fjala islam tekstualisht do të thotë nënshtrim vullnetit të Zotit. Këtu zëri islam është interpretuar shumë më mirë sesa në “Turqizmat” e Shkaliqit, ku është reduktuar në “emrin e fesë myslimane”. (Shiko te Shkaliqi në fq. 350), që është interpretim shumë i ngushtë.

Ndërkaq, zëri (determinimi) më i plotë i islamit është dhënë në “Pojmovnik islama” (në fq. 62-65) ku, përveç të tjerash, është thënë se religjioni praktik (dini) përbehet prej katër, përkatësisht pesë detyrave themelore, kryesore, e këto janë: 1. që myslimani i devotshëm të bëjë pesë falje (lutje) në ditë; 2. agjërimi i obligueshëm i ramazanit; 3. dhënia e zeqatit (mëshirës fetare); 4) haxhillëku i obligueshëm në Mekë (haxhi) dhe 5. obligimi – predikimi se zoti është një. Doktrinën islame shqiptarët e quajnë më shkurt islam. Së këndejmi edhe termat: **islamik, islamizim, islamizoj** e të tjera. Me anë të islamit është bërë edhe përhapja e kulturës orientale dhe e institucioneve arsimore te popujt e ndryshëm, veçmas te shqiptarët. (Më shumë për këtë shiko në librin tonë: **Zhvillimi i arsimit dhe i shkollave të kombësisë shqiptare në territorin e Jugosllavisë së sotme deri në vitin 1918**, Prishtinë, 1968, fq. 35-36).

20. **Kur'an,-i** (arabisht), libër i shenjtë i Islamit; fjalët e Zotit të dërguara Muhamedit, të pranuar si bazë e së drejtës, e kulturës, e politikës dhe e letërsisë islame. Përmban 114 sure (kapituj) me gjithsej 6220 ajete (fjali), përkatësisht 77934 fjalë. (Po aty, 657).

Në “Fjalorin madh” të Aniqit mungon domethënia themelore e Kur'anit se ai është “recitim, mësim, ai që duhet lexuar”, faktikisht libërleximi. Derisa norma më e vjetër e këtij libri të shenjtë rrjedh nga viti 776, në shekullin IX janë përcaktuar edhe mënyra të ndryshme të leximit të Kur'anit në disa qendra, p.sh. në Medine, Mekë, Damask, Kufë e të tjera. Dhe kështu në lidhje me Kur'anin me kohë janë zhvilluar interpretime të ndryshme të këtij libri të shenjtë të myslimanëve, prej të cilave janë krijuar shumë sekte e parti. Njëkohësisht s'ka dyshim se Kur'ani “ka qenë dhe ka mbetur shembull i rrëfimit arab në prozë” dhe njëkohësisht “bazë e jetës së gjithmbarshme shpirtërore e materiale” (Sipas: **Pojmovnik islama**, fq. 77-78).

Ky libër i shenjtë edhe në gjuhën shqipe është i njohur me emrin **Kuran,-i**.

21. **Medresa** (arabisht), shkollë fetare islame në rangun e shkollës së

mesme e të lartë. (Po aty, 738).

Në mënyrë të ngjashme është thënë për medresenë edhe te Shkaliq, i cili jep këtë shpjegim: “shkollë fetare myslimane, në të cilën hyhet pas mbarimit të mejtepit ose ruzhdijes”. (A. Shkaliq, **Turcizmi...**, 451).

Në “Pojmovnik islama” (fq. 87) për medresenë thuhet se dikur ka qenë “shkollë fetare myslimane”, ndërsa sot kjo është “në rangun e shkollës sonë të mesme, në të cilën mësohen lëndë të ndryshme fetare”.

Shkurt, të gjithë autorët e përmendur medresenë e trajtojnë si shkollë fetare islame ose myslimane, duke harruar se në aty, varësisht nga rangu, mësoheshin edhe shkenca të ndryshme natyrore dhe ndonjë lëndë tjetër laike: p.sh. nga rendi i shkencave shoqërore. Edhe te ne ka pasur medrese për arsim fetar e laik, e të tilla kanë qenë Medreseja e Is-hak-Beut në Shkup, Medreseja e Gazi-Husrev-Beut në Sarajevë, Medreseja e Mehmed-Pashës në Prizren e shumë të tjera. Në Prishtinë punon Medreseja Alaudin.

22. Mekteb (mejtep), arabisht, shkollë fillore fetare. (Po aty, 742). Në mënyrë të ngjashme është shpjeguar me nga një fjali në “Turcizmi” dhe “Pojmovnik islama”.

Në **Enciklopedia Pedagogjike 2** (v. 1989), në faqen 25, zërin “mejtep” ne e kemi sqaruar kështu: “Mejtep, arabisht maktab, vend ku shkruhet – shkollë, në rastet më të shpeshta shkollë fillore myslimane ose tipi më i ulët i shkollës fillore islame. Mejtepet hapeshin në qytete e fshatra, vendoseshin në xhami ose afër tyre. Nxënësit mësonin aty lexim, shkrim (i shkronjave arabe), Kur’an, aty-këtu edhe libra të tjerë... Mësimi ishte i përshtatur me religjiozitet e dogmatizëm. Mësohej pa e kuptuar lëndën, përmendsh dhe me dënime të rrepta fizike. Mësues ishin hoxhallarët, ndërsa në mejtepet moderne – **ibtidaitë**, mësuesit me kualifikime të domosdoshme. Mejtepet janë hapur që në shekullin VII – VIII. Te ne ka pasur më shumë deri në vitin 1912, me ndërprerje deri në vitin 1918 dhe në kohën midis dy luftërave. Ekzistojnë mejtepet për djem, për vajza dhe të përziera. Në literaturë takohen edhe emërtimet: mejtef, mejtep dhe mektep.”

Në gjuhën shqipe përdoret gati ekskluzivisht emërtimi **mejtep**.

23. Merhamet (arabisht), emërtim i organizatës bamirëse islame. Merhamet do të thotë: mëshirë islame, përdëllim. (Po aty, 745).

Në mënyrë të ngjashme është shpjeguar termi edhe në “Turcizmi”, në fq. 460, por edhe në literaturën shqipe gjuhësore etj.

24. Muhamed (arabisht), i dërguari i Zotit, profet, themelues i Islamit;

mësimi i tij është shkruar në Kur'an. (Po aty, 786).

Në emërtimin arabisht: "Muhämmäd" do të thotë "i lavdëruar, i madhëruar". Më hollësisht për Muhamedin, i cili si i dërguar i Zotit e ka shpallur besimin e ri monoteist – Islamin, shiko në "Pojmovnik islama" në fq. 94-96.

Është i lindur rreth vitit 570 në qytetin Mekë. Në fëmijëri të hershme ka mbetur pa të dy prindërit dhe për të është kujdesur xhaxhai i tij Abu Talibi. Si i ri ka marrë pjesë në aktivitete fetare në Mekë. Rreth vitit 610 ka përjetuar përvoja religjioze në formë vizionesh e zërash. Gradualisht ka filluar ta pranojë rolin e vet të të dërguarit të Perëndisë. Shpalljet që ka pranuar Muhamedi, më vonë janë mbledhur në librin e shenjtë – Kur'an. (Më shumë për këtë: Milan Vukomanoviq, **Religjia**, Beograd, 2004, 29).

25. **Musliman(ka)**, (arabisht-persisht), ai që është i besimit mysliman, ithtar i Islamit. Është në përdorim edhe emërtimi i vjetër: muhamedan. Musliman është edhe emërtim për pjesëtarin e nacionalitetit mysliman në BeH, ndërsa tash për këtë përdoret emërtim boshnjak. (Po aty, 789). Në të njëjtën faqe, termi **muslimanstvo** (muslimanizëm) do të thotë "ndjenja e përkatësisë myslimanëve". Është më e drejtë dhe më precize që termi të shpjegohet me fjalët: pjesëtar i fesë islame. Mungojnë karakteristikat e tjera të zërit "musliman", si dhe faktet konkrete – se në botë janë diçka më shumë se një miliard njerëz, se te ne Islami është përhapur pas ardhjes së turqve në Ballkan, se myslimanët te ne kanë organizatën e vet fetare (Bashkësinë Fetare Islame) dhe të dhënat e tjera konkrete, p. sh. ku ka më shumë myslimanë, në cilat vende janë me numër më të madh e të tjera. Pjesëtari i fesë myslimane në gjuhën shqipe emërtohet **mysliman**, dhe feja e tij është: **feja myslimane**.

26. **Namaz** (persisht), sipas Aniqit, namazi është falje - lutje myslimane që bëhet pesë herë në ditë në kohë të caktuar me falje e shqiptim të fjalive nga Kur'ani dhe lutje në gjuhën arabe. (Po aty, 814).

Interpretimi është i saktë dhe krejtësisht sipas shembullit në "Turqizmat" e Shkaliqit në fq. 486. Në të dy burimet është dashur të shtohet se myslimanët për çdo ditë bëjnë pesë lutje: në mëngjes (sabah ose sabah namaz), në drekë, midis mesditës dhe perëndimit të diellit në gjysmën e dytë të ditës (iqindia), në perëndim të diellit (akshami) dhe në mbrëmje (rreth dy orë pas muzgut të parë – jacia). Namazi është një nga shtyllat më të rëndësishme të Islamit, e të njëjtin kuptim e ka edhe fjala arabe **salat**.

Faljen e obligueshme myslimane (**namaz-in**) e gjejmë edhe në literaturë (fetare e tjetër) në gjuhën shqipe.

27. **Oriental** (lat. orietalis), që ka të bëjë me lindjen, lindor; që ka të bëjë me Orientin, përkatësisht me Lindjen e Afërme, të Mesme dhe të Largët. I përmend shembujt e **kishave orientale**, në të vërtetë kishave të botës ortodokse, të **gjuhëve orientale** (për gjuhët e Lindjes së Afërme e të Mesme dhe gjuhët e tjera orientale) dhe **sagun oriental**.

Në lidhje me këtë term e ka shpjeguar edhe domethënien e **orientalistikës** si studim shkencor i kulturës shpirtërore e materiale të Orientit. (Po aty, 955).

Theksojmë se zërat oriental, orientalistika nuk janë trajtuar në fjalorët e Shkalliqit e të Bozhoviqit bashkë me Simiqin.

Në gjuhën shqipe gjejmë disa terma: **oriental, orient, orientalist, orientalistikë, orientalizëm** e të tjera.

28. **Pasha** (turqisht), titull i eprorëve të lartë ushtarakë e civilë në Perandorinë Osmane dhe në disa shtete të tjera; guvernator i krahinës. (Po aty, 1005),

Shpjegimi i këtij titulli është sipas shembullit të “Turqizmove” të Shkalliqit. (Shiko në fq. 511). Duhet theksuar se pashai ishte edhe këshilltar shtetëror, komandant autoritativ, kurse në kuptimin figurativ sundimtar arbitrar.

Termi është me prejardhje turke, me formën e parë: “basha”. Emërtimi gati gjithnjë vihet pas emrit (p.sh. Mustafa-pasha, Ali pashë Tepelena, Ali pashë Gucia etj.).

Në shqip: **pasha, pashallarë** dhe figurativisht: **jetoj si pasha**.

29. **Pashallëk** (turqisht), njësia më e madhe administrativo-territoriale në Perandorinë Osmane, krahina në krye të të cilës ishte pashai. (Po aty, 1006). Autori përmend shembujt e Pashallëkut të Bosnjës e të Pashallëkut të Beogradit. Do të shtonim se Bosnja është bërë pashallëk në vitin 1583, kurse selia e Pashallëkut të Beogradit ka qenë në Beograd prej vitit 1521. Në shekullin XVIII atë e drejtonte mëkëmbësi me emërtimin e pashait. Ekzistonin edhe pashallëqet e Jeni Pazarit, Leskovcit, Nishit, Vidinit (në Bullgari) e të tjerët. (Sipas librit: **Da li znate?**, Beograd, 2004, 263). Sa për shembull po përmend një njësi të tillë administrativo-territoriale: **Pashallëkun e Shkodrës**.

30. **Rumelia** (latinisht-turqisht), pjesa më e madhe e territoreve evropiane nën pushtetin osman (fundi i shekullit XIV dhe fillimi i shekullit XV) e organizuar si ejalet: më vonë ngushtohet në rajonin e Bullgarisë së sotme, pjesët e Serbisë, të Maqedonisë e të Greqisë. Domethënia tjetër ka Rumelia Lindore, përkatësisht pjesa e Bullgarisë, e cila, pas vitit 1878, ka mbetur në përbërje të Perandorisë Osmane, kurse në vitin 1885 është bashkuar me Bullgarinë. (Po aty, 1355).

Përcaktim më preciz i Rumelisë është Turqia evropiane, përkatësisht emërtimi për pjesën evropiane të Perandorisë Osmane. Deri në vitin 1541, të gjitha vendet ballkanike hynin në përbërje të Bejlerbejllëkut (pashallëkut) të Rumelisë. Termi rrjedh nga fjala turke “Rum” (grek) dhe latine “Roma”.

31. **Sabah** (arabisht), agim, mëngjesi i hershëm, Falja e parë islame e mëngjesit. (Po aty, 1360). Është dhënë edhe domethënia tjetër: Sabah – shtet autonom në ishullin Borneo. Sabah do të thotë gjithashtu mëngjes, agim. Po themi edhe një domethënie të fjalës sabah. Ky është leksioni i dhënë në mejtepe ose medrese. (Shiko: **Turcizmi...**, fq. 538). Mbase, kjo rrjedh nga fjala turke “sabak” (leksion).

Në gjuhën shqipe më shumë përdoret fjala **mëngjes**. Thuhet p. sh. **U ngrit që me sabah**.

32. **Sabur** (arabisht), durueshmëri, aftësi e zotërimit të vetvetes. Në lidhje me këtë është edhe fjala **saburim** – sundim i vetvetes, durim i vështirësive të jetës. (Po aty, 1361).

Në gjuhën shqipe shumë të afërta janë fjalët: **sabër** dhe **durim**. P. sh. **Punoj me durim**. Është e njohur edhe fjala e urtë popullore: “sabri – selamet” (durimi – shpëtim).

33. **Sheriati** (arabisht), ligj themelor fetar i myslimanëve, dispozita islamike të themeluara në shekullin VIII – IX. Thuhet edhe **e drejta sheriate** si sistem i së drejtës myslimane e dalë nga Kur’ani, p. sh. e drejta e pronës, e drejta familjare, e drejta trashëgimore, e drejta ndëshkimore e të tjera. (Po aty, 1530).

Emërtimi sheriat rrjedh nga fjala arabe: sharia, domethënia themelore e të cilës është: “ruga e drejtë”. Edhe në gjuhën shqipe është në përdorim emërtimi **shariat-i**, ndërsa në periudha të caktuara historike edhe e drejta e sheriatit ka ushtruar ndikim të padyshimtë. (Shqip: **E drejta e sheriatit**).

34. **Teqe** (arabisht), faltore, në të cilën banojnë dervishët dhe kryejnë

ritualet fetare - kuvend i dervishëve. (Po aty, 1577). Por, ky do të ishte përkufizim tepër i ngushtë nëse do të thuhej se tekia - teqeja shërben vetëm për rite fetare, sepse aty bëhen edhe biseda, aty-këtu shkruhen ose analizohen libra, artikuj dhe kryhen obligime të tjera. Është dashur të thuhet edhe se eprori i teqesë është shehu dhe se këso faltroresh edhe tani ka shumë, sidomos në Kosovë, Bosnjë, Maqedoni dhe Shqipëri. Në Kosovë dhe në Shqipëri teqe ka në Prizren, Gjakovë, Rahovec, Pejë, Mitrovicë, Berat, Elbasan, Tiranë, Krujë, Shkodër e të tjera.

Në gjuhën shqipe tekia quhet **teqe, teqeja**.

Turcizëm, njësi e marrë nga osmanishtja (p.sh. “bakar”, “çarapa”, “sheqer” etj.). Domethënia e dytë e turqizmit është se njësia nga arabishtja, persishtja ose ndonjë gjuhë tjetër është marrë me ndërmjetësimin e osmanishtes në kohën e rishtresimit të kulturës turke, sllave, shqiptare e të kulturave dhe të qytetërimeve të tjera. (Po aty, 1636).

Është e drejtë që ky term si dhe domethënia e tij kanë hyrë në këtë Fjalor.

Është e nevojshme të thuhet edhe se në gjuhën shqipe, boshnjakishte e gjuhë të tjera fqinje, në radhë të parë në të folurin popullor, janë me mijëra fjalë që rrjedhin më së shumti nga arabishtja, mandej nga persishtja dhe turqishtja. Këto emërtime orientale janë të njohura si “turqizma”. Ky term (turqizëm) ka zënë vend te ne me ndërmjetësimin e turqve dhe kjo është arsyeja themelore që edhe sot e kësaj dite është mjaft i pranishëm edhe në literaturë (p.sh. titulli i fjalorit të A. Shkaliqit: **Turcizmi u sprskohrvatskom jeziku**).

Kur është fjala për përdorimin praktik të termave-nocioneve orientale te ne, sot, është qëndrim shkencor adekuat se disa fjalë kanë “depërtuar thellë” në gjuhën shqipe dhe gjuhë të tjera të këtushme, disa janë në zhdukje e sipër, ndërsa disa janë zhdukur fare. (Për më shumë te: Mehmet Beqovi, **O nekim orijentalnim nazivima u Novom Pazaru**, Novopazarski zbornik, 13/1989, 203-210).

36. **Vilajet** (arabisht), njësia më e madhe administrative në Perandorinë Osmane, krahinë, qark; në kuptimin pezhorativ: mjedis i prapambetur, p.sh. “tamni vilajet” (botë e errësirës dhe e territ shekullor). (Po aty, 1733).

Këtu janë të domosdoshme plotësime të caktuara: së pari se ky është territor i një valiu, së dyti se vilajet do të thotë atdhe, vendlindje. (A.

Shkallë, Turcizmi..., 641) dhe së treti, se kjo ndarje e madhe administrativo-territoriale në vilajete faktikisht është në fuqi edhe sot në Turqi. (Sipas Pasho Baku: **Fjalor enciklopedik**, Tiranë, 2002. 733).

Në hapësirat e Turqisë evropiane janë të njohura vilajetet e Edrenesë, Selanikut, Kosovës, Shkodrës, Manastirit dhe Janinës. Në Turqi vilajetet ekzistojnë prej vitit 1866.

37. **Zahir** (arabisht), ithtar i shkollës islame (shekulli IX deri XIV) e cila kërkonte interpretim tekstual të Kur'anit dhe të Hadisit si burime të vetme të mësimit islam (Po aty, 1783).

Termi i cituar islamik është shënuar dhe sqaruar shkurtimisht vetëm në këtë Fjalor. Fjala “zahir” në arabishte do të thotë “i qartë”, “i dukshëm”.

38. **Zeman** (arabisht), epokë, kohë në relacion të gjatë, vakt, stinë. (Po aty, 1832).

Fjala “zeman” shpeshherë shpjegohet me fjalën – kohë, -a. Përfundimisht, te Vujaklia (**Leksikon stranih reči i izraza**, Beograd 1954) në faqen 323 termi është shpjeguar si kohë, shekull, qindvjetësh, madje edhe vdekje, shuarje e jetës.

Edhe në literaturën shqiptare fjala “zeman” interpretohet si kohë, periudhë, epokë, e diku do të thotë edhe shekull.

Pas këtyre zërave më të rëndësishme për terminologjinë e përgjithshme dhe islamike, në Fjalorin e Aniqit gjejmë edhe terma të cilat i trajton gjithashtu nga pikëpamja e shkencave orientaliste dhe islamiste. Kështu p.sh. në lidhje me termin **objava** (në fq. 896) autori thekson se ky është “njoftim publik për diçka, shpallje e drejtuar opinionit” e njëkohësisht “akt i besimit në shumë religjione”. Si shembull e merr besimin islam në Kur'an.

Më faqen 902, në lidhje me zërin **obred**, jep shembujt e riteve romokatolike, grekokatolike, ortodokse, adventiste dhe të riteve të tjera, e gjithashtu edhe të riteve islame.

Në faqen 1792, në lidhje me fjalën **vera**, tregon institucionet e jetës fetare në formë të organizuar, si fenë katolike, ortodokse, myslimane e të tjera.

Është e mundur që në Fjalor të gjendet edhe ndonjë e dhënë, që tregon me çfarë serioziteti dhe gjithanshmërie autori i ka studiuar zërat e shumtë.

Në veprën e tij gjejmë dhe shumë nocione, terma e zëra, p.sh. nga jeta

e mjedisëve të tjera dhe të popujve të tjerë. Kështu ai, në fq. 1461, përpos fjalëve **Srbija, Srbin**, shpjegon shkurtimisht termat: **Srbadija** (të gjithë serbët, serbizmi), **srbenda** (ai që në serbizmin e vet është agresiv), **Srbijanac** (serb nga Serbia), **srbijanski** (që ka të bëjë me Serbinë dhe serbët), **srbizacija** (akt i serbizimit, serbizimi, serbizimi i pjesëtarëve të popujve të tjerë), **srbizam** (element i njohshëm i gjuhës serbe i marrë në ndonjë gjuhë tjetër), **srbizirati** (zbatimi i serbizimit, të bërit që diçka të jetë serbe, që të marrë karakteristikën e serbizimit etj.), **srbovati** (shprehje imponuese e ndjenjave nacionale serbe). Analiza të ngjashme ka dhënë edhe për vende e kombe të tjera, p.sh. për kroatët, si janë: **hrvaština, Hrvatina, hrvatovati, hrvatskije, hrvatstvo** etj. (Shiko faqen 418).

Rezyme

Si qëndrim dhe rezultat i përgjithshëm dhe më i rëndësishëm teorik në Fjalorin e madh të gjuhës kroate ("**Veliki rječnik hrvatskoga jezika**"), e gjithashtu edhe në literaturën tjetër të cituar këtu, mund të thuhet se është trajtuar një numër bukur i madh termash, nocionesh dhe emërtimeve nga fusha e doktrinës islame dhe e terminologjisë islame.

Rezultati i dytë është se termat e trajtuara dhe zërat e tjerë janë parashtruar në esencë mirë dhe shkencërisht drejt.

Ndër zërat nga gjuhët, kulturat dhe literatura orientale më shumë ka nga ato në gjuhën arabe. Shkaqe janë se termat e përmendura rrjedhin nga gjuha arabe, kurse te ne kanë ardhur nëpërmjet literaturës, imamëve dhe shehlerëve të arsimuar të disa rendeve të dervishëve dhe, në pjesën më të madhe, nëpërmjet gjuhës turke dhe veprave letrare në këtë gjuhë.

Duke ndarë termat e nocionet kryesore edhe themelore si dhe fjalët e tjera nga islamistika dhe gjuhët orientale, me të cilat autori (V. Aniq) në "Fjalorin e madh" është marrë në esencë me ndërgjegje dhe vetëmohim, duke i trajtuar shkencërisht dhe në pika qenësore, na duhet të vërejmë se as në këtë vepër, përndryshe të shkëlqyeshme, nuk janë ndriçuar shumë zëra terminologjikë, para së gjithash, nga filozofia islame, sidomos nga Tesavufi, gjithashtu termat dhe nocionet nga etika islame, nga pedagogjia islame dhe disiplinat e tjera shkencore islame. Zbrazëti e madhe në "Fjalor" është edhe fakti që ka munguar shpjegimi më i përafërt i disa disiplinave fetare islame dhe i përmbajtjeve të tyre. Kështu, p.sh., për hadisin, ahlakun, kiraetin dhe mësimet e tjera fetare islame nuk është thënë asnjë fjalë, ndërsa zërat e tjerë,

jashtëzakonisht të rëndësishëm (islami, islamistika, kultura orientale, Kur'ani, myslimani) ose kanë munguar fare ose janë trajtuar në mënyrë të sipërfaqshme.

Disa plotësime konkrete të disa termave mund të shërbejnë edhe si ndihmë për përgatitjen dhe eventualisht për publikimin e botimit të ri.

Është shumë kompleks procesi i krijimit të terminologjisë për cilëndo fushë, e veçmas për fushën shkencore, kulturore e fetare islame, sepse në këtë fushë duhet të studiohen në mënyrë shumëdimensionale nocione dhe terma të shumta, mënyra e krijimit të tyre, marrëdhëniet dhe lidhjet, definicioni dhe përdorimi i tyre në literaturë, në gjuhën letrare, e gjithashtu edhe në relacionet praktike dhe në fushat e tjera të jetës.

(Përktheu: Vehap Shita)

Dr. Pajazit NUSHI

TERMI “SHPIRT” DHE DERIVATET KONCEPTUALE E GJUHËSORE TË TIJ NË PSIKOLOGJINË E FESË ISLAME

Hyrje

Psikologjia përgjithësisht, sidomos psikologjia e religjionit, veçanërisht psikologjia e fesë islame ka filluar të zhvillohet vonë, madje shumë më vonë sesa janë zhvilluar fetë monoteiste dhe teologjia e judaizmit, e krishterimit dhe e islamizmit. Në të vërtetë, teologjia e secilës nga fetë e përmendura ka nocione dhe terma të psikologjisë. Ndër konceptet dhe termat e këtilla shpirti dhe dukuritë shpirtërore janë ndër më të vjetrat.

Psikologjia e religjionit, duke përfshirë edhe psikologjinë e fesë islame në shqipe, duke kërkuar dhe ndërtuar sistem koherent konceptesh e termash dhe lidhje logjike ndërmjet tyre, ballafaqohet me domosdonë e njohjes, të përcaktimit të përmbajtjes dhe të emërimit të shpirtit, të proceseve shpirtërore, të funksionit dhe të manifestimit të tyre në jetën e gjithmbarshme të njeriut. Konsideroj se pa përcaktim të këtillë të konceptit dhe të termit shpirt dhe të sistemit të zbatimit të tij në të folur, sidomos në të shkruar, vështirë mund të përshkruhet dhe të shpjegohet esenca, zanafilla, funksioni, vlera dhe zhvillimi i fesë dhe i sjelljeve fetare të njeriut. Po ashtu, pa saktësim të këtyre termave edhe më vështirë mund të përshkruhet dhe të shpjegohet zhvillimi i mendimit për fenë, ku koncepti dhe termi shpirt është ndër nocionet më të rëndësishme, përkatësisht termat qendrore.

Termi shpirt është ndër termat e lashtë; ky term ka përdorim relativisht të dendur në shprehjet e mendimeve, të ndjenjave dhe të llojeve të ndryshme të aktiviteteve të njeriut. Në përdorim të deritashëm të termit shpirt dhe të termave që kanë për bazë të formimit të tyre termin shpirt

(shpirtlig, shpirtëzim, shpirtar, etj.) janë shfaqur lajthitje. Në këto lajthitje termi shpirt dhe termat e proceseve shpirtërore dhe domethënia e tyre shpesh janë trajtuar terma me domethënie të barasvlefshme me termat frymë, vetëdije, ndjenjë, frymëzim, madje edhe me termin temperament ¹.

Psikologjia e fesë islame ka për detyrë të japë përgjigje në tri pyetjet kryesore: 1. çfarë është shpirti? 2. përse është i këtillë? si është zhvilluar mendimi për të dhe si janë zhvilluar sjelljet fetare të islamikut?. Pa përgjigje në këto pyetje, që përcaktojnë statusin shkencor të secilës disiplinë dhe të terminologjisë së saj, psikologjia e fesë islame vështirë mund të bashkërenditet ndër disiplinat e tjera të psikologjisë. Megjithëse përgjigja në disa nga pyetjet e shtruar i tejkalon caqet e shqyrtimit të shprehjeve profesionale, teknike e gjuhësore të psikologjisë së fesë islame, konsideroj se vlen të merremi edhe me njërën ndër çështjet më të rëndësishme të mendimit filozofik e psikologjik dhe të terminologjisë islame, sikurse është shpirti, sidomos marrëdhënia e tij me trupin.

Psikologjia – shkenca për shpirtin

Sikurse është e njohur, psikologjia qysh nga ditët e para të zhvillimit të saj është përcaktuar si shkencë që studion shpirtin. Njohja e të vërtetës ose e të vërtetave për shpirtin, për proceset shpirtërore dhe për sjelljet shpirtërore të njeriut të fesë islame do duhej të jetë lëndë e psikologjisë së fesë islame. Mirëpo, që në fillim të përcaktimit të objektit të studimit të psikologjisë së fesë islame hasim në vështirësi dhe në pengesa metodologjike gati të pakapërcyeshme. Mendimi i vërtetë për shpirtin do të thotë përputhje e tij dhe bindje e njeriut për qenien e shpirtit. Ndërkaq, qenia e shpirtit dhe e mendimit të njeriut për ekzistencën, fillin e zhvillimit, mënyrën e funksionimit të tij, etj. nuk ka mundësi të provohet dhe në mbështetje të rezultateve të të provuarit të tij të pohohet ose të mohohet ekzistenca, zhvillimi dhe funksionimi i shpirtit. Spiritizmi në përgjithësi dhe teologjia islame, sikurse edhe psikologjia e fesë islame nuk kanë arritur të provojnë ekzistencën substanciale, shfaqjen dhe funksionimin e drejtpërdrejtë të shpirtit. Madje, në Kur'an është shkruar: “Të pyesin Ty për shpirtin (i drejtohet All-llahu Muhamedit a.s., thuaj: “Shpirti është krijuar me urdhrin e Zotit tim, e juve ju është dhënë vetëm pak dijeni (se dijenia e

¹ Fjalor i shqipes së sotme, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, Botimet Tona, Tiranë 2002, fq. 1 281.

plotë është vetëm e Perëndisë)”². Po ashtu, në këtë përkthim të Kur’anit thuhet: “Pastaj e ka krijuar atë (njeriun) dhe i ka dhënë gjallëri, me frymëzimin e Tij. Ai ju ka dhënë të dëgjuarit, të pamurit dhe të menduarit, - e sa pak prej jush jeni mirënjohës”³. Këto thënie të Kur’anit kanë shkaktuar te disa studiues besimtarë heqje dorë nga gjurmimi thellësor i shpirtit dhe i dukurive shpirtërore. Ndërkaq, nga ana e disa studiuesve të tjerë të psikologjisë, pamundësia metodologjike e të provuarit të substancës së shpirtit dhe të funksioneve të tija ka kërkuar angazhim serioz në zbulimin dhe në njohjen e atyre proceseve psikike të vetëdijshme të njeriut, tërësia e të cilave emërtohet me termin shpirt. Në këtë rrafsh dallohen studiuesit e psikologjisë së fesë islame të Egjiptit.

Megjithëkëtë, të arriturat në këtë pikëpamje janë të kufizuara. Ndërkaq, termi shpirt ka përdorim të zakonshëm, sidomos në komunikimin kolokvial jo vetëm në gjuhën shqipe. Në teologji, sikurse edhe në disiplinat e studimeve islame, si janë “Tasavuf” (misticizëm), “Fikh” (e drejta islame), Sheriat (ligji i All-Llahut), etj. termi “shpirt” ka status të qëndrueshëm. Në disiplinat e psikologjisë bashkëkohore përdoret gjithnjë e më rrallë meqë sot psikologjia, në kuptimin e gjerë të saj, përkufizohet shkencë mbi sjelljet. Përfashtim nga këto disiplina të psikologjisë së sotme bëjnë psikologjia e moralit, psikologjia e fesë, nga të cilat ndahet metapsikologjia. Meqë është nocion dhe term themelor edhe i psikologjisë islame, term prodhues në gjuhësi me modalitete fjalëformuese të ndryshme, term me shkallë relativisht të lartë të qëndrueshmërisë dhe të përdorimit të tij, etj., kurse domethënia e tij është e problematizuar, përdorimi i tij, pa marrë parasysh kontekstin e zhvillimit të mendimit, paraqet një çështje të rëndësishme për psikologjinë e fesë islame dhe për terminologjinë e saj.

Statusi leksikografik dhe semantik i termit “shpirt” në psikologji dhe në psikologjinë e fesë islame

Në gjurmimin e burimit të nocionit dhe të termit “shpirt” konstatojmë se në mendimin filozofik që nga koha e lashtë “shpirti” ka qenë ndër nocionet qendrore. Mjafton të përmendim pikëpamjen e mendimtarëve të vjetër grekë prej Alkemonit, Demokritit dhe Epikurit e deri tek Aristotelit dhe vepra e tij “Për shpirtin” për të dalluar orvatjet e panumërta që nga

² Prof. Hasan I. Nahi: “Kur’ani i Madhëruar”, El Israë, 85, Prishtinë, 1988, fq. 291.

³ Po aty, Es Sexhde, 9, fq. 416.

mendimet e para për njeriun dhe për shpirtin e tij për të përcaktuar kuptimin e termit shpirt, funksionin e shpirtit, raportin shpirt-trup, etj.

Nga filozofia nocioni dhe termi shpirt është bartur në psikologji duke mos ndryshuar jo vetëm pozicionin e nocionit dhe të termit qendror edhe në këtë disiplinë, por duke u bërë emërtues i gjithë asaj që studion psikologjia. Pozicionin e këtillë e dallojmë edhe në leksikun e psikologjisë, sepse fjala ballore e greqishtes së vjetër “Psikologji”, kur zbërthehet në domethënien e fjalës Psyche = shpirt dhe logos shkencë = shkenca për shpirtin e argumenton pozicionin e nocionit dhe të termit qendror të psikologjisë. Nocioni dhe termi psikologjik e ka ruajtur pozicionin dhe statusin leksikografik edhe sot. Termi shpirt, psikë, psikikë, psikologji, etj. ka ngelur i pandryshuar në strukturën dhe në morfologjinë leksikore të shqipes edhe sot.

Psikologjia e dikurshme, që është përcaktuar sipas sqarimit leksikografik të termit psikologji – shkenca për shpirtin, sot përkufizohet shkencë për sjelljen. Kjo ikje e psikologjisë në përdorim të termit shpirt më tepër mund të shpjegohet nga pamundësia e të provuarit eksperimental të ekzistencës së shpirtit, të formave të shfaqjes, të matjes dhe të vlerësimit kualitativ të proceseve, të gjendjeve dhe të tipareve karakteristike të dukurive shpirtërore. Mbisundimi i metodave objektive të studimit, të argumentimit të qenies së shpirtit, të funksionimit, të formave të shfaqjes dhe të vlerësimit kuantitativ dhe kualitativ të dukurive shpirtërore ose psikike dhe zhvillimi i degëve të psikologjisë aplikative në edukatë, në shëndetësi, në industri, etj. kanë shkaktuar përdorimin gjithnjë e më të paktë të termit shpirt duke e lënë përdorimin e këtij termi më tepër në komunikim të përditshëm se në terminologji të psikologjisë. Megjithëkëtë, në historinë klasike të psikologjisë, në antropologji, në etnologji, në etikë, etj. termi shpirt ka përdorim të zakonshëm, por me domethënie të ndryshueshme, ku domethënia e tij mund të nxirret më lehtë nga konteksti i rrjedhës së mendimit.

Në psikologjinë e fesë islame termi “shpirt” dhe domethënia e tij ka ngelur të thuash i pandryshueshëm, kurse dijenia për të është e paktë dhe e pamjaftueshme për të ngritur psikologjinë e fesë islame si në pikëpamje substanciale ashtu edhe në pikëpamje funksionale në nivel të një discipline me nocione dhe me terma, me rregullsi dhe me ligjësi të mendimit koherent për shpirtin. Për shkaqet e përmendura, psikologjia e fesë islame sot ka arritur më tepër të krijojë një sistem koherent të mendimit dhe të

terminologjisë së nocioneve të saja në fushën funksionale e shumë më pak në fushën substanciale të shpirtit dhe të dukurive shpirtërore. Pikërisht falë të arriturave në njohjen e sjelljeve fetare të njeriut, e jo në fushën e njohjes së substancës e të qenies së shpirtit, psikologjia e fesë islame ka arritur të formohet fushë e psikologjisë me terminologji në zhvillim të sistemit të nocioneve të saja.

Qasja studimore e nocionit dhe e termit shpirt

Në psikologjinë e feve përgjithësisht kërkimi i burimit të nocionit dhe i termit “shpirt” shpie në teologjinë e fesë së caktuar, përkatësisht në shkencën për “Zotin”, ku nuk polemizohet për qenien e tij, por ai dhe shpirti i njeriut i ardhur nga Zoti mund të njihet vetëm me njohjen e besimit të njeriut në Zotin e tij. Meqë secila nga fetë monoteiste e ka zotin e vet (Judaizmi-Juden, Krishterimi-Jezusin, Islamizmi-All-Llahun) Zoti i secilës prej këtyre feve është burim i shpirtit të njeriut; rrjedhimisht All-Allahu për muslimanin është Ai, që, sikurse thuhet në Kur’an: “Dhe kur Unë ta plotësoj atë dhe t’i jap frymë prej shpirtit tim (kur t’i jap jetë), bëni sexhde atij”⁴. Sipas këtij pohimi këto dy nocione janë jashtë kategorive objektive dhe të pamundshme të njihen me anë të njohjes shqisore dhe racionale të njeriut. Për këtë shkak, për termin shpirt dhe për domethënien e tij, mund të flitet nga këndvështrimi metapsikologjik dhe psikologjik. t.

Psikologjia e religjionit i qaset studimit të shpirtit dhe fenomeneve shpirtërore duke u mbështetur në metoda objektive dhe duke u nisur nga baza konceptuale, që është raporti shpirt-organizëm. Në kuadrin e kësaj baze konceptuale dhe duke u mbështetur në metoda e procedura objektive shpirti u studiua në tri aspekte të funksionit të tij: *1. nga aspekti i raportit të dinamikës mentale, ku çështje kryesore është raporti shkak-rrjedhim, përkatësisht shpirt – sjellje e njeriut, 2. nga aspekti i topografisë mentale, ku çështja u shtrua drejt njohjes së pozicionit të shpirtit në strukturën mentale e trurorë dhe 3. nga aspekti i funksioneve mentale, me të cilin rast çështje e diskutueshme është çfarë funksionesh mentale kryen shpirti dhe si i kryen këto funksione?*

Në kuadrin e studimit të këtyre aspekteve të fesë islame psikologjia ka arritur të njohë sjelljet e besimtarit islam, zhvillimin, motivet dhe modifikimet e sjelljeve të islamikut, sikurse edhe integrimet e këtyre

⁴ Po aty, kapitulli a surja “Sad”, verseti 29, fq. 458.

sjelljeve në tipare karakteristike të personalitetit dhe të karakterit të tij. Gjatë njohjes së tyre psikologjia e fesë islame edhe në shqipe ka arritur të formojë një grup të veçantë termash dhe të orvatet të krijojë një sistem pak a shumë të qëndrueshëm të termave të kësaj fushe të psikologjisë. Në këtë kuadër psikologjia e fesë islame në shqipe bën fjalë për tiparet e personalitetit të islamikut, për karakterin e islamikut, qëndrimet e islamikut ndaj Zotit, ndjenjat fetare e morale të tij, për pikëpamjen e tij për gjithësinë dhe fenomenet e ndryshme fizike, biologjike, sociale e psikologjike të njeriut, etj. Këto dhe shumë terma të nocioneve gjegjëse të tyre kanë arritur të stabilizohen në terminologjinë shqipe të psikologjisë së fesë islame. Ndërkaq, termi “shpirt” ka ngelur term me domethënie të pakapshme në kuadrin e tri aspekteve të përmendura. Për këtë arsye dallojmë qasjen metapsikologjike dhe qasjen psikologjike të studimit të shpirtit dhe të proceseve shpirtërore, sikurse edhe të emërimit të tyre.

Pozicioni dhe domethënia metapsikologjike e termit “shpirt”

Nga teologjia islame mësojmë se fjala arabe *ruuh*, herë-herë edhe fjala *nefs*, në gjuhën shqipe janë përkthyer me fjalën *shpirt*. Mendimtarët islamikë të lashtë, me gjithë kufizimet kur’anore për shqyrtim dhe njohje të shpirtit, sepse “Shpirti është çështje që i përket vetëm Zotit...” janë marrë më studimin e shpirtit. Ndër mendimtarët e vjetër të fesë islame, që u dalluan me pikëpamjet e tyre për shpirtin, janë: Gazali, Avicena, Rumi, etj.

Ebu Hamid El-Gazal (1058-1085) për shpirtin ka thënë: “Shpirti në vete përmban gjallëri, jetë, freski e kënaqësi, e gjallëron trupin, e kontrollon, e rregullon dhe e dirigjon atë. Trupi është instrument dhe bartës i shpirtit...”⁵.

Mendimtari i njohur islam Abu-Ali Ibn Sena, përkatësisht Avicena, natyralist dhe mjek arab (980-1037) ka pohuar ekzistencën e pesë llojeve të shpirtit: 1. Shpirti i gjërave të ngurta, që tek njerëzit e përfaqësojnë eshtrat, 2. Shpirti i bimëve, te njerëzit përfaqësohet me mëlçinë e zezë, 3. Shpirti i kafshëve, të cilin te njeriu e përfaqëson zemra, 4. Shpirti njerëzor, që përfaqësohet me intelektin dhe me ndërgjegjen e njeriut dhe 5. Shpirti i bekuar, që është dhuratë e All-Llahut për besimtarët islamë të sinqertë ⁶.

⁵ Prim. dr. med. sci. Ali F. Iljazi, Kur’ani dhe shkenca bashkëkohore, Gjakovë, 2000, fq.466.

⁶ Po aty, fq. 468.

Enciklopedisti i urtësisë së jetës shpirtërore Xhelaluddin Rumi (1207-1273) ka folur për lidhjen e njeriut me format dhe me funksionet e shpirtit. Sipas tij, shpirti i njeriut paraqet konstitucionin dhe tipin, pesë shqisat e jashtme dhe të brendshme të lidhura me qendrat e tyre në sistemin nervor qendror, kuptimin e lidhur me intuitë dhe me aftësi të njeriut, gjendjen e ndryshuar të aktivitetit të njeriut (njeriu në gjumë dhe në gjendjen jogjimore), gjendjen e frymëzuar të njeriut dhe në fund gjendjen e të vërtetave, që njeriu nuk mund t'i njohë, sepse ato i takojnë fuqiplotit ⁷.

Nga këto pohime të mendimtarëve të lashtë islamikë shohim se teologët islamikë janë marrë me studimin e shpirtit dhe kanë sajuar nocione dhe terma të gjuhëve orientale. Disa nga nocionet dhe termat e tyre janë bërë pjesë e terminologjisë shqipe të psikologjisë klasike të mbarimit të shekullit nëntëmdhjetë dhe të fillimit të shekullit njëzet, kurse sot kanë ngelur kryesisht pjesë e leksikut të psikologjisë popullore të islamit.

Një numër fjalësh dhe termash të këtilla të kësaj psikologjie kanë depërtuar edhe në gjuhën shqipe. Të këtilla janë fjalët: abdest, ah, aheng, alamet, Allah, amanet, amin, amshim, arnaut, ashik, averoizëm, avicenizëm, baba, bajraktar, bektashizëm, bela, beqar, bezdisje, bilmez, bismil-lah, budalla, deli, dembel, dert, derman, dervishizëm, devshirme, ejvalla, enkas, fakir, efendi, fetfa, fidai, fikhi, fiqir a fiqer, fukara, gazep, gajret, gjoks, gjynah, hadith (hadis), hall, hasmëri, hashura ose ashura, hatër, hiç, iman, inat, jetim, insan, islamizëm, kësmet (kismet), kodosh, lazëm, lezet, majmun, llafazan, marak a merak, maraz, marifet (zotësi), matuf, medet, melek (engëll), meskin, muhamedan, muhaxhir, mysafir, mysliman, nazeli, nef(p)si, qejf, rehati, sebep, sefa, selam, selam alejkum, sevda, sifat (virtyt, sjellje, ves), siklet, shaka, vesvese, ters, tefsir, ujdi, uzdaj, vardisje, xhelat, xhind, zahmet, zanat, zapt, zët, zor, Zot, zullum, etj. Ndër këto fjalë të lidhura me domethënien e shpirtit disa kanë marrë statusin e termit të psikologjisë së fesë islame. Këto janë: Allah, amshim, averoizëm, avicenizëm, bektashizëm, bezdisje, dembeli-a, dervishizëm, devshirme, fukara, hadithet, hasmëri, inat, jetim, islamizëm, majmun, llafazan, merak, matuf, siklet, shaka, vardisje, xhelat, Zot, etj.

Disa nga nocionet dhe termat e përmendura kanë karakter nocionesh abstrakte. Ndër nocionet e këtilla është edhe nocioni shpirt. Domethënia e këtij termi është reflektuar edhe në nocionet konkrete, që janë emërtuar me

⁷ Po aty, fq. 472.

terma islame dhe janë mbartur në gjuhën shqipe. Reflektim të këtillë hasim sidomos në antroponomi të shqiptarëve.

Shpirti dhe antroponomia islame e mbartur në gjuhën shqipe

Domethënia metapsikologjike e fjalës shpirt, përkatësisht e termit “shpirt” të turqishtes a të arabishtes ka pasur ndikim të fuqishëm në antroponomi të shqipes. Shumë emra dhe mbiemra në shqipe kanë ardhur nga arabishtja dhe turqishtja me domethënien bazë të termit të shpirtit ose të ndonjë funksioni të tij. Meqë antroponimet e shqipes, të ardhura nga arabishtja e turqishtja, i kalojnë caqet e temës sonë, më poshtë do të vë në dukje vetëm disa nga antroponimet më të stërpikura dhe të lagura me domethënie të shpirtit ose të funksioneve të tija dhe që kanë përdorim të shpeshtë në shqipe.

Antroponime të këtilla janë: Abdullah - me shpirt të shërbyesit të Zotit, Adem - njeri, Behxhet - freski e bukurisë, Bejaze – e bardha, më shpesh me shpirt të bardhë, Dervish - i tërhequr në varfëri dhe në përvuajtëri, Dilaver - trim, Emin - i besueshëm, Eshref - fisnik, Fadil - i vlefshmi, Faik - i zgjedhuri, Hamdi - i falënderuari, Hasan - bukurosh, Ibadete - të mësuarit për Zotin dhe falja ndaj Zotit, Ismet - i mbrojturi, Islam - i dhënë pas Zotit, Kadri - i fatit, Kasem - ndarës, Kahreman - kreshnik, trim, Latif - i butë, i pashëm, Lutfi -mirëbërësi, Mahmut - i falënderuari, Mazllum – modest, Mehdi - i rrugës së mbarë, Myrvet (njerëzi, bujari), mysliman, Naile - fituese, Naim - i butë, Nuredin - besimi i ndritshëm islam, Pejgamer, Qamil (i pjekur, i provuar), Qemal - pjekuri, përsosmëri, Ramiz - i shkathët në të folur, Rashid - i dhënë pas Zotit, Ragib - ai që mban shpresë, Sadik - i saktë, Salih - shpirtmirë, Serbeze - e lirë, e pafrikueshme, ballëhapët, Shaqir –falënderues, Shefki - me pasion të flaktë, Tahir - i pastër, Teufik - përkrahës i Zotit, Vehbi - i prirur nga Zoti, Vehab - rob i Zotit, Zeqir - ai që ka kujtesë të fortë, Zeki -mendjemprehtë, Zihniye - e talentuara, etj.

Termi “shpirt” dhe domethënia e tij në terminologjinë e psikologjisë bashkëkohore të religjionit

Në psikologji termi “shpirt” emërton tërësinë e përjetimeve të vetëdijshme të njeriut, kurse sintagma “shpirti fetar”, sidomos termi “vetëdija fetare”, ka domethënie të tërësisë së ndërlikuar të përjetimeve fetare të individit, ku hyjnë bindjet, ndjenjat, paragjykimet, pasionet, pikëpamjet, qëndrimet dhe sentimentet fetare, sikurse edhe tiparet e personalitetit dhe të karakterit të qytetarit fetar duke përfshirë edhe qytetarët e fesë islame. Këto janë terma të psikologjisë funksionaliste dhe, si të këtilla, kanë status të qëndrueshëm edhe në psikologjinë e fesë islame. Sintagmat e tipit “shpirt fetar”, “vetëdije fetare”, “bindje islame”, etj. mund të jenë ndër më të ndryshmet, si, bie fjala, interesim religjioz, pikëpamje fetare, qëndrim islamik, paragjytime fetare, karakter fetar, sinqeritet i denjë religjioz, vetëpërmbytje islame, zemërgjerësi muhamedane, islamizmi i hershëm, etj. Kërkesat e zhvillimit dhe të formimit të tipareve të besimtarit islam mund të shprehen me terma të tipit sintagmë në mënyrë më të saktë. Kështu, mund të cilësohet vetia e karakterit të besimtarit islam me termat: dashuria ndaj së vërtetës, toleranca fetare, çiltëria islame, sinqeriteti i besimtarit islam, guximi islamik, skofia islame, etj. Termat sintagma kanë stabilitet më të fortë në terminologjinë e psikologjisë islame se termi shpirt.

Në psikologjinë bashkëkohore termi shpirt po zëvendësohet shkallë-shkallë me termin psikë. Termi psikë në psikologjinë bashkëkohore është zhveshur nga domethënia metapsikologjike, sepse psikologjia ka marrë drejtim të zhvillimit objektiv. Ky drejtim zhvillimor dallohet edhe me përkufizimin e objektit të psikologjisë, dhe sot, sikurse përmendëm, *objekti i studimit të saj janë sjelljet e individit, që kanë karakter perceptues, që kontrollohen, maten, vlerësohen, verifikohen, shpjegohen dhe formësohen gjuhësisht në mënyrë të kuptueshme*. Pa përmbushje të këtyre kriterëve psikologjia, sikurse edhe disiplinat e tjera shkencore, nuk do të mund të ekzistonte si disiplinë e pavarur e shkencës. Zhvillimi i saj sot mbështetet në të dhëna e fakte të qenësishme dhe empirike, që u nënshtrohen provave të organizuara në mbështetje të zbatimit të metodave hulumtuese. Këto të dhëna e fakte kanë të bëjnë, në rend të parë, me reagime dhe me sjellje konkrete të individit në kushte dhe në situata të caktuara fizike, organike, sociale, fetare e psikike dhe me raporte të posaçme të këtyre kushteve e situatave.

Në mjedisin e kulturave të niveleve të ndryshme ekziston pikëpamja se shpirti ekziston në brendësinë e trupit të gjallë. Një pikëpamje e këtillë ka të bëjë edhe me aktualizimin e paralelizmit psikofizik, që rrjedh që nga dualizmi i Dekartit, sipas të cilit, shpirti është substancë që mendon, për ndryshim nga substanca që ka kuptim më të gjerë - nga trupi. Më këtë pikëpamje u aktualizua dhe më tepër një çështje serioze në filozofi dhe në psikologji: çështja e raportit shpirt-trup, që është ndër çështjet dominuese të mendimit njerëzor edhe sot. Vilhelm Vunt (1832-1920) – themelues i psikologjisë empirike - ka pohuar se “nuk ekziston substanca shpirtërore, jomateriale, e përhershme dhe mëvetësore”. Të këtij mendimi kanë qenë edhe disa mendimtarë të tjerë nga psikologjia, ndër të cilët edhe Teodor Fehner (18081-1887). Në psikologjinë bashkëkohore substanca e shpirtit gjen mbështetje në funksionimin e sistemit nervor qendror dhe ndikimin e mjedisit social në zhvillimin e tij dhe të sjelljeve të individit. Në këtë shpjegim është ndier ndikimi i madh i rrymës së reflektologjisë së Vladimir Behterievit, I. Pavlovit dhe, sidomos ndikimi i madh i rrymës biheviariste dhe neobiheviariste.

Biheviarizmi, sidomos neobiheviarizmi, i referohet domosdosë së studimit të fakteve psikike të kapshme me shqisat dhe me arsyen e të tjerëve dhe të kontrolluara nga të tjerët duke përfshirë më vonë edhe zhvillimin e kibernetikës dhe të informatikës, ku përpunimi i informacioneve dhe vënia në lëvizje e vetvetes, sikurse edhe kontrollimi i lëvizjeve mbështetet në një sistem fizik të provuar dhe të argumentuar. Nga mendimi i tyre sot në anglishte përdoret termi “mind” në domethënien e mendjes dhe të sjelljeve të lidhura me mendjen, që dallohet nga termi “soul” a shpirt. Nuk ndodh kështu në disa gjuhë të tjera, bie fjala, në gjermanishte (“die Seele”), në frëngjishte (“ame”) dhe në shqipe, ku termi shpirt përdoret në literaturën e psikologjisë bashkëkohore. Mirëpo, përdorimi i tij është i nivelit dukshëm më të ulët se në tekstet e psikologjisë së fillimit të gjysmës së dytë të shekullit njëzet.

Pas rezultateve të psikanalizës së Zigmund Frojdit nga dekada e parë e qindvjetëshit njëzet, sidomos të asaj të Karl G. Jungut, terminologjia e psikologjisë ka pësuar ndryshime dhe plotësime të mëdha. Z. Frojdi ka nxitur zhvillimin e psikologjisë me konceptin dhe me termin kapital të “pavetëdijes” dhe të *dinamikës së pavetëdijes*, kurse K. G. Jung ka shtrirë konceptin e pavetëdijes edhe në *sferën e pavetëdijes kolektive*. Duke u mbështetur në këto zbulime të rëndësishme edhe psikologjia e ka shtrirë

lëndën e studimit të saj jo vetëm në tërësinë e përjetimeve të vetëdijshme, kur dominonin nocionet dhe termat e lidhura me termin bazë “shpirt” dhe së bashku me të edhe nocioni e termi “besim fetar”, por edhe në atë të pavetëdijshme dhe në dinamikën e pavetëdijes. Këta dy mendimtarë kanë nxitur më tepër zhvillimin e metodave gjurmuese të përmbajtjes së pavetëdijes e të dinamikës së saj, sepse, për disa forma të shfaqjes së pavetëdijes, sikurse janë: gjumi, ëndrrat, paravdekja e njeriut e të tjera – në fenë islame kanë qenë të njohura që nga koha e profetit Muhamed.⁸ Më këtë zgjerim termi “shpirt” i psikologjisë introspeksioniste dhe strukturaliste u bë i pamjaftueshëm për të shprehur tërësinë e psikës dhe të formave të shumëllojshme të dinamikës së saj. Nga ana tjetër, përhapja e biheviorizmit në psikologji ka shkaktuar nxjerrjen jashtë përdorimit të termave shpirtërore dhe mentale, sikurse edhe rezultatet e gjurmimeve introspektive të shpirtit.

Meqë në psikologji, sikurse edhe në disiplinat e tjera të shkencës, nuk mund të ketë të vërteta të pandryshueshme dhe përfundimtare, kjo ka korrigjuar e plotësuar sistemin konceptual të saj duke përsosur njëkohësisht sistemin e shprehjes gjuhësore të këtij sistemi. Pasojë e një zhvillimi të këtillë janë ndryshimet e mëdha në terminologji të psikologjisë, ku termi shpirt gjithnjë e më shumë po ngel në grupin e termave të psikologjisë introspektive dhe të historisë së zhvillimit të saj deri kah mbarimi i gjysmës së parë të shekullit njëzet, por term i lëkundshëm pas mbarimit të gjysmës së parë të këtij shekulli. Në këtë fazë të zhvillimit të psikologjisë termi “shpirt” ka emërtuar tërësinë e përjetimeve të vetëdijshme të njeriut dhe në këtë kuadër edhe strukturën e besimit fetar të njeriut.

Në veprat e terminologjisë më të re të psikologjisë në anglishte, sikurse kemi përmendur, termi shpirt “soul” nuk është shtjelluar⁹, por në vend të tij është vënë termi “mind”, përkatësisht “mendje”, kur shpjegohet problemi “mind-trup”, që ka zënë vend shtjellues të posaçëm¹⁰. Por, edhe në veprat e psikologjisë bashkëkohore në anglishte termi “soul” përmendet rrallë¹¹.

⁸ Prof. Hasan I. Nahi, vep. e cituar, verseti Ez-Zumer, 42, fq. 464.

⁹ Oxford Dictionary of Psychology, Andrew M. Colman, Oxford University Press, 2005.

¹⁰ Po aty, fq. 450

¹¹ Carole Wade-Carol Tavis, Psychology, Seventh Edition, Pearson Education LTD., London, 2005.

Dr. Pajazit NUSHI

TERMI “SHPIRT” DHE DERIVATET KONCEPTUALE E GJUHËSORE TË TIJ NË PSIKOLOGJINË E FESË ISLAME

Rezyme

Rezultatet e studimeve të sjelljeve dhe të mendimit të njeriut kanë çuar vazhdimisht në domosdonë e studimeve neurofizilogjike e neuropsikologjike, sepse vazhdimisht, që nga koha e Dekartit dhe më herët, është konsideruar se truri është bartës i jetës shpirtërore të njeriut. Në këtë konstatim sot nuk dyshohet. Ndërkohë lobit të përparmë të cipës së trurit dhe talamusit i është atribuuar cilësia e qendrës së shpirtit dhe të sjelljeve të njeriut. Ndërkaq, funksioni i ndërlidhur i këtyre pjesëve të trurit është i pamjaftueshëm për të pohuar se pikërisht në këto pjesë të ndërlidhura të trurit është qendra e shpirtit të njeriut, përkatësisht e jetës psikike të tij dhe bartëse e pikëpamjeve dhe e sjelljeve fetare të njeriut.

Përjetimi i vetëdijshëm fetar i besimtarit nuk mund të shprehet me terminologji fiziologjike, madje as me atë neuropsikologjike të trurit. Kjo ka shkaktuar zgjatje të jetës së termit shpirt në psikologji. Mirëpo, pamundësia e përcaktimit të pozicionit të shpirtit në hartën mentale dhe të përcaktimit të burimit të energjisë motivuese të shpirtit në sjelljet e besimtarit ka shkaktuar disa kufizime në përdorim të termit shpirt. Shtrirja e burimit të energjisë së sjelljeve fetare në sferën e pavetëdijes dhe të strukturës epshore, përkatësisht nep(f)sore të saj, e ka ndryshuar domethënien e termit shpirt. Këto mungesa domethënëse dhe ndryshime shtrirëse të domethënies së termit shpirt kanë shkaktuar lëkundje të pozicionit të këtij termi në terminologjinë e psikologjisë. Rrjedhimisht, edhe statusi terminologjik i termit “shpirt” dhe i bazës fjalëformuese të këtij termi ka ngelur i lëkundshëm dhe i padefinuar në psikologji. Pozicioni i këtillë i këtij termi ka shkaktuar në disa gjuhë zhvendosjen e tij nga terminologjia e psikologjisë në leksik të psikologjisë popullore dhe në leksik të të folurit të zakonshëm.

Kjo lëkundje e termit “shpirt” ka filluar të reflektohet edhe në terminologjinë e psikologjisë në gjuhën shqipe. Megjithëkëtë, termat e tipit sintagmë të gjuhës së psikologjisë së shpirtit tregojnë tendencë të qëndrueshmërisë së tyre në terminologjinë e psikologjisë së fesë islame. Kjo lëkundje i ka nxitur studiuesit e psikologjisë islame, sidomos ata të Egjiptit, ta intensifikojnë sistemin e gjurmimit të motiveve shpirtërore dhe të kuptimit të tyre në sjelljet e qytetarëve të fesë islame.

Prishtinë, më 10.11.2005

Dr. Feti MEHDIU

PËR NJË TERMINOLOGJI ISLAME STABILE NË GJUHËN SHQIPE

Për islamistikën shqiptare, me sa kemi njohuri deri tash, mund të flitet nga vitet e 20-a të shekullit njëzet. Përkundra faktit se Feja islame te populli shqiptarë gjallëron prej shekullit 14, duke u mishëruar me kulturën dhe traditën e këtij populli, literatura islame në gjuhën shqipe fillon në vitet 1920, me përkthimin e studimeve dhe me shkrime nga fusha islame. Lirisht mund të thuhet se islamistika shqiptare fillon me përkthimet fragmentare të Kur`ani kerimit (1921) dhe me revistën Zani i naltë (1924).

Gjatë tërë asaj kohe dhe midis dy luftërave botërore – si edhe pas luftës së dytë botërore, në trojet shqiptare, madje jo vetëm këtu por edhe në Itali, Amerikë, janë botuar shumë revista, gazeta, libra e publikime të ndryshme në gjuhën shqipe nga fusha e dijes islame. Në këto tekste është përdorur një terminologji laramane, ndonjëherë krejtësisht e pasakt për konceptin e fesë islame. Kjo ka ndodh nga shkak se në formimin e terminologjisë islame nuk është përfillë sa duhet brumi burimor për këtë terminologji.

Nevoja për të pas një terminologji unike islame stabile dhe afatgjate nga kjo fushë e dijes dhe kulturës shqiptare është shtruar edhe në Simpoziumin e vitit 1992, që u mbajti në Prishtinë.¹ Është nevojë e ngutshme që literatura shqiptare të ketë një terminologji islame unike duke respektuar specifikat e burimeve të Fesë Islame, përkatësisht ai formim të mbështetur në burimet e fesë islame, në Kur`an dhe në traditën islame.

¹ *Feja, kultura dhe tradita islame ndër shqiptarët*, 15-17, tetor, 1992, Prishtinë, 1995. Botoi Meshihati Bashkësisë Islame i Kosovës.

Terminologjia islame në gjuhën shqipe duhet vështruar nga dy aspekte:

Formimi dhe përdorimi i terminologjisë islame në tekstet konkrete;

Spiegimi në fjalorët standardë dhe fjalorët special që botohen në gjuhën shqipe. Madje edhe në te Fjalori i feve ka nevojë për plotësime.

Këtu do të marrim në shqyrtim disa nga ato terma që janë përdorur në tekstet islame, qofshin përmes përkthimeve apo përmes shkrimeve origjinale në gjuhën shqipe.

Termi *islamik-e, islamizëm, islamizim, islami*, përdoren, përveç në literaturën islame, edhe në tekstet laike në gjuhën shqipe, për të treguar: bashkësinë ose komunitetin; fenë islame; pranimin ose përhapjen e fesë islame tek një popull, konkretisht te shqiptarët.

Trungu i kësaj gjendet në Kur'an. Aty kemi *islam* dhe kjo fjalë është shoqëruar me fjalën *din*. Derisa **din** është fjalë e përkthyeshme dhe në shqip del: **fe**-ja, ajo **islam** nuk mund të përkthehet, njëlloj siç ndodh edhe me disa terma tjerë specifike që burojnë nga Kur'ani, si *zekati, haxhi*, etj.

Mbi bazën islam janë shtuar prapashtesat **ik-e, izëm, izim dhe i**, dhe në shkrimet shqipe del me këtë përdorim: *Bashkësia islamike, shtet islamik, kongres islamik*, për të treguar se Bashkësia, shteti, kongresi... mbështeten në parimet e fesë islame. Ndërtimi i tillë është i gabueshëm.

Pasi rrënja islam, mbaron me konsonant, njëlloj sikur osman, shteti osman, atëherë këtu duhet të marrë vetëm **e**, për të tregur gjinin femërore, si te *Bashkësia islame*, njëlloj sikur te *qeveria osmane*, ndërsa tek emrat kongres, parim, shtet etj, nuk merr asnjë mbaresë, por thuhet: *kongres islam, parim islam, shtet islam, etj*.

Mbaresa **izëm** këtu ka hyrë në bazë të analogjisë për ndërtimin e terminologjisë abstrakte filozofike a ideologjike, si: komunizëm, budizëm, marksizëm, brahmanizëm, iluminizëm, etj.

Pasi që në rastin konkret fjala është për fe, e cila është emërtuar në Kur'an decidivisht si fe islame, dhe pasi që me izëm ndërtohen terma ideologjike, këtu duhet të përdoret: Fe islame, fesë islame, fenë islame dhe jo: Fe **islamike**, fesë **islamike**...

Forma tjetër që në kohë të fundit ka nis të përdoret në shkrime: Islami, Islamin, në vend të Feja islame, Fenë islame, kur përdoret në gjuhën shqipe del me dy kuptime për të vetmin arsye se emri Islam, te shqiptarët ka marrë

funksion patronimik, dhe del si emër edhe si mbiemër: Islam Islami, Hasan Islami, Agim Islami etj. Për këtë arsye mendoj se këtu, varësisht nga konteksti, duhet shoqëruar me fjalën fe: *Feja islame* dhe jo Islami. Nuk është drejt të thuhet, për arsyen e sapopërmendur, *u përhap islami, erdhi islami, e sulmoi islamin, islami thërret.... por të thuhet: Feja islame u përhap, feja islame erdhi, e sulmoi fenë islame, feja islame thërret..*

Mbaresë **izim** përmban në vete frytin e dhunës, të presionit, si arabizim, serbizim, do të thotë ta detyrosh dikënd të bëhet ashtu siç nuk është. Pasi që feja islame në burimin e vet nuk e miraton dhunën **لا اكراه فى الدين** La *ikrahe fid-din....*” Nuk ka dhunë në fe...”, dhe ky ajet i referohet thirrjes për të pranuar fenë islame, nuk duhet të përdoret islamizimi i shqiptarëve... por të përdoret pranimi i fesë islame nga shqiptarët apo përhapja e fesë islame te shqiptarët. Këtë e përdor shumë korrekt historiani anglez Thomas Arnold në veprën e tij: *The preaching of islam...*²

Termi pejgamber edhe në literaturën islame ndërmjet dy luftërave është përdor paralelisht me profet, për ata që janë të dërguarit e All-llahut. Mendoj se të dy termat mund të përdoren edhe mëtutje. Por, sipas mendimit tim termi pejgamber që ka burimin nga gjuha perse e cila bën pjesë në gjuhët e popujve islamë, ka më shumë arsye të përdoret se sa profet, që është me prejardhje greke. Këtu është fjala për terminologjinë islame.

Kurse termi *profit* për pejgamber, që na ka rastis ta lexojmë në literaturën shqipe ndërmjet dy luftërave botërore, është krejtësisht i gabuar dhe nuk duhet të përdoret.

Për terminologjinë islame, në hapësirën shqiptare, duhet të merren për mbështetje gjuhët:arabe, perse dhe turke. Kjo arsyetohet me faktin se këto janë bartëse të terminologjisë islame.

Ky sesion shkencor, duhet të vejë një gurthemel për ndërtimin e një terminologjie stabile dhe të qartë e korrekte si nga aspekti filologjik ashtu edhe nga aspekti fetarë e kulturor, sepse edhe përdorimi i drejtë i terminologjisë fetare, këtu islame, si pjesë e kulturës së gjuhës tregon nivelin kulturor të popullit tonë.

² Thomas W. Arnold, *The preaching of islam*, London, 1913.

Kjo nismë le të na shërbejë që të vejmë në tryezë publike kapitalin teorik me ilustrime konkrete përkitazi me terminologjinë fetare në gjuhën shqipe në përgjithësi, sidomos atë islame, me shembuj nga praktika.³

Jam përqendruar vetëm te disa përdorime të gabuara nga aspekti i terminologjisë islame shqiptare, siç janë: Muhamedanizëm, apo Feja Muhamedane, feja e Muhamedit, ndonjëherë edhe fe turke, fe arabe (*për fe islame*) kaptinë, (*për sure të Kur'anit*); kushtetutë islame, (*për Kur'anin*); kufomë, (*për xhenaze*); kongres gjithislam, (*për haxh*); Perendi, (*për Zot dhe All-llah*) profit, (*për pejgamberr dhe profet*); revelasion, revelatë, (*për Shpallje*); verset, frazë, citat, rresht (*për ajet*); pelegrin-pelegrinazh, (*për haxh, haxhi*); lutje (*për namaz*); rruazare, (*për tesbih, tespah*); paraajs, (*për xhennet*); ferr, (*për xhehennem*), etj.

Kur trajtojmë problemin e terminologjisë islame në gjuhën shqipe duhet, të kemi parasysh faktin se terminologjia në përgjithësi nuk është vetëm një nomenklatur e thjeshtë për të emërtuar fenomenet a sendet që na rrethojnë. Termi duhet të shpreh kuptim të caktuar me saktësinë më rigorozë, i cili në parim nuk len hapësirë për implikimin e ndonjë kuptimi asociativ me funksion dytësorë, siç mund të ndodh ndërmjet termit *namaz*, nëse këtë e përkthejmë me fjalën lutje, apo termin *haxhi*, nëse e lëmë të përkthyer me termin pelegrin.

Terminologjia shpreh një pikëpamje të caktuar shkencore për botën, ajo është një shprehje semiologjike e përmbajtjes së caktuar konkrete, prandaj duhen sqaruar në hollësi disa terma nga fusha islame.

Unë mendoj se terminologjia islame në gjuhën shqipe do të jetë e plotësuar dhe korrekte pasi që të shtrohen e të shqyrtohen në tryeza të ekspertëve të dy profileve: gjuhësor dhe fetar.

Për mendimin tim kjo çështje tanimë ka filluar të trajtohet me konferencën shkencore në Tiranë.⁴ Sot këtu kemi për objekt shqyrtimi terminologjinë islame, që është për çdo lavdatë, por duhet thënë se për një terminologji fetare multikonfesionale stabile e afatgjatë në gjuhën shqipe, nuk mjafton me kaq.

³ Mendoj se për këtë qëllim duhet shfrytëzuar literatura përkatëse fetare, qofshin tekste shkollore, doracakë apo periodiku fetarë, i krishterë dhe islam.

⁴ Në fillim të qershorit 2005, u mbajt Konferenca shkencore: Terminologjia fetare dhe gjuha shqipe.

Mendoj se duhet, të paktën, edhe dy tryeza sikur kjo: Njëra të shohsis terminologjinë fetare të krishterë, kurse tjetra, pasi të jenë botuar materialet e tryezave paraprahe, duhet të mbahet në përbërje multikonfesionale dhe multidisiplinore, në një organizim dy a tre ditorë, dhe atëherë mund të afrohen zgjidhje shumë më korrekte e të pranueshme për përdorim të gjerë në gjuhën shqipe.

Në hulumtimet tona kemi shënuar një varg shembujsh të kësaj natyre.

Këtu do të trajtojmë disa prej tyre, me një qasje krahasuese, për të cilat kemi bindjen se nuk mund të shkojnë në terminologjinë islame

Terminologji e ndërtuar nga brumi i Kur'anit

All-llah-u,⁵ është emërtim vetëm për Krijuesin e gjithësisë. Në shkrime shqipe ka përdorim të larmishëm. Në Kur'an shkruhet kështu, me dy ll-ëja. Në gjuhën shqipe e përdorim Zot, por nuk është përdorim korrekt, ngase në Kur'an, kemi termin *rabb* dhe *ilah*, të cilat përkthehen me termin Zot. Sado që termi zot ka prejardhje greke, për termin *rabb* dhe *ilah* mund të përdoret, kurse për *All-llah* nuk duhet përdorur. All-llah nuk është termë vetëm i Kur'anit dhe nuk është fjalë që ka lind me arabishten e sotme. Është shumë më i vjetër, por gjithsesi e brumit semit. Në librat tjerë të shenjt Tevrat (Tora) dhe në Inxhil (Ungjill) përdoret forma *Eloh*⁶ për të njëjtin qëllim siç është në Kur'an. Për terminologjinë islame duhet të ruhet forma që është në Kur'an.

Ajet-i, është një pjesë e caktuar e Kur'anit. Ajeti nuk është vetëm një varg poetik. Nuk kufizohet vetëm në një varg, as vetëm në një fjali apo periudhë.

Termin *ajet* disa e zëvendësojnë edhe me fjalën rresht dhe citat, që gjithashtu nuk korrespondojnë me domethënien dhe strukturën e ajetit, prandaj ajeti duhet të mbetet ajet. Mund të spiegethet por kurrësi nuk mund të përkthehet a të zëvendësohet me ndonjë shpikje të dhunshme semiotike e semantike

⁵ Radhitjen e termave nga Kur a ni e kam bërë sipas A-bes.

⁶ Kështu e theksojnë studjuesit e proveniencës së krishter. Kur shkruhet me shkrimin arab, i cili ka trung të përbashkët me ebreishten, si gjuhë semite, mund të lexohet edhe **Ilah**. Me këtë formë e hasim edhe në Kur'an, dhe bashk me termin *rabb*, i kemi përkthyer Zot.

Ajeti në Kur'an mund të përfaqësojë, më së paku dy bashkëtingëllore, **T/a/ H/a/ ; J/a/ S/in/**, e më së shumti një faqe të tërë të Kur'anit me 15 vargje, sipas botimeve standarde të Kur'anit. Prandaj mbështetja në burim është garancë e stabilitetit afatgjatë.

Verset-i, është fjalë latine *versus*, që do të thotë: varg, varg poetik. Versificatio- vjershërim. E kanë përdor për termin *ajet në Kur'an*. Edhe në kohën tonë e përdorin, njëlloj për atë qëllim, me arsyetimin se e kanë përdor islamistë të shquar të fillimshekullit njëzet, në një anë dhe të prirur që, gjojo të bëjnë pastrimin e gjuhës shqipe nga fjalët e huaja, në anën tjetër.

Është krejtësisht në kundërshtim me konceptin që shpreh termi ajet në Kur'an.

Haxh-i, është termë i formuar në Kur'an, me të cilin, në shqip, emërtohet ai që ka kryer detyrën e pestë islame haxhxhin-haxhillëkun. Ky veprim kryhet në muajin e 12 hixhri, muajin e hënës, pavarësisht në cilën stinë bie ai muaj sipas llogaritjes së kohës me kalendarin gregorian. Është e caktuar edhe dita. Kryhet vetëm në Mekke, në Arabi Saudite. Nuk është i obliguar për fëmij. Me rastin e vizitës së atyre vendeve duhet zbatuar detyra të caktuara që bëhen vetëm në atë kohë. Është i urdhëruar me Kur'an vetëm për ata që kanë mundësi.

Pelegri-i - ka prejardhje latine: *pelegrinus* që fillimisht ka kuptimin i huaj, e pastaj edhe “ ai që shkon në vendet e shenjta”. “ Udhëtim në vende të shenjta që bëjnë pelegrinët”. Në fjalorë të shqipes ka edhe spjegim figurativ:” vajtja e një numri të madh njerëzish në një vend historik”.⁷

Këtë e kanë përdor në vend të termit haxh dhe haxhi. Edhe në kohën tonë ndonjëherë e hasim në shkrimet shqipe islame, sigurisht si rezultat i imitimit të literaturës islame shqiptare nga shekulli i kaluar. Në realitet asnjëri nga këto kuptime nuk ka të bëjë me haxhin dhe haxhiun sipas konceptit islam. Tëra spjegimet që i gjejmë për termin pelegrin janë në kundërshtim me funksionin që e ka termi në thelb. Sipas këtyre spjegimeve shihet se vendet e shenjta nuk janë të caktuara. Kjo nuk përkon as me parimet e fesë së krishterë, ngase edhe ata haxhin e bëjnë në Jerusalem. Nuk është e caktuar as koha, mosha e as rrethana tjera të parapara në bazë të parimeve fetare. Madje figurativisht mund të jetë edhe ndonjë vend historik.

⁷ Fjalor i fjalëve të huaja, Prishtinë, 1988. (Instituti Albanologjik i Prishtinës)

Termi *haxh* në fenë islame shpreh një domethënie të përkufizuar saktësisht, cilin vend, në cilën kohë, në cilën moshë dhe rrethana të tjera, prandaj përdorimi pelegrin në vend të haxhi është krejtësisht jashta kontekstit islam dhe si i tillë duhet lënë jasht përdorimit në terminologjinë islame.

Përveç termit pelegrin, në tekstet islame në gjuhën shqipe, herë herë dalin edhe “gjevahirë” tjerë për të shenjuar termin haxh. Ka rastis disa herë që ky akt fetarë islam të emërtohet si Kongres gjithislam, gjithëbotërorë, që është pa asnjë mbështetje serioze.⁸

Islam-i, është emërtim për fenë islame dhe është i fiksuar në Kur`an,

Sure-ja, secili nga 114 kapitujt në të cilët ndahet Kur`ani.<sup>11</sup> Sigurisht në bazë të këtij spiegimi ka hy në përdorim termi kaptinë, për suret e Kur`anit, ose kapitull. Termi sure është term kur`anor, nuk është term letrar i letërsisë arabe, prandaj nuk mund të përkthehet me kapitinë apo kapitull. Në gjuhën arabe për kapitull dhe kaptinë përdoren krejtësisht terma tjerë, si: fasl, bab,

Xhenaze-ja, është fjalë arabe dhe si term nuk nënkupton vetëm trupin e pjetë të një njeriu, siç e ka kufoma. Termi Xhenaze nënkupton disa veprime të caktuara të domosdoshme dhe disa të preferuara, të cilat sipas normave islame duhet të kryhen nga të gjallët për të nderuar të vdekurin.

Përpjekja për ta zëvendësuar termin xhenaze me kufomë është një përpjekje për formim të dhunshëm në terminologjinë islame. Xhenazja ka edhe një namaz, i cili duhet kryer nga ata që e përcjellin dhe namazi, dihet, kërkon edhe abdest, e pastaj *falet namazi i xhenazes*. Nuk mund të thuhet falet lutja e kufomës, as bëhet lutja e kufomës, sepse kjo nuk do të kishte kurrëfar kuptimi. Aty kemi bashkimin e tri fjalëve të tri gjuhëve të ndryshme: shqip, persisht, arabisht.

Terma të ndërtuara nga brumi jo Kur`anor¹²

Më parë përmendëm edhe disa terma me burim grek e latin, të cilët kanë pas pretendime të inkorporohen në terminologjinë islame shqiptare por pa sukses ngase nuk e mbulojnë as përsëafërmi kuptimin e ekuivalentëve në origjinal.

Do të përmend edhe disa terma, të cilët burimisht janë nga proviniensa islame por jo nga gjuha e Kur`anit, për të cilat janë bërë përpjekje që të përkthehen në gjuhën shqipe. Gjithashtu do të sjellim edhe disa ilustrime të përpjekjeve për të formuar terma islame në mënyrë të dhunshme.

Abdest-i është formuar nga dy fjalë persiane: *ab-uj* dhe *dest- dorë*. Në fjalorët e gjuhës shqipe e kanë spjeguar: të larët ritual te myslimanët para se të falin namaz.¹³ Ka ndërtuar raporte të caktuara me gjuhën shqipe: ka marrë

¹¹ *Fjalori i gjuhës shqipe*, Prishtinë, 1965. (Ribotim i fjalorit të viti 1954 - Tiranë)

¹² Kështu i trajtojmë tëra ata terma që nuk kanë mbështetje në gjuhën arabe, sepse Kur`ani në origjinal është në gjuhën arabe.

¹³ *Fjalori i gjuhës shqipe*, Prishtinë, 1965.

abdes, mora abdes, u prish abdesi, nuk është për abdes...prandaj duhet të mbetet abdes ose abdest, kuptohet me spjegime më të plota.¹⁴

Namaz-i, ka prejardhje persiane që tregon formën e kryerjes së një obligimi islam të përditshëm, madje pesë herë në ditë. Ky term, në origjinalin e vet, në Kur'an është *salat*, porse në opinionin shqiptarë, turk, boshnjak e ndonjë tjetër, ka arrit me emrin *namaz* dhe kështu është sot e gjithë ditën.

Në gjuhën shqipe është shoqëruar me fjalën **fal** dhe kështu paraqet një formim kompakt: folje + emër, Fala namazin... falshim namazin... falnin namazin etj...

Tentimi për ta përkthyer me fjalën *lutje* paraqet një dështim profesional dhe shmangie nga koncepti themelor. Ata që kanë provuar ta përkthejnë me *lutje* nuk kanë menduar sa duhet për parakushtet që kërkohen të plotësohen para se të fillohet namazi(salat), Për të bërë *lutje* nuk kërkohet asnjë kusht i veçantë, mjafton vetëm të të shkoj mendja dhe lutesh sipas shijes e vullnetit personal, në çfarëdo rrethanash që të jeshë.

Falja e namazit bëhet në kohë të caktuar, duhet pastrim i caktuar, veshje e caktuar, duhet drejtuar në anë të caktuar të horizontit etj. Prandaj namazi me *lutje* nuk mund të përkthehet.

Kler-i – është një fjalë greke *kleros* që do të thotë shenjtëri, person i shenjtëruar. Në fjalorët e gjuhës shqipe, madje edhe në fjalorët special, për këtë jepet ky spjegim: "... të gjithë ata që kryejnë shërbime fetare e që kanë detyra të ndryshme fetare."¹⁵ Ky term që e gjejmë në literaturën fetare islame në gjuhën shqipe edhe sot, nuk mund të përdoret për personelin fetar islam, sado që e gjejmë në botimet e shekullit të kaluar, sepse nuk përkon me konceptin islam lidhur me personelin që kryen shërbime fetare te myslimanët. Ai që kryen shërbime fetare te myslimanët mund të jetë: imami, muezini, myftiu, kadiu. Në hapësirat shqiptare tërë këto i shprehin, shpesh, me termin *hoxhë*, i cili sado që nuk është adekuat, prapëseprapë është shumë më afër se sa të thuhet *kler*. *Hoxhë* nënkupton parinë islame, ulematë, në asnjë mënyrë nuk përmbajnë shenjtëri.

Revelatë-a është përdor shpesh në shkrimet shpiqe islame të shekullit njëzet, me kuptimin shpallje, për Kur'anin. Iu bë *revelatë*... *revelata* hyjnore.

¹⁴ Kjo formë e të larit është e definuar në Kur'an, prandaj duhet të përkthehet saktësisht.

¹⁵ Prof.dr. Ekrem Murtezai, Fjalor i feve, Prishtinë, 2000.

Ka prejardhje latine dhe do të thotë: zbulesë, në sllavisht otkrovenje, që përdoret për librin e shenjt Ungjill.

Terminologjia islame, për këtë në Kur'an, ka fjalën *vahj-shpallje*. Ka edhe funksion foljor *uhije*-iu shpallë. Përdoret vetëm për Kur'an. Për shpalljet tjera gjuha arabe ka fjalën i alan. Do të thotë se *vahj* nuk është vetëm arabe por është term islam. Prandaj nuk përkthehet me revelatë. Mund të përkthehet me fjalën shpallje.

Rruzare, ruaza në varg, të futura në një pe. Pretendon të zëvendësojë termin tespi, në origj. *Tesbih*. Është tentim i një formimi të dhunshëm terminologjik. *Tespih-u,ët*, mund të realizohet edhe pa rruzare fare. Nuk është me rëndësi fare mjeti, por veprimi, çka bëhet dhe çka nënkupton termi tespih. Veprimi që bëhet me tespih (tesbih) është burimisht nga Kur'ani dhe do të thotë: të madhruarit e All-llahut me shprehjen *Subhanall-llah-i lartsuar qofsh o All-llah!* Nga folja sabbaha është formuar *tesbih*, që paraqet infinitivin e llojit të zgjeruar të foljeve. Tespihët si mjet teknik, mund të kenë vetëm 33 kokrra, ruaza, ose 99 ngase duhen 3x33. As më pak as më shumë nuk mundet, jo sa ruaza të duash ti.

Edhe një arsye tjetër pse nuk mund të përkthehet tespih me rruzare është se rruzaret i varin për qafe fëmijët, ose mund t'i varin për dore etj., kurse tespihët janë një mjet teknik ndihmës për të adhuruar All-llahun.

*

* *

Në fund dëshiroj të theksoj se literatura shqiptare islame e shekullit të kaluar e ka kryer funksionin e vet dhe ka hap rrugën e terminologjisë fetare, ashtu sa ka mund. Sigurisht se akoma mund të jetë pikë referuese për terminologjinë islame në gjuhën shqipe, porse tani duhet marrë parasysh edhe literaturën e re fetare, e cila duhet, gjithsesi të vështrohet me sy kritik, ngase ndonjë herë kanë imituar terminologjinë e vjetër që nuk është mbështetur në burime të dorës parë. Çdo send me kohën dhe vendin e vet që të kemi një terminologji fetare stabile dhe jetëgjatë multikonfesionale, pa insistim të zëvendësimit të termave të huaj me terma dyfish të huaj.¹⁶

¹⁶ Terma dyfish të huaj janë për shembull: *ferr*, *verset*, *pelegrin*, *kler*, *revelatë* etj, sepse nuk janë as të burimit shqip as të burimit islam, ndërsa termat: *xhehenem*, *xhenet*, *ajet*, *haxhi*, *xhenaze*..., janë të huaj vetëm për kah prejardhja gjuhësore, por nga aspekti fetarë i përkasin fushës islame.

Çështje tjetër më vete është drejtshkrimi dhe lakimi i disa emrave nga kjo lëmi për të cilët duhet trajtim i veçantë, më gjerësisht dhe më thellësisht se sa është bërë deri tash.¹⁷ Kjo duhet të shtrohet në nivel gjithshqiptar dhe të harmonizohen elementi fetarë: i krishterë dhe islam edhe ai gjuhësor shqiptarë, dhe pastaj ato rregulla të respektohen nga njerëzit e pendës.

Nuk duhet hequr nga mendja konstatimin e prof. Eqrem Çabejit i cili thoshte, purizmi i tepruar mund t'i sjellë dëm gjuhës shqipe, dhe unë mendoj se pjesë e gjuhës shqipe është edhe terminologjia islame, prandaj kërkohet prej tërë individëve dhe institucioneve kompetente që të kenë parasysh rrugën e zhvillimit të gjuhës, e sidomos terminologjisë si faktor me rëndësi për komunikim të qartë ndërfetar e ndërkulturor për të dhënë një zgjidhje të qëndrueshme dhe afatgjate.

¹⁷ Shih: Drejtshkrimi i disa emrave arab në gjuhën shqipe, Gjuha shqipe, Prishtinë, nr.1/1984; Emrat arab dhe drejtshkrimi i gjuhës shqipe, Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, Prishtinë, nr.19/2000.

Dr. Ramiz ZEKAJ

TERMINOLOGJIA ISLAME NË FJALORËT E GJUHËS SHQIPE

S'është mjaft të marrë pendën njeriu dhe të nxinjë kartë, duhet të mësonjë, të shkruanjë me mjeshtëri se s'arrin të hedhësh gurë për të ngritur një shtëpi, është nevojë t'i vësh gurët radhë më radhë që të lidhen dhe të qëndrojnë shëndoshë e bukur.

(Faik Konica)

Duke marrë shkas nga këto thënje të Faik Konicës më lejoni që fillimisht të uroi për vazhdimësinë e nismës në shërbim të gjuhës sonë të dashur, që kohë më parë filloi në Tiranë për të trajtuar problemin e terminologjisë fetare në gjuhën shqipe. Në këtë kontekst jemi edhe sotë këtu për të trajtu tashmë një aspekt më të veçantë të kësaj terminologjie, dhe konkretisht për të trajtuar terminologjinë islame në gjuhën shqipe.

Që sot ne jemi këtu merit ka Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës dhe Fakulteti i Studimeve Islame në Prishtinë të cilët janë edhe organizatorët e kësaj tryeze shkencore njëditore.

Të nderuar pjesëmarrës:

Terminologjia islame në gjuhën shqipe ka pasë një produktivitet të veçantë ndërkohë që tradita e kësaj terminologjie daton me shekuj. Por duke u nisur nga fakti që kjo nuk u trajtua sa duhet dhe si duhet në periudhën e sistemit totalitar mundë të themi se kemi shumë punë për të bërë në mënyrë që edhe kjo qështje e rëndësishme për kombin tonë të marrë rrugën e duhur.

Dikur kur gjuha shqipe shkruhej me alfabetin arab por edhe më vonë gjatë rilindjes terminologjia islame ishte prezente kudo dhe mbulonte

shumicen e sektorëve të gjuhës së popullit tonë. Atë e gjejmë në administratë, në shkollë, në krijime letrare e shkencore, në liturgjinë fetare, në jetën e përditshme etj. Është kjo terminologji që i bëri më të bukura vargjet e Naimit, Nolit, e Fishtës. I ngriti në shkallën më të lartë artistiko shkencore veprat e Tahsinut, Samiut e Dalliut. Në të vërtetë ato mbetën si monumente gjeniale të letërsisë e gjuhësisë mbi të cilat më pas u kodifikua gjuha jonë letrare, edhe pse vështirësitë për këtë qenë mjaft të mëdha.

Çelsi i suksesit që përdorën këta korifej të gjuhës dhe kombit ishte se ata njifnin dhe kuptonin mirë problemet linguistike dhe dimensionet e gjuhëve tjera që tashmë kishin kaluar këtë situatë që po kalonte gjuha jonë. Fjalët arabe, perse e turke, që kishin zënë vend në gjuhën e popullit tonë nuk cenonin aspak vlerat e saj dhe autoktonitetin e saj, përkundrazi ajo u pasurua edhe më duke shtrirë komunikimin me disa prej kulturave dhe civilizimeve më në zë të kohës. Ato e bënë gjuhën tonë më të larmishme dhe më të zhdërvjellët, i dhanë mundësi më të mëdha stilistike-shprehëse.

Por ndërkohë që periudha e rilindjes kaloi, pavarësia e shtetit shqiptar dhe përpjekjet për konsolidimin e tij në planin politik bënë që edhe në gjuhë të vendosen kritere për të përfshirë leksikun aktiv të shqipes pa lënë menjatë edhe atë pjesë të rëndësishme të leksikut pasiv. Në fakt gjatë kësaj periudhe nuk u arrit të bëhej unjisi i gjuhës, por njerëzit e letrave thuajse kishin rënë dakort për metodologjinë dhe parimet themelore teorike që përcaktonin vijësinë ideoshkencore të shqipes. Normat leksikore, gramatikore, drejtshkrimore e drejtshqiptimore që përdorëshin gjatë kësaj periudhe shkonin në sinkron të plotë me njëra tjetren. Shumësia e terminologjisë islame që ishte prezente gjatë kësaj periudhe vetëm sa plotësonte visaret e gjuhës sonë dhe i jepnin asaj nuanca të reja për zhvillim më solid dhe më dinamik.

Alergjia për terminologjinë fetare në përgjithësi dhe atë islame në veçanti fillon me fillimet e ndikimit totalitar komunist mbi gjuhën dhe me nismat e ashtëquajtura “përpjekjet për pastrimin e gjuhës letrare shqipe nga fjalët e nga ndërtimet e huaja të panevojshme...”¹. Kjo pasqyrohet në të gjithë fjalorët e hartuar gjatë kësaj kohe, ku vihet re një prezencë e vogël e shumësit të fjalëve të terminologjisë islame, terminologji kjo e cila në

¹ FJALOR I SHQIPES SË SOTME (me rreth 34.000 fjalë), Tiranë 1984, Hartuar nën drejtimin e Prof. Androkli Kostallari (Kryeredaktor), Dr. Shk. Jani Thomai, Kand. Shk. Miço Samara, Bashk. Shk. Josif Kole (Redaktorë).

popull vazhdonte të jetonte dhe të përdorej në masë. Kjo nuk vërehet vetëm te fjalorët shqip-shqip; por edhe te fjalorët e gjuhëve të huaja si anglisht-shqip², shqip-anglisht, italisht-shqip³, te fjalorët sinonimik, fjalorët për fëmijë etj.

Kjo vinte nga lufta e klasave që kishte kaluar në sistem dhe politizimi ideologjik i institucioneve shkencore e arsimore. Kështu në një kohë që feja luftohej hapur dhe në mënyrë frontale, kjo duhej të reflektonte edhe në qështjet gjuhësore, duke menjanuar pjesen dërmuese të fjalëve me përmbajtje islame nga fjalori i përditshëm në shtyp, media, letërsi, shkolla, hartimin e teksteve mësimore, fjalorëve etj.

Sigurisht që ky ishte intrigimi dhe padrejtësia më e madhe që po i bëhej popullit tonë në historin e tij. Leksikografia e tij nuk po definohej sipas aftësisë së zgjedhjes së fjalëve që i takonin leksikut aktiv ose pasiv të popullit shqiptar dhe dialekteve të tij, por sipas orientimit të partisë dhe të ideologjisë sllavo-komuniste. Pasuria gjuhësore e të dy kryedialekteve të gjuhës sonë, gjatë kësaj periudhe pësoi një ndrydhje dhe prerje si me gërshtëri. Sulmi ndaj terminologjisë fetare nuk zhvillohej vetëm në mospërfshirjen e sajë në fjalorë e literatura të ndryshme por edhe duke gjetur sinonime për fjalë a terma që nuk zëvendësoheshin dot, ose duke i shpjeguar ato mbi baza ideologjike.

E keqja më e madhe ndodhi kur filluan të hartohen fjalorët e parë gjuhë e huaj-shqip dhe shqip-gjuhë e huaj, fjalorët terminologjikë, “Fjalori i gjuhës shqipe” (1954), e më vonë kur u bë edhe Kongresi i Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe (1972). Kjo vazhdoi edhe më pas kur u hartuan fjalorët e gjuhës së sotme shqipe (1980,1984) ku terminologjia fetare islame ngeli pa u vjelur. Ata që u morën me fjalorët duket nuk e kuptuan qartë thirrjen e Eqrem Çabejt “Për pastërtinë e gjuhës shqipe”, e cila presupozon pasurimin e gjuhës me elementë të gurrës vetjake e ku padyshim bëjnë pjesë edhe gjithë opusi i fjalëve që në trojet tona u nguliten me ardhjen e besimit islam, të cilit tashmë në rang kombëtar i takojnë mbi 90 % e popullsisë shqiptare. Ndoshta thënia e Prof.Dr.Ali Dhrimos se “Hartuesit e fjalorëve në përgjithësi janë njerëz të mallkuar”⁴, në këtë rastë edhe mundë të zinte vend

² FJALOR ANGLISHT-SHQIP, me 70.000 fjalë, autor Pavli Qesku, redaktor: Zef Simoni, EDFA Tiranë 2000.

³ FJALOR ITALISHT-SHQIP, rreth 50.000 fjalë, hartuar nga Ferdinand Leka, Zef Simoni; Shtëpia Botuese “8 Nëntori” 1986.

⁴ FJALOR SINONIMIK I GJUHËS SHQIPE, f.9, Tiranë 2002.

diku. Sigurisht që kjo u bie mbi supë më tepër atyre që orientuan politikat gjuhësore në trojet tona andej nga nuk duhej për vite të tëra. Për këta ndoshta do ishte e përshtatshme edhe një thënie e Faik Konicës ku thotë: “Po qe se dredhia dhe forcat brutale mund t’i shtypin talentet individuale, ato janë të pafuqishme kundër vrullit kolektiv anonim të një populli të tërë, i cili don t’i këndojë të këqijat e veta, apo t’i madhërojë fitoren dhe gëzimet e veta”.⁵

Dhe kjo u vërtetua më së miri me botimin e fundit të AIITC-së të “Fjalorit të Orientalizmave në Gjuhën Shqipe” i autorit Tahir Dizdari, ku përfshihen mbi 4500 fjalë me prejardhje nga gjuhët turke, arabe dhe perse, dhe ku më së miri dëshmohet prezenca e terminologjisë islame në gjuhën shqipe, terminologji kjo që vetëm në një përqindje të vogël është përfshirë në fjalorët e gjuhës. Në këtë kontekst Prof.Miço Samara shprehet në parathënien e këtij botimi:

Kjo vepër ose ky fjalor përfshin një lëndë të pasur leksikore me mbi 4000 fjalë e shprehje, që kanë hyrë prej kohësh në shqipe nga gjuhët orientale, mjaft prej të cilave, kanë pësuar edhe zhvillime të reja strukturore e semantike... Një pjesë e këtij leksiku në këtë vepër (rreth 5%) gjendet tek “Meshari” i Gjon Buzukut (1555) e “Fjalori latinisht-shqip” i Bardhit (1635), por shumica e tij në këtë vepër (rreth 40%) gjendet te fjalori i K.Kristoforidhit (1904) e në vjershat e bejtexhinjve, çka tregon se depërtimi i tyre në masë ka filluar pikërisht në shek.XVIII, atëherë kur qyteti shqiptar fillon të rritet me popullsi të ardhur rurale dhe marrëdhëniet e tij me fshatin shtohen, kur besimi islam zë vend në Shqipëri... Orientalizmat (terminologjia islame)⁶ u ngulën dhe zunë më tepër vend kur në Shqipëri u hapën mjaft mejtepe e medrese, ku jepej mësimi e arsimimi islam. Prandaj, orientalizmat jo vetëm do të pasqyroheshin në tekstet mësimore të këtyre shkollave, por ato do të gjenin përhapje në ligjërimin e përditshëm masiv, në shtypin e kohës, në letërsinë artistike shqipe origjinale dhe të përkthyer nga ato gjuhë.⁷

Të nderuar pjesëmarrës në këtë sesion shkencor:

⁵ Faik Konica, “Ç’është liria”, f.31, Tiranë 2005.

⁶ Shën. Autorit.

⁷ FJALOR I ORIENTALIZMAVE NË GJUHËN SHQIPE (Rreth 4500 fjalë me prejardhje nga gjuhët turke, arabe dhe perse), Botues: Instituti Shqiptar i Mendimit dhe Qytetërimit Islam (AIITC) dhe Organizata për Arsim, Shkencë dhe Kulturë (ISESCO), Tiranë 2005.

Asnjëher më tepër se sot nuk duhet punuar për përcaktimin e terminologjisë fetare të gjuhës shqipe. Ne si Institut në dekadën e fundit kemi botuar shumë tituj librash, botojmë revisten shkencore Univers, si dhe një numër periodikësh të karakterit kulturor e informativ. Por jo vetëm ne, pasi në Shqipëri, Kosovë, Maqedoni, Mal të zi, Preshevë, pastaj edhe në diasporë kemi me dhjetëra institucione islamike, shtëpi botuese të pavarura e botime të veçanta ku terminologjia fetare nuk është e unifikuar dhe që dallimet nga një shtëpi botuese tek tjetra janë mjaftë të mëdha.

Prandaj edhe duhet çuar më tutje kjo punë që sot po hudh edhe jë hap më tutje këtu në Prishtinë. Dhe kushtet janë më se të favorshme për ta bërë këtë, por duhet punë dhe më shumë vëmendje e kujdes nga institucionet që mbajnë përgjegjësi direkte për këtë çështje siç është Akademitë e Shkencave në Tiranë e Prishtinë, Instituti i Gjuhësisë dhe ai Albanologjik, fakultetet e gjuhës dhe letërsisë etj. Në këtë mendoj duhet përfshirë më tepër edhe Fakulteti i Studimeve Islame në Prishtinë dhe ai i Shkencave Islame në Shkup.

Është e pafalshme dhe nuk duhet të tolerohet që sot fjala Islam që përfaqëson besimin e shumicës dërmuese të shqiptarëve të mos ketë një shprehje të përbashkët për të gjithë, pasi ajo akoma diku shqiptohet Islamizëm, shkruhet në libra musliman kur në fjalor e kemi të shkruajtur mysliman, dhe kur mundësitë e unifikimit të tyre janë më së të mundshme.

Disa shembuj nga shtrebrërimet dhe keqkomentimi i terminologjisë islame edhe në fjalorët e sotëm të gjuhës:

HAXHI – Titull që u jepet besimtarëve kur shtegtojnë në vendet e ashtëquajtura “të shenjta” (në Mekë a në Jerusalem); ai që ka marrë këtë titull (në vendet ku vepron feja).

KURAN – Libër që përmban dogmat e fesë myslimane dhe legjenda të ndryshme mitike.

KURBAN – ..bagëti që therej kur fillonte ndërtimi i një shtëpie gjoja për të sjellë mbarësi.

MYSLIMANIZËM – Fe që sipas gojëdhënës është krijuar në shekullin VII nga Muhamedi dhe që përhap e mbron dogmat e kuranit.⁸

⁸ FJALOR I SHQIPES SË SOTME (me rreth 34.000 fjalë), Tiranë 1984.

Tashmë dihet se me rënien e bastionit komunist në europën lindore e për pasojë edhe në trojet shqiptare, një pjesë e terminologjisë islame është riaktivizuar sërish, kjo me një dimension edhe më të gjerë, pasi kërkesat dhe interesimi si nga masat e popullit ashtu edhe nga institucionet teologjike islame etj., janë në një standard ndër më të lartët krahasuar me dy shekujt e fundit e ndoshta edhe më gjatë.

Për të përfunduar do të thoja se trajtimi në nivele akademike-shkencore i problemit të terminologjisë fetare në përgjithësi dhe i asaj islame në veçanti është sot një kërkesë e kohës, dhe shumë e domosdoshme, pasi kjo do të kontribojë në planin gjuhësor edhe në unitetin e shqiptarëve si dhe në ridimensionimin e vlerave të tjera kombëtare të popullit tonë.

Dr. Qazim QAZIMI

STANDARDIZIMI I TERMINOLOGJISË ISLAME, ÇËSHTJE QË KËRKON ZGJIDHJE

Nuk ka dyshim se terminologjia Islame në gjuhën shqipe ka gjetur mbështetje në terminologjinë e përgjithshme islame, në terminologjinë islame turke, perse, por edhe në pasuritë dhe bukuritë e gjuhës popullore, ngase nga gurrë e saj, shumë herë, e ka edhe burimin. Terminologjia Islame shqiptare vazhdimisht është mbështetur mbi bazën e islamistikës, të gjuhës, të frazeologjisë dhe të figuracionit popullor, por edhe në gjuhën artistike të letërsisë shqiptare islame. Në këtë terminologji nuk mungojnë as shprehjet e bukura e të gjalla të gjuhës shqipe, fjalë ekspresive etj. Shprehjet dhe nocionet gjuhësore shqiptare islame në masën më të madhe janë mbështetur në literaturë burimore islame por edhe në bazën e të folmes së popullatës vendore, të kultivuar, të zgjeruar dhe të konsoliduar dukshëm nga vetë ajo.

Është realitet i pamohueshëm se terminologjia islame nganjëherë është e ngarkuar, ndoshta detyrimit, me shumë orientalizma e terma autoktone islame. Kështu, terminologjia islame në shqipe mbetet në kuptimin e mirëfilltë të fjalës klasike, që i përgjigjet raportit të saj ndaj botës islame që e rrethon. Me gjithë përparimin e dukshëm e të avancuar të standardizimit të gjuhës shqipe në përgjithësi, terminologjia Islame në gjuhën shqipe edhe më tutje vazhdon të jetë e varfër, stereotipe, e thatë, e paqartë dhe nganjëherë e mbytur në skema e modele të gjuhëve të huaja.

Ç'është e vërteta, Islami si fe por edhe shkencat e islamistikës, për shkak veçorive dhe specifikave të tyre, kanë terminologjinë e vet, të ndryshme nga çdo terminologji tjetër. Dhe, vetëm ajo është në gjendje t'i shprehë porositë e të së vërtetës islame dhe ta sjellë njeriun tek ajo. Do të ishte e thjeshtësuar por edhe gabim të thuhet për terminologjinë islame se

është terminologji arabe, turke, perse apo të një gjuhe kombëtare, edhe pse ajo në të shumtën e rasteve është me etimologji arabe, në realitet ajo është përvetësuar si terminologji islame, dhe si e tillë, është përqafuar anë e kënd botës islame, duke mos përjashtuar edhe ndonjë specifikë vendore.

Duhet të theksohet se arabishtja i përket familjes së gjuhëve semite, ndërsa terminologjia islame, si që u cek, në të shumtën e rasteve është me etimologji arabe, andaj nuk është çudi që në arabishte të ekzistojnë disa fonema e tinguj që nuk i gjejmë në gjuhët Indo-evropiane, sikundër që nuk i gjemë disa tinguj të gjuhëve Indo-evropiane, e në këtë rast, të gjuhës shqipe në gjuhën arabe, prandaj drejtshqiptimi sikundër edhe drejtshkrimi (transliterimi i tyre), përveç tjerash, paraqet vështërsi edhe të natyrës fonetike. Për të arritur njësimin dhe standardizimin e terminologjisë islame në gjuhën shqipe dhe për të ju shmangur laramanive, konsideroj se duhet ndryshuar disa fenomene-dukuri që janë futur në terminologji islame shqiptare, të bastarduara nga origjinali dhe janë keqpërdorur, e që kërkojnë përmirësim dhe zgjidhje të drejtë e të qëndrueshme në të gjitha shtresat e sistemit të saj.

Fenomeni i shndërrimi i **U**-së në **Y**, drejtshkrimi dhe drejt shqiptimi i nyjës shquese (**EL**-), drejtshqiptimi dhe transliterimi i shenjës së dyfishimit (**teshditit**), përdorimi i **disa shenjave** për adaptimin-përshtatjen e alfabetit të shqipes për shkrimin dhe transliterimin e arabishtes me shkronja shqipe, do të jenë temë shtjellimi i kumtesës time.

Fenomeni i shndërrimi i U-së në Y.

Nisur nga fakti se terminologjia Islame tek shqiptarët, dukshëm dhe në masë të madhe, në kohë pak sa më të hershme, ka arritur përmes turqve, tek një numër i konsiderueshëm emrave dhe i termeve islame zanoreje **U**, në fjalët me orgjinë arabe, në gjuhën shqipe janë shndërruar në **Y**, sikur që shihet nga termat, emrat dhe shprehjet vijuese:

Dunja- Dynja, Mual-lim- Myalim, Mubtela- Mybtela, Muderris- Myderriz, Mudir-Mydir, Mufti-Myfti, Musliman-Mysliman, Munafik- Mynafik-, Munasib- Mynasib, Mumkin-Mymkin, Mutlak-Mytlak- (absolut), Murat- Myrat, Muxhize-Myxhize-, Mulk-Mylk, Musafir- Mysasfir, Mushteri-Myshteri, Mutesarrif-Mytesarif, Muhtar- Myhtar, Nusret- Nysret, Kufer-Kyfer-Qyfter- mohim i Zotit, Sulejman-Sylejman, Suhur-Syfyf,

Sunet-Synet, Suret-Syret (Fotografi), Shubhe- Shybhe, Shuqyri-Shykri, Umer-Ymer, Zumer-Zymer etj.

Dihet mirëfilli se në gjuhën arabe zanorja -Y-nuk ekziston fare dhe fenomeni i shndërrimit të U-së të fjalët me etimologjia arabe në Y tek nocionet, emrat dhe terminologjitë shqiptare islame, si që vërejtëm më sipër, është rrjedhojë e ndikimit të terminologjisë islame turke. Këtë dukuri (shndërrimin U-së në Y-) nuk e hasim tek Familja e Gjuhëve semite e as tek ato indoevropiane, ndërsa tek grupi i Gjuhëve Sllave (ta zëmë, tek boshnjakët dhe muslimanët maqedon), sikundër edhe në arabishte, zanorja Y, nuk ekziston fare. Kujtoj se është e udhës dhe më mirë që këto terme, nocione dhe emra në shqipe, të përdorën si në origjinal (donë të thotë me U), dhe krejt kjo duhet bërë në shërbim të standardizimit të gjuhës shqipe dhe njësimit e këtyre termeve, në rend të parë, aty ku folët e shkruhet e lexohet shqip, e më pastaj edhe njësimit e tyre me gjuhët e muslimanëve tjerë anë kënd botës. Edhe pse në leksikologjinë e gjuhës shqipe janë pak fjalë të kësaj natyre, shpreh bindjen se është më mirë që këto fjalë të përdorën si në origjinal, nga kah e kanë origjinën dhe kjo për shqipen nuk paraqet kurrfarë problemi. Kohëve të fundit, po vërehet më të madhe se brezi i ri, ata të cilët kanë studiuar në botën arabe, e që i njohin fjalët në origjinal, po i përmbahen terminëve dhe nocioneve sipas origjinalit dhe nuk po e përfillin shndërrimin e U-së në Y, siç po e preferon drejtshkrimori i gjuhës shqipe. Ky fenomen shihet në botimet e "LOGOS-it"¹ por edhe tek botuesit tjerë.

Drejtshkrimi dhe drejt shqiptimi i nyjës shquese - (El-أل)

Në gjuhën arabe, përveç të tjerash, emri ka edhe kategorinë e shquarsisë dhe të pashquarsisë.² Përderisa nunimi (tenvini) dihet se është veçori e emrit dhe shenjë e pashquarsisë së tij, nyja shquese (أل) është karakteristikë e emrit dhe shenjë e shquarsisë së tij. Arabishtja ka specifikat e veta në përdorimin e emrave në trajtë të shquar dhe në atë të pashquar. Një prej veçorive të emrit në trajtën e shquar është nyja shquese - (El- #

Shkronja Lamun (ڤ, tek nyja shquese (ڤ, kur ndodhet para shkronjave të ashtuquajtura diellore (

Në realitet, kjo nyje, që është si një lloj parashtese për ta bartë emrin nga trajta e pashquar në trajtë të shquar, është veçori e emrit dhe nuk paraqitet tek pjesët tjera të ligjëratës në gjuhën arabe. Por, absurdi ndodhë kur kjo nyje shkruhet me shkronjë të vogël (el-) në fillim të ligjëratës, pas kryerreshtit, pas pikës, në fillim të emrave të përveçëm, në fillim të emrave të institucioneve, në fillim të emrave gjeografik, në fillim të emrave historik etj. gjë që, sipas mendimit tonë është në kundërshtim me rregullat e gjuhës shqipe. Nuk ekziston kurrfarë pengese gramatikore e as formale që edhe për këtë nyje të aplikohen rregullat e përgjithshme gramatikore të gjuhës shqipe. Thënë ndryshe, aty ku e kërkon drejtshkrimi i shqipes dhe natyra e saj që fjalët të nisen-të shkruhen me shkronjë të madhe apo të vogël, i njëjti standard mund dhe duhet të aplikohet edhe me emrat, nocionet dhe terminologjitë islame që në fillim kanë nyjën shquese (EL-) dhe, kjo nuk parqet kurrfarë problemi as për fjalën me origjinë arabe e as për drejtshkrimin e gjuhës shqipe. Ta themi edhe këtë se në të gjitha përkthimet e kuptimeve të Kur'anit në gjuhët:⁶, anglishte⁷, boshnjakishte⁸, në turqishte⁹, tek shënimi i emrave të sureve nyja shquese El-, ose AL-në anglishte, por edhe në shqipe me ndonjë përjashtim janë shënuar me shkronjë të madhe.

الشَّيْءُ

Fjala All-llah, Muhammed, Xhennet, xhehenem në arabishte, me grafi arabe, shkruhen me një shkronjë, por mbi të vihet shenja e përforcimit #

përafërt për shqiptarët do të ishte të thuhet \$ alid, \$ alil, \$ alif, \$ ajdar, \$ aber, se sa Khalid, Khalil, Khalif, Khajdar, Khaber.

Përdorimi i dy shkronjave identike me tinguj të ndryshëm, e me pak dallim në formë, nuk do të ishte një gjë krejtësisht e re në adaptimin e alfabetit shqip për atë ta shënuar atë të arabishtes. Një veprim i tillë ndodh edhe në alfabetin e gjuhëve të tjera pra edhe në vetë arabishten, ku kemi grafi-shkronjash identike për kah forma, e që shënojnë tinguj të ndryshëm, dhe dallimi në mes tyre në formë behët vetëm përmes shenjave gjegjësisht pikave, siç është rasti tek shkronjat binjake e bile dhe trinjake të arabishtes;

Ju faleminderit#

Nexhat IBRAHIMI

ZHVILLIMI I TERMINOLOGJISË FILOZOFIKE ISLAME NË MESJETË

**(Burimet, prejardhja, karakteristikat dhe prapavija historike e
zhvillimit të terminologjisë filozofike islame në Mesjetë)**

Moto:

“Evropianët, duke pasur mendime të prapambetura e të errëta për Kur’anin e Madhërueshëm për një kohë të gjatë nuk e pranuan filozofinë islame, por kur i shfletuan veprat filozofike të muslimanëve dhe kur panë aty përparimet e mëdha të tyre në këtë fushë të dijes; kur panë se Kur’ani Kerim, që është një filozofi më vete, nuk e ndalon filozofinë, por përkundrazi, e urdhëron dhe e këshillon atë në çdo faqe të tij, e kuptuan dhe më në fund e pranuan të vërtetën.” Sami Frashëri.¹

I. Shqyrtime të hyrëse

1. Trajtimi i lëndës me titullin e lartëtheksuar është punë sa interesante dhe kureshtare, aq është edhe e vështirë, delikate dhe komplekse. Kureshtia e temës konsiston në faktin se tema të hedhë nga bregu në breg, nga kultura në kulturë, të hedhë në horizonte të pakufishme të feve, kulturave dhe qytetërimeve të ndryshme. Po ashtu, kureshtia dhe rëndësia e temës konsiston edhe në çështjen se terminologjia numërohet ndër elementet që lënë vragë më të thella në kulturat e popujve, sepse nëpërmjet saj përcaktohet edhe konceptimi edhe mënyra e të menduarit.²

¹ Sami Frashëri, Qytetërimi islam, vepra 13, Shkup, 2004, fq. 88.

² Muhammed Umhazun, Koncept izucavanja islamske historije, Sarajevë, 2000, fq. 77-80.

Kurse vështirësia e temës konsiston në mosekzistimin e një pune paraprake në nënqiellin tonë, por as në botën muslimane. Vështirësi tjetër është joharmonizimi i terminologjisë filozofike islame te ne. Dallimet janë rezultat i ndikimit të traditave të ndryshme dhe i pikëpamjeve dhe prirjeve individuale, por edhe i mosnjohjes së problematikës, e jo rezultat i një pune të gjatë dhe sistematike hulumtuese-shkencore.

Për një punë të mirëfilltë shkencore-hulumtuese nevojiten shumë punë papapërgatitore, siç janë edhe këta punime dhe ky tubim dhe punë interdisiplinare të shumë studiuesve të kualifikuar.

2. Lënda e këtij punimi është **terminologjia mesjetare filozofike islame** dhe ka për qëllim hulumtimin e prejardhjes së terminologjisë filozofike dhe karaktërsitikat themelore në pika të përgjithshme, kryesisht nga pikëpamja e historisë së filozofisë mesjetare.³

Periodha në të cilën sajohet dhe formësohet terminologjia mesjetare filozofike islame, në shekullin IX dhe X, është arenë e fërkimeve dhe kontakteve dinamike e intensive e të dy kulturave dhe qytetërimeve, greko-bizantine dhe islame, por edhe e këmbimit dhe e përvetësimit të trashëgimisë së tjetrit, jo vetëm filozofike, por edhe të tjera.⁴ Disa autorë pohojnë se kjo kohë karakterizohet me këmbim intenziv të ideve ndërmjet dijetarëve nga një anë dhe këmbimit e përshkrimit të librave ndërmjet bibliotekave dhe i përkthimit të tyre në gjuhë të ndryshme: induse, persiane, greke, latine, arameite, hebraike e të tjera në gjuhën arabe.⁵ Pa dyshim, periudha kohore dhe hapësira gjeografike e hulumtuar ofron material të

³ Një pjesë e traditës muslimane e ka refuzuar filozofinë si të huaj, joislame dhe madje *antikur'anore* dhe *antisunnetike*. Mendojmë se refuzimi i tillë nuk ka qenë i bazuar në frymën e mirëfilltë islame, por në momentet konkrete, të motivuara politikisht apo nga interesat e ngushta subjektive. Mendojmë se në këtë rast sinkretizmi është karakteristikë e islamit shpirtëror kundrejt traditave paraprake dhe paralele shpirtërore. Islami asnjë nga ato tradita nuk e ka refuzuar tërësisht, por as pranuar tërësisht. Prej tyre ka marrë vetëm atë që i ka shërbyer për ngritjen e identitetit vetjak, autonom dhe specifik. Filozofia nuk mund të vendoset mbi Shpalljen, as t'ia nënshtrojë Shpalljen kriterëve specifikë filozofike. Shih: Muhamed Mrahorovic, *Filozofijska razmedja islamske duhovnosti*, Sarajevë, 2001, fq. 222-223.

⁴ Gjatë studimit të kësaj teme duhet pasur parasysh është se filozofia mesjetare ka pasur pozitë nënshtruese kundrejt teologjisë, andaj edhe shumë shprehje dhe koncepte filozofike duhet kuptuar në këtë frymë. Kjo gjendje ka qenë e shtrirë në Perëndim, por në masë të caktuar edhe në Lindjen islame. Shih: Salih H. Alic, *Arapsko-islamska filozofija*, definicija i znacaj u istoriji, në: *Prilozi za Orijentalnu Filologiju*, XXIV/1974, Sarajevë, 1976, fq. 109-111.

⁵ Ajatollah Misbah Yazdi, *Islamska filozofija*, 1, Sarajevë, 2004, fq. 17.

pasur dhe të llojllojshëm kulturologjik, sociologjik, letraro-historik dhe psikologjik për hulumtim, por këtë radhë, për shkak të synimit të kufizuar të punimit, aspektet tjera do të mbesin jashta shqyrtimeve tona.⁶

Duhet pranuar se, dekadave të fundit, në të gjitha gjuhët e rëndësishme evropiane janë bërë përpjekje dhe janë shkruar studime lidhur me emërtimet, terminologjinë filozofike islame.⁷ Në këtë rrafsh është punuar diç edhe në gjuhët më afër nesh, boshnjako-kroato-serbe, kurse emrat e Daniel Buçanit, Tarik Haveriqit, Enes Kariqit, Reshid Hafizoviqit janë vetëm disa nga ata që kontribuan në hyrje të shkencës së historisë së filozofisë islame dhe të terminologjisë së saj. Në gjuhën shqipe kjo punë pritet të bëhet. Puna e Sami Frashërit dhe të tjerëve më herët ende është e pastudiuar dhe nuk mund të flasim për një të kaluar në këtë pikëpamje.⁸

II. Burimet për hulumtimin e terminologjisë filozofike islame

Burimet më të rëndësishme për hulumtimin dhe studimin e terminologjisë mesjetare islame janë burimet islame: Kur’ani dhe Sunneti dhe burimet dytësore islame.⁹ Të ndikuar nga Kur’ani, arti dhe letërsia është pasuruar në masë të jashtëzakonshme.¹⁰ Përkthimi i veprave filozofike greke

⁶ Një kontribut fillestar dhe konstruktiv në këtë pikëpamje e ka dhënë: Tarik Haveric, *Srednjovjekovno filozofijsko nazivlje u arapskom jeziku*, Sarajevë, 1990, fq. 7 e tutje.

⁷ Louis Massignon, Amelie-Marie Goichon, Ibrahim Madkur, Abdurrahman Badawi etj. kanë bërë një punë të madhe, natyrisht më tepër në relacionin latinisht - arabisht. Sipas: Tarik Haveric, op. cit., fq. 10.

⁸ Kontributi i akad. Ekrem Murtezait në aspekt të terminologjisë fetare dhe filozofike dhe të personaliteteve muslimane në kuadër të **Fjalorit filozofik** dhe **Fjalorit të feve**, ndonëse i përgjithësuar, meriton vëmendje shkencore. Shih: Ekrem Murteza, *Fjalor i filozofisë*, Prishtinë, 1995 dhe *Fjalor i feve*, Prishtinë, 2000.

⁹ Është për keqardhje që filozofi boshnjak, T. Haveriq, (për shkak të bindjeve ateiste) në veprën e tij mjaft analitike, që në punimin tonë i referohemi më së tepërmi në shumë aspekte, injoron burimet islame (Kur’anin, Hadithin etj.) si burim të hulumtimeve të terminologjisë islame. Por, Salih H. Aliq, filozof tjetër, pohon se “filozofia në islam ka pasur dy burime, nga të cilat më vonë ka zhvilluar dy drejtime shprehimisht tjetërfare të filozofimit” e ata janë: i pari “brenda vetë traditës islame fetare” dhe i dyti “trashëgimia filozofike greke.” Salih H. Alic, op. cit., fq. 112-114 dhe 115 e tutje.

Për burimet e meditimt filozofik në islam lexo: Seyyed Hossein Nasr – Oliver Leaman, *History of Islamic Philosophy*, part I, Teheran, Iran, pa vit botimi, fq. 27-39. M. M. Sharif, *Historija Islamske Filozofije*, I, Zagreb, 1988, fq. 159 e tutje. Po ashtu: Henry Corbin, *Historia e filozofisë islame*, I-II, Shkup, 1997, fq. 13-32.

¹⁰ Shih gjerësisht: : Ismail Raju al-Faruqi and Lois Lamya al-Faruqi, *The Cultural Atlas of Islam*, New York & London, (1986 ?), fq. 342-353.

në gjuhën arabe¹¹ në rend të parë dhe i veprave burimore të filozofëve islamë dhe të fjalorëve mesjetarë arabë të terminologjisë profesionale në rend të dytë.¹²

1. Burimet islame

Burimet islame për hulumtimin e terminologjisë filozofike islame janë brenda Kur'anit dhe Hadithit dhe natyrës së tyre të hapur dhe konstruktive kundrejt vlerave njerëzore. Burim është edhe gjuha arabe e bazuar në Kur'an, e cila me kalimin e kohës mundësoi zhvillimin e shprehjeve shumë të pasura.¹³ Mirëpo, menjëherë pas vdekjes së Muhammedit a. s. filluan të formohen shkollat, drejtimet, sektet e shumta teologjike, juridike dhe më vonë edhe filozofike. Synimi dhe dëshira që secila në mënyrën e vet të përpiqet t'i arsyetojë pikëpamjet dhe shikimet mbi rregullimin e raporteve të njeriut me Krijuesin, vetveten dhe rrethin ku jeton, ndikoi të krijohen pikëpamje dhe teori të ndryshme e krahas kësaj edhe terminologji e shumtë, e pasur dhe interesante për historinë e leksikografisë, të teologjisë dhe të jurisprudence¹⁴, që do të ekzistojë deri në ditët e sotshme.

2. Përkthimet e veprave filozofike greke në gjuhën arabe

Interesimi më sistematik dhe më shkencor për filozofinë islame nga perëndimorët u paraqit pas shekullit XVIII.¹⁵ Filloi interesimi për

¹¹ Umer Ferruh thekson se përkthimet e para greke në gjuhën arabe i kemi shumë herët, madje qysh në kohën e Muaviut dhe Jezidit. Umer Ferruh, *Tarih'ul-fikri'il-arabijji ila ejjami Ibn Haldun*, botimi IV, Bejrut, 1983, fq. 271. Shih edhe faqet: 271-286.

¹² Si burime ndërmjetëse mes veprave burimore islame dhe të fjalorëve profesionalë arabë janë edhe veprat e tipit *Kitab'ul-hudud*. Sipas: Tarik Haveric, op. cit., fq. 13.

¹³ Seyyed Hossein Nasr, *The Qur'an and hadith as source and inspiration of Islamic philosophy* në: Seyyed Hossein Nasr – Oliver Leaman, *History of Islamic Philosophy*, part I, Teheran, Iran, pa vit botimi, fq. 27e tutje. Krhs.: Teufik Muftic, *Gramatika arapskoga jezika*, Sarajevë, 1998, fq. 19 e tutje. Teufik Muftic, *Klasicna arapska stilistika*, Sarajevë, 1995, fq. 11.

¹⁴ Një pasqyrë të shkëlqyeshme të periudhës së hershme të shkollave dhe sekteve mund ta gjejmë te: El-Imam Ebi'l-Hasan Alij ibn Ismail El-Esh'arij, *Kitabu mekalat'il-islamijjin ve ihtilaf'il-musal-lin*, botimi III, Wiesbaden, 1980. Në gjuhët evropiane lexo: Henri Laoust, *Raskoli u islamu*, Zagreb, 1989. Për ndikimin reciprok të akaidit dhe gjuhës shih: Teufik Muftic, *Klasicna arapska stilistika*, op. cit., fq. 13.

¹⁵ Orientalisti serb Rade Bozhoviq mendon se interesimi për gjuhën arabe në Evropë është paraqitur "qysh në mesjetën e hershme, por arabistika, si disiplinë shkencore në kuadër të orientalistikës, themelohet nëpërmjet shkollës holandeze të semiologëve në shek.

përkthimet arabe e jo për përkthimet latine të përkthimeve arabe. Por vetëm pas luftës së II botërore filloi studimi dhe botimi sistematik dhe metodik i përkthimeve arabe të veprave të filozofëve grekë. Sigurisht se merita kryesore i takon egjiptianit Abdurrahman Bedeviut, i cili botoi edhe tekstet e Plotinit dhe të neoplatonistëve.¹⁶

Rëndësia e këtyre burimeve është e padiskutueshme, sepse drejtpërdrejt njoftohemi me mënyrën e përkthimit të teksteve dhe të terminologjisë filozofike dhe të tjera.¹⁷

3. Veprat burimore të filozofëve islamë

Nëse ndjekim rrjedhën kronologjike, **veprat burimore të filozofëve islamë** janë të rendit të dytë. Numri i përkthyesve në fund të shekullit VIII filloi të rritej, për të gjetur kurorë me El-Kindiun (801-865), pastaj me El-Farabiun (870-950), Ibn Sinain 950-1036), Ibn Baxhën (?-1138), Ibn Tufejlin (?-1185), Ibn Rushdin (1126-1198) etj. Mirëpo, burimet arabe nga përkthimet greke janë bërë të njohura shumë vonë; kanë filluar në shekullin XIX kurse shumica janë bërë në shekullin XX, me përjashtime të vogla. Meritën kryesore e kanë F. Dieterici (vd. 1903), M. Bouyges (vd. 1945), por edhe L. Gauthier, P. Kraus etj.¹⁸

Këta filozofë që linden dhe u rriten në korelacion me filozofinë greke quhen filozofë të frymëzuar helenistë. Kështu i ka quajtur edhe H. Corbin.¹⁹

Kemi edhe një grup tjetër të filozofëve të cilët kanë hartuar vepra të llojit të leksikonëve, *Kitab'ul-hudud*, me të cilët janë përpjekur t'i përcaktojnë kuptimet e shprehjeve të caktuara. Edhe këtu El-Kindiu dhe Ibn

XVII dhe XVIII." Sipas: Rade Bozovic, Udzbenik arapskog jezika sa vjezbankom i rjecnikom, Botimi I, Sarajevë, 1984, fq. 9.

¹⁶ Për këtë problematikë lexo: Tarik Haveric, op. cit., fq. 14. Ibrahim Madkur, Fi'l-felsefet'il-islamijeh, II, pa vit dhe vend botimi, fq. 164 e tutje.

¹⁷ Motivi i dijetarëve muslimanë të përkthejnë filozofinë greke ishte i qartë. Fjalët e El-Kindiut njoftojnë qartë: "Në citate të plota të tubohet çdo gjë që të lashtit (dmth. grekët) kanë thenë për sendin (objektin) dhe të plotësohet ajo që të lashtit nuk e kanë shprehur mjaft, dhe këtë me mjetet e gjuhës sonë arabe dhe sipas traditave të kohës sonë dhe sipas aftësisë sonë vetjake." Walzer, Greek into Arabic, fq. 13, në: Salih H. Alic, op. cit., fq. 115.

¹⁸ Ahmed Fuad El-Ehwani, Filozofia islame, Prizren, 2002, fq. 38-58. Tarik Haveric, op. cit., fq. 14-15 dhe fusnotat: 9, 10, 11, 12.

¹⁹ Henry Corbin, Historia e filozofisë islame, I-II, Shkup, 1997, fq. 167 e tutje. Arapsko-islamski uticaj na evropsku renesansu, Sarajevë, 1987, fq. 120-130.

Sinai janë të shkëlqyeshëm.²⁰ Njëherit këto vepra janë hyrje në veprat e specializuara, në fjalorët e mirëfilltë të filozofisë dhe diturive të tjera.

4. Fjalorët mesjetarë arabë të terminologjisë profesionale

Fjalorin e parë sistematik mbi terminologjinë profesionale arabe e kemi nga Ebu Abdullah Muhammed El-Hawarizmi (nga shekulli X). Vepra e tij *Mefatih'ul-ulum*. Ky fjalor përfshinë fjalët nga të gjitha dituritë e asaj kohe dhe ka shërbyer deri në shekullin XIX.

Fjalori vijues me rëndësi është ai i Mir Sejjid Sherif Xhurxhanit (1339-1413), me emrin *Kitab'ut-ta'rifat* (Libri i njësive), i cili “është fillesë e fjalorit të ardhshëm të madh të emërtimeve teknike të filozofëve të shprehjes gjuhësore arabe.”²¹ Për shumë kohë ky fjalor do të shërbejë si strumbullar.

Mirëpo, fjalori që do të jetë kurorë e fjalorëve është ai i Alij ibn Alij Et-Tahaneviut (vd. 1745), nga India, *Keshshaf istilahat 'ul-ulum we'l-funun*, i cili ndonëse me kohë është i Kohës së re (në Kalkutë, më 1861), me frymë është mesjetar dhe sigurisht njëri prej fjalorëve më gjithëpërfshirës me shprehje teknike.²²

Ndër fjalorët filozofik modern të koncipuar është ai i Xhemil Salibas, me titull *El-Mu'xhem'ul-felsefij*, i cili ka mangësitë dhe përpartësitë: mangësitë konsistojnë sepse ky fjalor është më i varfër sa i përket terminologjisë së vjetër dhe nuk përmbanë shpjegime të hollësishme, kurse përparësitë konsistojnë në faktin se shpjegimet e terminologjisë filozofike të kohës së re janë të plota dhe të hollësishme.²³

Si burime parësore për studimin dhe hulumtimin e prapavisë historike të krijimit të terminologjisë filozofike islame, të kontakteve të para të qytetërimit islam dhe bizantin, të njohjes së historikut të lëvizjeve të përkthyesve, analet e jetës dhe veprës së përkthyesve, janë të pakalueshëm edhe fjalorët biografikë dhe bibliografikë dhe shënimet e tyre të pasura.

²⁰ Tarik Haveri, op. cit., fq. 15.

²¹ Henry Corbin, Historia, op. cit., fq. 303. Shih: Ismail Raju al-Faruqi and Lois Lamya al-Faruqi, The Cultural Atlas of Islam, New York & London, (1986 ?), fq. 239.

²² Ibid, op. cit., fq. 284. Shih: I.R. al-Faruqi and L.L. al-Faruqi, The Cultural, op. cit. fq. 239.

²³ Xhemil Saliba, El-Mu'xhem'ul-felsefijji bi'l-elfadh'il-arabijjeti we'l-frensijjeti we'l-inklizijjeti we'l-latinijeh, I-II, Bejrut, 11414 h./1994, fq. 17.

Ndër fjalorët e këtillë në vend të parë duhet theksuar veprën **El-Fihrist** të Ibn Is'hak En-Nedimit (shek. X) nga Bagdadi²⁴, veprën **Ujun'ul-enba'i fi tabekat'il-etibba'** të mjekut Ebu'l-Abbas Ahmed Ibn Ebi Usajbia (shek. XIII), **Tarih'ul-hukama** e Zavzaniut etj.²⁵ Por, vepra më vëllimore është **Keshf'udh-dhunun** të poligrafit/polihistorit turk Haxhi Halife me nofkën Katib Çelebiu (1609-1657).²⁶

Burimet dytësore për studimin dhe hulumtimin e prapavisë historike të krijimit të terminologjisë filozofike islame janë përkthimet më të hershme të veprave filozofike islame në gjuhën latine dhe të tjera, të cilat ndonjëherë janë përcjellë me fjalorë profesionalë dy-tre gjuhësorë dhe studimet e specializuara të filozofëve, orientalistëve dhe historianëve të filozofisë islame.

Në pamundësi që ta ndjekim historinë e përkthimit të veprave filozofike islame, sepse kjo detyrë do t'i kapërcente mundësitë tona intelektuale por edhe materiale, kohore dhe hapësinore, do të theksojmë se **Miguel Asin Palasios**, pastaj **Enciklopedia islame** nga evropianët (sidomos botimi II), **Amelie-Marie Goichon** etj. kanë dhënë kontribut të madh. Por, punën më gjithëpërfshirëse e ka bërë **Suheil M. Afnan**, në veprën tashmë shumë herë të përmendur "Philosophical lexicon in Persian and Arabic", "Philosophical terminology in arabic and persian" etj..²⁷ Me rëndësi është edhe puna e **Abdurrahman Bedeviu**²⁸ dhe e **Ahmed Emini**²⁹

III. Prejardhja e terminologjisë filozofike islame

Letërsia e vjetër dhe shkrime të caktuara të asaj kohe i kanë ndihmuar përkthyesve dhe filozofëve si model në punën e tyre të përkthimit dhe

²⁴ F. E. Peters, The Greek and Syriac background, në: S. H. Nasr – O. Leaman, op. cit., pp. 41-43.

²⁵ Shih: Tarik Haveri•, op. cit., fq. 18.

²⁶ Shih: Tarik Haveri•, op. cit., fq. 18. Nerkez Smailagic, Leksikon, op. cit., fq. 227-228.

²⁷ Shih: Tarik Haveri•, op. cit., fq. 21-22.

²⁸ Abdurrahman Bedevi, La transmission de la philosophie greeque au monde arabe, Paris, 1968, dhe Abdurrahman Bedevi, Eflatun fi'l-islam, bot. III, Bejrut, 1402 h./1982 etj. Shih edhe: Tarik Haveri•, op. cit., fq. 24.

²⁹ Ahmed Emin, Duh'al-islam, I, botimi X, Kairo, 1984, fq. 253-288.

Për lexuesin shqiptar kanë rëndësi edhe veprat: Ahmed Fuad El-Ehwani, Filzofia islame, Prizren, 2002 dhe Henry Corbin, Historia e filozofisë islame, I-II, Shkup, 1997, të cilat sjellin të dhëna të shumta për historinë e përkthimeve dhe informacione të tjera.

shkrimit. Mirëpo, llojllojshmëria e ndikimeve letraro-historike qartë tregon se nuk mund të flitet për një ndikim, respektivisht për një prejardhje unike³⁰, por për një vastër prejardhesh. Ndërkaq Suheil M. Afnan, terminologjinë filozofike islame e lidhë me zhvillimin e prozës paraislamike arabe, e cila sot thuhet nuk ekziston dhe në pjesë të caktuara të Kur'anit, aty ku është i theksuar sexh'i, apo proza e rimuar.³¹

Suheil M. Afnan dhe shkencëtarë të tjerë, dallojnë tri lloj veprash prozaike që u krijuan në dekadat e para të islamit, dhe të cilat më tepër do t'u shërbejnë përkthyesve të veprave greke si model në aspekt të stilit se sa të terminologjisë³²:

1. Proza religjioze

Prozë religjioze quhet çdo formë letrare e lidhur me jetën religjioze, në rend të parë shkrimet mistike, por edhe fjalimet e liderëve të parë muslimanë, të cilët kryesisht janë të lidhur ngushtë me pejgamberinë islame.³³

2. Letërsia mu'tezilite

Letërsia mu'tezilite qëndron ndërmjet prozës religjioze dhe asaj profane. Zhvillohet në fillim të shekullit VIII. Mu'tezilitët kishin zhvilluar gjuhë profesionale të teologjisë, por kanë përdorur edhe disa shprehje filozofike. Herë-herë është vështirë të dallohet a është shprehja e caktuar nga mu'tezilitët apo edhe ata e kanë përvetësuar nga të tjerët.³⁴

³⁰ Sipas: Tarik Haveri•, op. cit., fq. 25.

³¹ Studiuesit e semantikës së Kur'anit e të tefsirit, nuk janë unanimë rreth çështjes se a ekziston sexh'i – proza e rimuar në Kur'an. Gjerësisht: Dzermaludin Latic, Stil kur'anskog izraza, Sarajevë, 2001, fq. 118 e tutje.

³² Soheil M. Afnan, Philosophical Terminology in Arabic and Persian. Leiden: E. J. Brill, 1964, pp. 13, sipas: Tarik Haveri•, op. cit., fq. 25.

³³ Shembull të tillë kemi **Nehxh'ul-belagah** të Aliut r. a. etj.

³⁴ Arapsko-islamski uticaj na evropsku renesansu, op. cit., fq. 107-142. Krhs.: Muhammed Iqbal, Razvoj metafizike u persiji: Prilog historiji muslimanske filozofije, Sarajevë, 2005, fq. 43 e tutje, ose: Muhammad Iqbal, The Development of Metaphysics in Persia – A Contribution of Muslim Philosophy, Sarajevë, 2005, pp. 43..

3. Letërsia profane

Mendohet se kjo letërsi është krijuar për herë të parë në periudhën e vonshme emevite.³⁵ Në këtë trajtë numërohet letërsia epistolare, ajo e oborrit mbretëror dhe letërsia artistike.

a) Letërsia epistolare. Letërsia epistolare, *kitaba*, u sajua në zyrat e pallatit, kurse është motivuar me nevojën befas të rritur që në territoret e reja të qeveriset administrativisht.³⁶ Në zyra janë të njohura me emrin persik *divan*.³⁷ Kjo shtresë, shpesh me prejardhje joarabe, i udhëhiqnin punët sipas shembullit të zyrës sasanidase. Themelues i këtij zhanri mendohet të jetë Abdulhamidi, sekretar i halifit të fundit emevit, Mervanit II. Fjalori i letërsisë arabe epistolare të periudhës së vonshme emevite ka përfshirë edhe shumë shprehje të cilat më vonë do të gjejnë vend në prozës filozofike.³⁸

b) Letërsia e pallatit mbretëror. Në këtë prozë bëjnë pjesë trajtesat mbi detyrimet e sunduesve, këshillat për sundim të mirë dhe veprat e udhëpërshkruesve iranianë për ngadhënjimet e sunduesve të tyre. Ky lloj krijimi megjithatë shkëput lodhjet me kasiden arabe dhe zhvillon traditën e vet, me stil më të rrjedhshëm e më subtil, dhe me karakter didaktik dhe ceremonial.³⁹ Këto vepra i siguronin, i përkthenin nga pahlevishtja, i kompilonin dhe i përshtatnin autorët / shkruarit e caktuar. Ndër më të njohurit në këtë aspekt kemi Ibn Mukaffen (720-756).⁴⁰

c) Letërsia artistike apo letërsia e bukur. *Letërsia artistike* apo *letërsia e bukur* është ajo letërsi me vlera të pastra letrare, synimi i së cilës është të tepër të argëtojë se sa të këshillojë, mësojë. Edhe në këtë zhanër kryesor është emri i Ibn Mukaffes.⁴¹

³⁵ Për këtë periudhë shih: Vojislav Simic, *Arapska knjizevnost umejadskog perioda*, në: *Mogucnost – knjizevnost, umjetnost, kulturni problemi*, nr. 8-9/1979, Split, fq. 891-925.

³⁶ Edhe pse shprehja *kitab* shpesh lajmërohet në Kur'an në kuptime të ndryshme, kuptimi parësor është për Librin e shenjtë, Kur'anin. Por, shprehja *kitab* ka edhe kuptimin e letrës së rëndomtë, ose të lajmërimit, kumtesës, që i dërgohet një personi që gjendet larg. Shih: Nerkez Smailagic, *Leksikon islama*, sarajevë, 1990, fq. 330.

³⁷ Për kuptimet e shumta të shprehjes *divan* në rrafshin teorik dhe praktik, historik lexo: Nerkez Smailagic, *Leksikon islama*, op. cit., fq. 126-132.

³⁸ Shih gjerësisht: Tarik Haveri•, op. cit., fq. 47-49.

³⁹ Nerkez Smailagic, *Klasicna kultura islama*, II, Zagreb, 1976, fq. 101-102.

⁴⁰ Persian, ndër krijuesit e pare të prozës artistike arabe, dhe njëri ndër përkthyesit e pare nga indishtja dhe persishtja në arabishtje. Sipas: *Mogucnost* op. cit., fq. 1124. Krhs.: Tarik Haveri•, op. cit., fq. 26.

⁴¹ Sipas: *Mogucnost*, op. cit., fq. 1124. Krhs.: Tarik Haveri•, op. cit., fq. 26-27.

Përkundër vërejtjeve rreth ndarjes së saktë të zhanreve të aspektin letrar, këto gjini letrare kanë rëndësi parësore në aspekt zhvillimit të leksikut përgjithësisht dhe terminologjisë filozofike islame në veçanti.⁴²

IV. Karakteristikat e terminologjisë filozofike islame

Në pikëpamje të zanafillës, sajimit, lindjes së terminologjisë, kemi disa grupëzime kryesore shprehjesh:

1. Fjalët greke janë përkthyer në gjuhën siriane/arabe me sukses relativ. Por, kur nuk mund të gjendej shprehje përkatëse, transliterohej fjala greke, duke e ruajtur shqiptimin e fjalës greke aq sa është e mundur. Ndonjë shprehje greke është transliteruar nga sirianishtja dhe shpesh nuk mund të identifikohet se është me prejardhje greke, sepse së pari sirianët e pastaj edhe arabët e kanë përshtatur për nevojat e fonetikës së tyre. Transliterimi ka vazhduar edhe atëherë kur sirianishtja nuk shërbente si gjuhë ndërmjetëse, por e drejtpërdrejtë për përkthime, në fillim të shekullit IX.⁴³ Edhe Ç. Veljaçiq mendon se sirianishtja ka qenë gjuhë shtyllë ndërmjet gjuhës greke dhe arabe.⁴⁴ Do të cekim disa shembuj:

Fjala greke

stoicheîon ka dhënë fjalën arabisht **ustuqus** > **element**;

aithér > **atir**;

philosophia > **filozofi**; **philosophos** > **fejlesuf** > **filozof**;

hylé > **hayula** > **send, gjë**;

nómos > **namus**.

Disa fjalë si **artimetika** (aritmatiqi) dhe **gjeometria** (xhumatriyya) fillimisht janë përdorur në original e më vonë këto shprehje janë zëvendësuar me shprehje nga gjuha arabe, si **hisab** dhe **ilm'ul-hendese**.⁴⁵

Pasi që përkthimet e para në gjuhën arabe janë bërë nga sirianishtja dhe greqishtja pa ndërmjetësimin e gjuhës latine, fjalët me prejardhje latine,

⁴² Shih për periudhën abasite: Aisa Djulizarevic-Simic, *Arapska knjizevnost abasidskog perioda*, në: *Mogucnost*, op. cit., fq. 926-1013.

⁴³ F. E. Peters mendon se greqishtja dhe sirianishtja kanë qenë ndërmjetëse të filozofisë islame në Mesjetë, pra edhe të terminologjisë. Shih: F. E. Peters, *The Greek and Syriac background*, në: Seyyed Hossein Nasr – Oliver Leaman, *History of Islamic Philosophy*, part I-II, Teheran, Iran, pa vit botimi, fq. 40-51.

⁴⁴ • edomil Veljaçiq, *Razmedja azijskih filzofija*, II, Zagreb, 1978, fq. 317 e tutje.

⁴⁵ Tarik Haveri, op. cit., fq. 29 dhe 59-105.

nuk kanë vend në literaturën e asaj kohe.⁴⁶ Hana Fahuri dhe Halil Xherr shtrojnë dhe provojnë gjerësisht se sirianishtja ishte gjuha nga e cila fillimisht përkthehej trashëgimia greke. Nerkez Smailagiq pohon se rol të veçantë në transmetimin dhe absorbimin e trashëgimisë greke te muslimanët kanë zonat lindore (Mezopotamia, Siria, Persia) dhe sidomos sektet kristiane siriano-persiane e nestorianëve dhe monofizitëve.⁴⁷ Vetëm pastaj filluan përkthimet e drejtpërdrejta nga gjuha greke në gjuhën arabe.⁴⁸ Përkthyesit bashkëkohorë medoemos duhet ta kenë parasysh këtë fakt në përkthimet kritike të veprave burimore islame.

2. Vetëm disa fjalë janë huazuar nga gjuhët tjera dhe janë arabizuar (nga aspekti i fonetikës), e ndonjëherë këto fjalë janë lënë në trajtën origjinale. Fjala siriane **mîmar** (predikim, homili, shqyrtim, trajtim), në fillim ishte ruajtur sipas origjinalit, por më vonë ka marrë trasjtën **maymar**.

Fjala iraniane **gōwhar** në arabishte është bërë **xhawhar** (qenësi, rrojtje, substancë, esencë, thelbë). Me këtë shprehje është përkthyer fjala greke **usía**.⁴⁹

3. Shumë fjalë nga gjuha klasike arabe, qoftë në poezinë parakur'anore, qoftë nga Kur'ani, marrin kuptime të reja dhe në këtë mënyrë bëjnë jetë të dyfishtë: ruajnë kuptimet e deriatëhershme, por edhe paraqiten në tekste jofilozofike. P. sh.:

- Fjala **idafetu** (shtojcë, aneks) do ta përkthejë fjalën e Aristotelit **prós ti**, dhe do të ketë kuptimin: raport, marrëdhënie, relacion, sikurse edhe në gramatikë që ka kuptimin e lidhjes gjenitive.

⁴⁶ Daniel Bucan, në: Averroës, Nesuvislost nesuvislosti, Zagreb, 1988, fq. LX.

⁴⁷ Këto sekte pas ikjeve nga Greqia dhe vendet përreth u vendosen në këto zona dhe vazhduan ta kultivojnë filozofinë greke. Shih: Nerkez Smailagiq, Klasicna kultura islama, I, Zagreb, 1973, fq. 83-84.

Syed Nomanul Haq mendon se edhe hindishtja dhe persishtja, nëpërmjet sirianishtes, kanë rol të konsiderueshëm në sajimin e terminologjisë filozofike islame. Gjerësisht: Syed N. Haq, The Indian and Persian background, në: Seyyed Hossein Nasr – Oliver Leaman, op. cit., fq. 52-68.

⁴⁸ Hana El-Fahuri – Halil El-Xherr, Tarih'ul-felsefet'il-arabijjeh, II, botimi II, Bejrut, 1993, fq. 19 e tutje.

Për ndikimin e filozofisë greke në botën islame shih gjerësisht: Yegane Shayegan, The transmission of Greek philosophy to the Islamic world, në: S. H. Nasr – O. Leaman, op. cit., fq. 89-104.

⁴⁹ Tarik Haveri, op. cit., fq. 29.

- Fjala **tabkit**: qortim, vërejtje, sharje, ka përkthyer fjalën greke **ἐλεγχος**, dhe nga atëherë si shprehje profesionale ka kuptimin edhe përgënjeshttrim, refuzim.

- Fjala **nefs** e arabishtes është përkthyer me fjalën greke **psyche**, kurse fjala **ruh** me fjalën **pneûma**, pa ndryshuar kuptimin.⁵⁰

4. Ky grup është më i vëllimshmi dhe përbëhet nga neologjizmat, togfjalëshat të “farkuar nga rrënjët burimore të gjuhëve në pajtim me rregullat e morfologjisë gramatikore”⁵¹ Këto togfjalësha i kanë sajuar përkthyesit dhe vetë filozofët deri në ditët tona. Mendohet se kësaj i ka ndihmuar edhe dominimi i shkollës nga Basra, e cila me metodat e saj preskriptive (mundi shkollën deskriptive të Kufes) ishte e gatshme të absorbojë nacionet e reja.⁵²

Autorët theksojnë se gjuha arabe është mjaft e pasur me shprehje për **konkreten**, por jo aq edhe për **abstrakten**, por nga aspekti morfologjik, ky problem është kapërcyer duke shtuar prapashtesën **-ijje** - : p. sh.: **insan** (njeriu) > **insanijeh** (njerëzorja, humanitas) etj.⁵³ Dijetarët mendojnë se gjuha arabe me dy polet e saj, të kultivuara në modelin e Shpalljes, me shkollën e saj *për konkrete* në Kufe, duke poseduar në këtë mënyrë karakterin figurativ dhe empirik, dhe me shkollën e saj *për abstrakten* në Basra, e frymëzuar me konceptimin parimor dhe teoretik, me prirje kah teologjikja, shkencorja dhe filozofikja, është e denjë për realizime të pashembëllta.⁵⁴

Mund të konstatohet se fjalët e huaja të futura në përdorim në gjuhën arabe ndahen në dy grupe:

1) Fjalët e arabizuara (mu’arrab), ku bëjnë pjesë fjalët e transliteruara greke ose nga gjuhët tjera, në trajtën e tyre burimore ose të përshtatura⁵⁵ dhe

⁵⁰ Tarik Haveri•, op. cit., fq. 30.

⁵¹ Soheil M. Afnan, op. cit., fq. 27.

⁵² Për ekspertët rekomandojmë leximin: A. M. Goichon, La philosophie d’Avicenne, Paris, 1979, fq. 59, sipas: Tarik Haveri•, op. cit., fq. 30-31 dhe: Louis Massignon, Reflexion sur la structure primitive de l’analyse grammaticale en arabe, Arabica, 1954, fq. 3, sipas: Tarik Haveri•, op. cit., fq. 32.

⁵³ Sipas: Tarik Haveri•, op. cit., fq. 33-34.

⁵⁴ Sipas: Frithjof Schuon, Dimenzije islama, Sarajevë, 1996, fq. 28. Shih edhe fq. 28-45.

⁵⁵ Shaikh Husain Wali, Compte Rendues de l’Acad, Royale de la Langue Arabe, vol. 1-2.1934-1935, fq. 348, sipas: S. M. Afnan, op. cit., fq. 28.

2) Fjalët e posasajuara (muwal-lad), ku bëjnë pjesë “shprehjet të cilat i kanë përdorë sajuesit e fjalëve (al-muwal-lidun) dhe atë tjetërfare, se sa që i kanë përdorur arabët. Brenda këtij grupi kemi edhe dy nëngrupe:

a) Fjalët që i janë përshtatur rregullave të gjuhës arabe dhe

b) Ato që nuk i janë përshtatur rregullave të gjuhës arabe.⁵⁶

V. Prapavija historike e sajimit të terminologjisë filozofike islame

Një shekull pas vdekjes së Muhammedit a.s., më 632 e.r., shteti islam shtrihej në hapësirat, në të cilat në të kaluarën janë krijuar, janë zhvilluar dhe janë shkatërruar gati të gjitha kulturat dhe qytetërimet e Kohës së vjetër. Në horizontet e kësaj hapësire gjeografike kemi edhe dy religjione të mëdha monoteiste, judaizmin dhe kristianizmin.⁵⁷

Pushtimi ushtarak tërheq me vete, rëndom, përpjekjen që të konstituohet edhe dominimi ideologjik dhe kulturor. Kjo edhe u arritë, Islamin e pranuan edhe hebraikët dhe kristianët, edhe persianët edhe hindusët, edhe sirianët edhe egjiptianët ... Por, ata që dëshiruan të mbesin në besimin e vjetër, këtë mund ta bënin, duke iu falënderuar tolerances dhe maturisë islame.⁵⁸ Këtë proces F. Hiti e përshkruan: “Posa persianët, sirianët, kobtët, berberët dhe të tjerët në grupe e përqaftonin islamin dhe filluan me arabljanët të lidhin martesë, u rrënuan muri i lartë fillestar i cili më herët i ka ndarë arabljanët nga popujt tjerë joarabë. ...Prej tash arab quhej çdonjëri që predikonte islamin dhe kush fliste dhe shkruante arabishten, pa marrë parasysh prejardhjen e tij racore.” “Prandaj, kur flasim për medicinën ose për filozofinë arabe ose për matematikën arabe, nuk mendojmë me këtë se shkencat medicinale, filozofia dhe matematika domosdo janë prodhime të frymës arabljane ose këto janë prodhime që i ka zhvilluar populli që jeton në siudhësën arabe, porse ky është thesar të cilin në tërësi e kanë depozituar në

⁵⁶ Shaikh Husain Wali, *Compte Rendues de l'Acad, Royale de la Langue Arabe*, vol. 1-2.1934-1935, fq. 348, sipas: S. M. Afnan, op. cit, fq. 28. Krhs.: Teufik Muftic, *Gramatika arapskoga jezika*, Sarajevë, 1998, fq. 12-13.

Është e nevojshme të lexohet parathënia e Xhemil Salibes rreth formimit dhe sistemimit të terminologjisë në fjalorin e tij: Xhemil Saliba, *El-Mu'xhem'ul-felsefijj*, I, Bejrut, 1414 h./1994, fq. 7-21.

⁵⁷ Për prapavinë historike të zhvillimit të marrëdhënieve islame dhe të tjerët, rekomandojmë leximin e: Hisam Dzait, *Evropa i islam*, botimi II i plotësuar, Sarajevë, 1989.

⁵⁸ T. Haveriq kritikon bindjen se muslimanët kanë qenë absolutisht tolerantë. Ai mendon se kjo bindje është shprehur në mënyrë jokritike. Mirëpo, T. Haveriq mendon se dekadat e para të shtetit islam janë të pashembëllta në histori. Në: Tarik Haveriq, op. cit., fq. 37.

libra në gjuhën arabe njerëzit të cilët kryesisht kanë jetuar në periudhën e halifatit dhe vetë ishin persianë, sirianë, egjiptianë apo arabë, kristianë, judaistë dhe muslimanë, dhe të cilët lëndën për librat e tyre kanë mundur ta marrin nga burimet greke, arameite, indo-persiane dhe të tjera.”⁵⁹

Mungesa e një gjuhe unike dhe mungesa e terminologjisë profesionale në mesin e përkthyesve dhe ndarjet në aspekt të parimeve filozofike lindore dhe përfundime filozofike, por edhe shkencat tjera, i bërën të vështira për t’u studiuar dhe kuptuar, por ardhja e gjenive sikurse El-Kindiut, Farabiut, Ibn Sinait, Ibn Rushdit dhe të tjerëve, bëri që e kaluara të kuptohet, të zhvillohet, të krijohet filozofi e re dhe të transmetohet më tej.⁶⁰ Punës së këtyre gjenive iu ka ndihmuar edhe natyra e gjuhës arabe, e cila si gjuhë konsonantesh dhe foljore, është mjaft e përshtatshme t’i shprehë “gjendjet shpirtërore” dinamike, në lëvizje.⁶¹

Kjo në pika të shkurtra do të ishte gjendja shpirtërore e hapësirave dhe kohëve të trajtuara me këtë rast, që drejtpërdrejt ka ndikuar në zhvillimin fetar, kulturor dhe qytetërues të Mesjetës dhe kohës që vinte.

VI. Në vend të përfundimit & përmbylljes

Pse në vend të përmbylljes? Sepse as për shkaqe formale as joformale ky punim i filluar nuk mund të mbyllet. Pavarësisht nga vullneti i autorit, puna e këtillë është e gjykuar të plotësohet, të ndryshohet, të përmirësohet në vazhdimësi. Besojmë se koha që vjen do ta verifikojë dhe provojë këtë të shkruarën dhe do të ofrojë zgjidhje të reja, sigurisht më fatlume. Punimi ynë këtyre punimeve të ardhshme do t’u ndihmojë pak, kurse punimet e ardhshme, me kontributin e vet, mund të ofrojnë më shumë për këtë punim. Por, edhe atëherë do të shtrohet pyetja e përfundimit dhe përmbylljes. Pra, puna e këtillë nuk mund të përfundohet as përmbyllet.

⁵⁹ Filip Hiti, Istorija arapa od najstarijih vremena do danas, Sarajevë, botimi II fototip, 1988, fq. 228.

⁶⁰ Ahmed Fuad El-Ehwani, Filozofia islame, Prizren, 2002, fq. 38-58; Ajatollah Misbah Yazdi, Islamska filozofija, 1, Sarajevë, 2004, fq. 17.

⁶¹ Sipas: Louis Gardet, Mistika, Zagreb, 1983, fq. 136.

Përmbledhje

Zhvillimi i terminologjisë filozofike islame në Mesjetë

Në punimin tim temë boshte është **Zhvillimi i terminologjisë filozofike islame në Mesjetë**, respektivisht **burimet, prejardhja, karakteristikat dhe prapavija historike e zhvillimit të terminologjisë filozofike islame në Mesjetë**. Duke e marrë parasysh se filozofia në mesjetë ka mbuluar një fushë të gjerë të diturive dhe shkencave, mendoj se shqyrtimi i terminologjisë filozofike islame, kryesisht me prejardhje arabe, iraniane dhe turke, dhe asaj greke, latine por edhe shqipe, do të ofrojë ndihmesë në zhvillimet e mëtejme të drejta dhe origjinale shkencore ndër shqiptarët. Është mendimi i mi se gjuha shqipe ka potencial cilësor dhe sasior ta bartë barrën që i takon në hyllësinë e gjuhëve botërore.

Në fund kemi ofruar edhe një fjalor filozofik pesëgjuhësor, me 143 shprehje, me shpresë se do të ndihmojë në zhvillimin e gjithëmbarshtëm.

Literatura:

I. Në gjuhën arabe

1. Ahmed Emin, Duha'l-islam, I, botimi X, Kairo, 1984.
2. El-Imam Ebi'l-Hasan Alij ibn Ismail El-Esh'arij, Kitabu mekalat'il-islamijiin ve ihtilaf'il-musal-lin, botimi III, Wiesbaden, 1980.
3. Hana El-Fahuri – Halil El-Xherr, Tarih'ul-felsefet'il-arabijeh, pjesa II, botimi II, Bejrut, 1993.
4. Ibrahim Madkur, Fi'l-felsefet'il-islamijeh, I-II, pa vend dhe vit botimi.
5. Ismail Raju al-Faruqi and Lois Lamya al—Faruqi, The Cultural Atlas of Islam, New York & London, (1986 ?).
6. Xhemil Saliba, El-Mu'xhem'ul-felsefijji bi'l-elfadh'il-arabijjeti we'l-frensijjeti we'l-inklizijjeti we'l-latinijeh, I-II, Bejrut, 11414 h./1994.
7. Umer Ferruh, Tarih'ul-fikri'il-arabijji ila ejjami Ibn Haldun, botimi IV, Bejrut, 1983.
8. Abdurrahman Bedevij, Eflatun fi'l-islam, bot. III, Bejrut, 1402 h./1982.

II. Në gjuhët boshnjake-kroate-serbe

1. Ajatollah Misbah Yazdi, Islamska filozofija, 1, Sarajevë, 2004.
2. Arapsko-islamski uticaj na evropsku renesansu, Sarajevë, 1987.
3. Averroës, Nesuvislost nesuvislosti, Zagreb, 1988.
4. • edomil Velja•i•, Razmedja azijskih filozofija, II, Zagreb, 1978.
5. Filip Hiti, Istorija arapa od najstarijih vremena do danas, botimi II fototip, Sarajevë, 1988.
6. Frithjof Schuon, Dimenzije islama, Sarajevë, 1996.
7. Henri Laoust, Raskoli u islamu, Zagreb, 1989.

8. Hisam Dzait, Evropa i islam, botimi II i plotësuar, Sarajevë, 1989.
9. Louis Gardet, Mistika, Zagreb, 1983.
10. M. M. Sharif, Historija Islamske Filozofije, I, Zagreb, 1988.
11. Muhammed Iqbal, Razvoj metafizike u Persiji – Prilog historiji muslimanske filozofije, Sarajevë, 2005.
12. Muhamed Mrahorovic, Filozofijska razmedja islamske duhovnosti, Sarajevë, 2001.
13. Nerkez Smailagic, Leksikon islama, Sarajevë, 1990.
14. Nerkez Smailagic, Klasicna kultura islama, I, Zagreb, 1973.
15. Nerkez Smailagic, Klasicna kultura islama, II, Zagreb, 1976.
16. Rade Bozovic, Udzbenik arapskog jezika sa vjezbankom i rjecnikom, Botimi I, Sarajevë, 1984.
17. Dzermaludin Latic, Stil kur'anskog izraza, Sarajevë, 2001.
18. Tarik Haveric, Srednjovjekovno filozofijsko nazivlje u arapskom jeziku, Sarajevë, 1990.
19. Teufik Muftic, Gramatika arapskoga jezika, Sarajevë, 1998.
20. Teufik Muftic, Klasicna arapska stilistika, Sarajevë, 1995.
21. Umhazun, Muhammed, Koncept izucavanja islamske historije, sarajevë, 2000.

III. Në gjuhën shqipe

1. Ahmed Fuad El-Ehwani, Filozofia islame, Prizren, 2002.
2. Ekrem Murtezai, Fjalor i feve, Prishtinë, 2000.
3. Ekrem Murtezai, Fjalor i filozofisë, Prishtinë, 1995.
4. Henry Corbin, Historia e filozofisë islame, I-II, Shkup, 1997.
5. Sami Frashëri, Qytetëprimi islam, vepra 13, Shkup, 2004.

IV. Në gjuhën angleze:

1. Ismail Raji al-Faruqi and Lois Lamya al—Faruqi, The Cultural Atlas of Islam, New York & London, (1986 ?).
2. Muhammad Iqbal, The Development of Metaphysics in Persia – A Contribution of Muslim Philosophy, Sarajevë, 2005.
3. Seyyed Hossein Nasr – Oliver Leaman, History of Islamic Philosophy, part I-II, Teheran, Iran, pa vit botimi.

V. Periodiku

1. Glasnik – Casopis Rijaseta IZ BH, Sarajevë, 11-12/1997.
2. Glasnik – Casopis Rijaseta IZ BH, Sarajevë, 1-2/1998.
3. Prolozi za Orijentalnu Filologiju, XXIV 1974/ Sarajevë, 1976.
4. Mogucnost – Casopis za knjizevnost, umjetnost, kulturni problemi, nr. 8-9/1979, Split.

Prof. dr. Mehdi POLISI

LEKSIKU ISLAM PJESE PËRBËRËSE E LEKSIKUT TË SHQIPES

Huazimi i fjalëve ka qenë dhe vazhdon të jetë proces i vazhdueshëm gjuhësor, sepse, nevoja për të jetuar, gjithmonë i ka shtyrë njerëzit dhe popujt përgjithësisht të kenë kontakte me njëri-tjetrin. Prandaj është e qartë se qëkur ekzistojnë popuj të ndryshëm me gjuhë të ndryshme, ekzistojnë edhe kontakte ndërgjuhësore, të cilat në kushte dhe në rrethana të ndryshme historike-shoqërore çojnë te përzierja e gjuhëve dhe si rezultat i kësaj janë huazimet, përkatësisht ndikimet gjuhësore. Duke qenë një nga problemet shumë të rëndësishme gjuhësore, interesimi i gjuhëtarëve për trajtimin e ndikimeve të një gjuhe në tjetrën është i hershëm. Gjuhëtari i mirënjohur gjerman, Shuharti, kishte vërtetuar prej kohësh se nuk ka gjuhë krejtësisht të pastër, se të gjitha gjuhët u nënshtrohen ndikimeve të ndërsjella dhe se ato përzihen vazhdimisht.¹ Me ndikimet dhe marrëdhëniet ndërgjuhësore pastaj janë marrë edhe shumë gjuhëtarë të tjerë.²

Ndikimi i gjuhëve është i ndërsjellë, por për arsye të ndryshme, si: kulturore, ekonomike, tregtare, politike, fetare etj., njëra gjuhë ndikon më tepër në tjetrën. Kështu, për shembull, gjuha turke ndikoi dukshëm në leksikun e gjuhës shqipe, por edhe ajo pranoi diçka nga gjuha shqipe.³

¹ Hugo Schuchardt, *Slavo-Deutsches und Slavo-Italianisches*, Graz, 1884, f. 3-5 (cituar sipas Srdjan Musiq, *Romanizmi u Severo-zapadnoj Boki Kotorskoj*, Beograd, 1972, f. 13.)

² Prof. Vesel Nuhii në librin *Ndikimet ndërgjuhësore*, Prishtinë, 1990, kishte bërë një përzgjedhje punimesh të disa autorëve të mirënjohur, si të: Blumfildit, Sapirit, Vajnrhut, Haugenit, Fishmanit, Filipoviqit etj., të cilët në mënyrë të qartë e të thelluar trajtojnë çështjet e gjuhëve në kontakt.

³ Për ndikimin e gjuhës shqipe në gjuhën turke dhe në gjuhët e tjera të Ballkanit shih: Eqrem Çabej, *Elementet e shqipes në gjuhët e tjera të Ballkanit*, Studime gjuhësore III, Prishtinë, 1987, f. 71 e tutje.

Nga historia dihet fare mirë se turqit depërtuan në Ballkan, prandaj dhe në territoret shqiptare aty nga gjysma e dytë e shekullit 14 dhe vazhduan të qëndrojnë deri në fillim të shekullit 20, pra plotë pesëqind vjet. Qeverisja kaq e gjatë e turqve në këto vise, vendosja dhe përforsimi i administratës turke, kontaktet e dendura të popullit shqiptar me shërbimet administrative të kohës, hapja e institucioneve të ndryshme, hapja e shkollave ku mësohej gjuha turke, arabe e persiane, pranimi i Fesë islame nga ana e shqiptarëve si dhe shumë faktorë të tjerë, pa dyshim, ushtruan ndikim të thellë e të shumanshëm në jetën materiale e shpirtërore të popullit shqiptar. Ky ndikim kaq i madh nuk mund të mos linte gjurmë të thella edhe në gjuhë. Këtë e dëshmon numri i madh i huazimeve turke, arabe e persiane⁴ në gjuhën shqipe, të cilat janë të llojllojshme dhe shtrihen gati në të gjitha sferat e jetës njerëzore, si te: rrethi familjar; kuzhina; veshmbathja, stollitë, mjeshtritë; banesa, ndërtimi i saj dhe inventari i shtëpisë, emërtime sëmundjesh dhe mjekimesh, administrata dhe rregullimi shtetëror, ushtria, shprehjet ushtarake dhe pajisjet luftarake; ngjyrat, arsimit dhe edukimi; lojrat, fjalët që shprehin tipare dhe ndjenja shpirtërore të njeriut, leksiku islam etj.⁵

Huazimet turke-orientale në gjuhën shqipe kanë tërhequr vëmendjen e gjuhëtarëve të huaj dhe të vendit prej kohësh. Është thënë disa herë se disa elemente turke në gjuhën shqipe, duke përfshirë edhe ato në gjuhët e tjera të Evropës Juglindore dhe Lindore, i kishte vështuar për herë të parë Miklosichi⁶ qysh në gjysmën e dytë të shek. 19. Edhe Majeri, albanist i shquar gjerman dhe njohës shumë i mirë edhe i turqishtes⁷, nga 5140 fjalë

⁴ Në literaturën shqipe huazimet turke, arabe e persiane njihen herë si *turqizma* e herë si *orientalizma*. Termi turqizma arsyetohet me faktin se pjesa dërmuese e tyre kanë hyrë në gjuhën shqipe përmes turqishtes, kurse termi orientalizma arsyetohet me faktin se, pavarësisht nga rruga e depërtimit të tyre, gati më se gjysma e këtyre huazimeve të shqipes janë fjalë të burimit arab e persian. Mendoj se termi orientalizma është më i përshtatshëm jo vetëm se gjysma e tyre janë fjalë arabe e persiane por edhe për faktin sepse një numër i tyre, si: kalif, kalifat, kallf, admiral, zenit etj. ka hyrë nëpërmjet gjuhëve evropiane ose trajta themel, trajtë më e përgjithshme se temel, ka hyrë përmes greqishtes; perdhe (për perde), po ashtu nga greqishtja etj.

⁵ Mehdi Polisi, *Turqizmat në të folmet shqipe të Maqedonisë* (punim doktrate), mbrojtur në Fakultetin e Filologjisë, 1997 në Prishtinë)

⁶ F. Miklisich, *Die turkischen Elemente in den sudost-und osteuro paischen Sprachen I*, 1884; II, 1890.

⁷ Sipas E. Çabejt, *Studime gjuhësore I*, Prishtinë, 1976, f. 2.

bazë në fjalorin e tij të mirënjohur, kishte përfshirë 1180 fjalë turke.⁸ Kontributin e tyre në këtë fushë e kanë dhënë pastaj edhe dijetarë të tjerë.⁹

Për turqizmat-orientalizmat e gjuhës shqipe, sikurse shihet, janë shkruar mjaft studime; është marrë në shqyrtim një material i pasur; është shkruar për vendin e tyre në sistemin leksikor të shqipes, për faktorët që kanë ndikuar në depërtimin e tyre, për kronologjinë e hyrjes së tyre, për ndryshimet fonetike, morfologjike, semantike etj. të tyre, për qëndrimin që duhet mbajtur ndaj tyre dhe për çështje të tjera të karakterit të përgjithshëm, që, pa dyshim, është një kontribut i rëndësishëm gjuhësor dhe shkencor përgjithësisht. Megjithatë, për turqizmat-orientalizmat e gjuhës shqipe ka ende për t'u thënë, sidomos nëse merren në shqyrtim fushat e veprimtarisë njerëzore veç e veç. Në këtë studim objekt trajtimi do të jetë leksiku islam.

Leksiku islam në gjuhën shqipe, sigurisht edhe në gjuhë të tjera, në thelb është arab, sepse Kur'ani, burim i parë i Fesë islame, është shpallur në gjuhën arabe. Si gjuhë qendrore e Islamit dhe kulturës islame në përgjithësi, arabishtja ndikoi në shumë gjuhë të tjera¹⁰ në radhë të parë në persishten dhe në turqishten, të cilat pas arabishtes konsiderohen gjuhë të dyta

⁸ G. Mayer, *Etimologisches Worterbuch der albanischen Sprache*, Strassburg, 1891. (Sipas Çabejt).

⁹ Hasan Kaleshi, *Ndikimet orientale në tregimet popullore shqiptare*, Buletini i Muzeut të Kosovës XI, Prishtinë, 1972, f. 9-49; *Turski uticaji u tvorbi reči u albanskom jeziku*, Buletini i F. Filozofik të Prishtinës VII, 1970, f. 165-199; T. Dizdari, *Fjalori i orientalizmeve në gjuhën shqipe*, Tiranë, 2005 (i punuar në vitet e '60-të); E. Çabej, *Huazimet turke*, Studime gjuhësore III, Prishtinë, 1987, f. 64; *Për një shtresim kronologjik të huazimeve turke të shqipes*, Studime gjuhësore V, Prishtinë, 1988, f. 274; N. Boretzky, *Der türkische Einfluss auf das Albanische I,II*, Wiesbaden, 1975/6; A. Krajni, *Hyrja e turqizmeve në shqipen dhe përpjekja për zëvendësimin e tyre*, Jehona, nr.8/1975, Shkup; A. Kostallari, *Rreth depërtimit të turqizmeve në gjuhën shqipe gjatë shekujve XVII-XVIII*, Gjurmime albanologjike (ser.e shkencave filologjike) VII/1978, Prishtinë E. Lafe, *Rreth vendit të orientalizmeve ndër huazimet e shqipes*, Feja, kultura dhe tradita islame ndër shqiptarët, Prishtinë, 1995; J. Thomaj, *Terminologjia islame dhe leksikografia shqiptare*, Feja, kultura dhe tradita islame ndër shqiptarët, Prishtinë 1995; M. Polisi, *Adaptimet fonetike të arabizmeve në gjuhën shqipe*, Dituria islame, nr. 19, 20/1990; nr. 21/1991, Prishtinë; *Rreth disa orientalizmeve në Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe*, Gjuha shqipe, 1/1990, Prishtinë; *Përdorimi i disa termave islame në gjuhën shqipe*, Feja, kultura dhe tradita islame ndër shqiptarët, Prishtinë, 1995; i Bajçinca, *Probleme të përkthimit të teksteve islame në gjuhën shqipe*, Feja, kultura dhe tradita islame ndër shqiptarët, Prishtinë, 1995 etj.

¹⁰ Sipas Eduard Sapirit, *Gjuha – Hyrje në studimin e ligjëritit*, Prishtinë, 1980, f. 221, arabishtja hyn ndër pesë gjuhët e botës me ndikim më të madh.

islame.¹¹ Persishtja pastaj ndikoi në përhapjen e elementeve arabe-islame në gjuhët lindore deri tek urdishtja,¹² kurse në përhapjen e elementeve arabe-islame (dhe persiane) në gjuhët evropiane, shikuar nga aspekti kronologjik, janë dy rrugë: e para, përmes kontakteve të arabëve me romanët dhe përmes përkthimeve të veprave arabe në gjuhën latine¹³ dhe, e dyta, përmes turqishtes, sidomos në gjuhët e Evropës Juglindore.

Sa i përket leksikut islam (arab dhe persian), ai në gjuhën shqipe ka hyrë përmes turqishtes (si gjuhë ndërmjetësuese) dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë nga gjuha arabe, sidomos nga njohja dhe përkthimet e literaturës arabe-islame nga ulemaja shqiptare. Kjo më së miri hetohet te fjalët arabe të cilat në përbërjen e tyre kanë tingujt th ose dh, sepse turqishtja, meqë nuk i ka këto dy tinguj i kthen përkatësisht në s e z¹⁴, për shembull, krahas *hadis* (trajhtë e turqishtes), është duke u përdorur *hadith* (trajhtë e afërt me atë të arabishtes, pra jo krejtësisht e njëjtë), krahas *sevap* (turq.) përdoret *thevap* (e afërt me trajtën arabe); krahas *mezhep* (lexo mezh-hep, turq.), përdoret *medhheb* (ar.), krahas *ziqër* (turq. zikir), përdoret *dhikër* (ar. dhikr) etj.

Për shkak të rrjedhave politike e ideologjike përbrenda truallit shqiptar, leksiku islam për një kohë të caktuar (periudha komuniste) ka patur rënie, është përdorur me mjaft rezervë; në vend të tij është përdorur fjala shqipe që, për shkak të specifitetit, në asnjë mënyrë nuk mund të mbulojë kuptimin e tij; pastaj nuk është përfaqësuar sa duhet në fjalorët e gjuhës shqipe, e edhe kur është përfshirë, atij i është dhënë ngjyrim ideologjik dhe, ç'është më e keqja, është shpjeguar në mënyrë joobjektive, joshkencore dhe joprofesionale, domethënë se ndaj tij nuk është mbajtur qëndrim i drejtë.¹⁵ Lidhur me përfshirjen e leksikut islam ndër fjalorët e shqipes dhe për mënyrën e trajtimit leksikografik të tij, leksikografi ynë i

¹¹ Nerkez Smailagiq, *Leksikon Islama*, Sarajevo, 1990, f. 300. Shih dhe Sami Frashëri, *Përpyqjet e heronjve në përhapjen e Islamit*, Logos-A, Shkup, 2004 (vepra mban numrin rendor 12 të kësaj serie), e përktheu Dr. Ismail Ahmedi.

¹² Nerkez Smailagiq, *Po aty*, f. 72.

¹³ Shi Sami Frashëri, *Qytetërimi islam*, Logos-A, Shkup, 2004 (bot. i tretë dhe mban numrin rendor 13 të kësaj serie), e përktheu në gjuhën shqipe M. Polisi.

¹⁴ Mehdi Polisi, *Adaptimet fonetike të arabizmave në gjuhën shqipe*, Dituria islame, nr. 19, 20/1990 dhe 21/1991, Prishtinë.

¹⁵ Shih: Mehdi Polisi, *Përdorimi i terminologjisë islame në gjuhën shqipe*, Feja, kultura dhe tradita shqiptare ndër shqiptarët, Prishtinë, 1995, f. 317; dhe në: *Rreth disa orientizmave në Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe*, Gjuha shqipe, 1/1990, (bot. i Institutit Albanologjik), Prishtinë.

mirënjohur J. Thomaj do të shprehet: “Që përzgjedhja dhe trajtimi leksikografik i fjalëve të botës islame ndër fjalorët të jetë sa më objektiv, në kuptimin që t’i përgjigjen tipit të fjalorit; të jenë në përpjestim të drejtë me fjalësin e përgjithshëm e special që përfshihen në të, të cilësohen e të shpjegohen në pajtim me konceptet që shënojnë, larg çdo qëndrimi ideologjik-klasor, larg pikëpamjeve politike të përkatësisë fetare, jashtë çdo ndikimi jogjuhësor e joshkencor, të karakterizohen sipas vlerave objektive që kanë në fushën e veprimtarisë islame etj.”¹⁶ Duke sjellë shembuj për mënyrat e interpretimit ideologjik të leksikut islam në Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe, që ishte edhe vetë njëri nga hartuesit e tij, prof. Thomaj shprehet kështu: “Për hir të së vërtetës, do të pohoj këtu se në Redaksinë e Fjalorit vetë kam qenë kundër interpretimeve të tilla.”¹⁷

Prandaj, nga sa u tha dhe më lart, mendoj se edhe ndaj leksikut islam, ndaj kësaj sfere të jetës njerëzore, që është, pa dyshim, nga më të moçmet e huazimeve orientale në gjuhën shqipe, duhet patur qëndrim korrekt, sepse fundja, ai është pjesë përbërëse e leksikut të përgjithshëm të shqipes. Vetëm duke e trajtuar në mënyrë objektive, shkencore e profesionale, do të mund të ndihmojmë në standardizimin dhe qëndrueshmërinë e leksikut të kësaj fushe.

Për arsye praktike dhe metodologjike e shohim të arsyeshme që të ndalemi në mënyrë të veçantë për secilën fjalë që do ta marrim në shqyrtim.

Abdest, abdes, avdes, -i. Nga persishtja *abdest*. Në gjuhën shqipe janë në qarkullim të tria variantet. Meqë varianti *abdest* është më afër burimit dhe meqë nuk shkakton ndonjë vështirësi në shqiptim, medoj se është më i përshtatshmi. Por ajo që na ka shtyrë ta trajtojmë këtë fjalë në këtë rast është tendenca e zëvendësimit të saj me fjalën shqipe “*larje, të larët*”. Zëvendësimi i *abdest*-it me “*larje*” nuk i përgjigjet në asnjë mënyrë realitetit, nuk mund të mbulojë kuptimin e tij, sepse, ndërsa “*larje*” përdoret me kuptim të përgjithshëm, *abdesti* bëhet (merret) me qëllim të caktuar dhe është “*larja e detyrueshme e fytyrës, e duarve deri në bërryla, përshkuarja e pjesës së sipërme të kokës, nga balli deri në majë të kokës, me shuplakë të lagur të dorës dhe larja e këmbëve deri në nyje*”. Për këtë arsye përdorimi i termi *abdest* (*abdes, avdes*) në gjuhën shqipe është i pashmangshëm.

¹⁶ Jani Thomaj, *Terminologjia islame dhe leksikografia shqiptare*, Feja, kultura dhe tradita shqiptare ndër shqiptarët, Prishtinë, 1995, f. 309.

¹⁷ Po aty, f. 314, shënimi 10.

Ajet apo verset. Për shkak të fuqisë shprehëse dhe origjinalitetit para së gjithash duhet të përdoret fjala *ajet*. Fjala *ajet* është fjalë me burim nga arabishtja dhe kuptimi i parë i saj është “shenjë”, “simbol”, “argument”, por kur është fjala për Kur’anin, *ajet* do të thotë “*fjali a tog fjalish të sures në Kur’an.*” Përdorimi i sintagmës *ajetet kur’anore*, në vend *ajetet e Kur’anit*, më duket jo me vend.

Hadis apo hadith. Fjalë e burimit arab. Më duket se të dyja variantet e kanë fituar të drejtën e përdorimit në gjuhën shqipe. Ja pse. Trajta *Hadis* ka hyrë përmes turqishtes dhe i përket traditës, kurse trajta *hadith*, ndonëse konsiderohet si trajtë burimore arabe, unë nuk mendoj se është krejt ashtu, sepse, po t’i bëhet një analizë fonetike-fonologjike kësaj fjale, do të shihet se përveç përdorimit të th-së, ne nuk jemi në gjendje ta shqiptojmë h-në karakteristike arabe, më tutje nuk e shqiptojmë të gjatë as i-në e kësaj fjale. Për këtë arsye nuk mund të përcaktohem për njërin a tjetrin variant. Në gjuhën shqipe përdoret vetëm në fushën e terminologjisë islame, me fjalë të tjera hadis, hadith është: “*gjithçka që Muhamedi a.s. ka folur, ka porositur, ka punuar dhe e ka pëlqyer.*” Hadisi, Hadithi, pas Kur’anit, është burimi i dytë i Islamit.

Haxh, -i. Fjalë me burim nga arabishtja. *Haxh* është “*vizita e Qabes në Meke në dhjetë ditët e para të muajit të fundit sipas kalendarit të hixhretit (në muajin Dhulhixhxe) për ata që kanë pasuri të mjaftueshme dhe që janë të shëndoshë psikik dhe fizik.*” Haxhi është një nga pesë shtyllat e Islamit dhe, siç dihet bëhet në vend dhe në kohë të caktuar, prandaj identifikimi i haxhit me “shtegtim”, “vizitë”, “të vizituar”, pelegrinazh” etj., siç e gjejmë ndër Fjalorët e gjuhës shqipe e gjatë, nuk më duket aspak i drejtë. Asnjëra nga këto fjalë shqipe nuk mund ta mbulojë kuptimin e fjalës *haxh*. Në gjuhën shqipe përdoret edhe varianti *haxhillëk* (trajtë e turqishtes).

Namaz, -i. Fjalë me burim nga persishtja. Namazi është një nga pesë shtyllat e Fesë islame. Është farz (detyrim) për çdo musliman të rritur, që është i aftë fizik e psikik, dhe bëhet pesë herë brenda njëzet e katër orëve. Në namaz lexohen ajete nga Kur’ani (jo nga përkthimi). Namazi përbëhet prej dy e më shumë *reqateve*, ndërsa çdo reqat përbëhet prej *kijames* (qëndrimit në këmbë), *ruqusë* (përlujtje e pjesës së sipërme të trupit në pozitë horizontale, me ç’rast me duar preken gjunjët) dhe *sexhdes* (të rënë me ballë dhe me duar përtokë). Meqenëse *namazi* përbëhet nga këto karakteristika të veçanta dhe, meqenëse kjo fjalë përdoret prej kohësh dhe është bërë pjesë e pandashme e leksikut të shqipes, çdo zëvendësim me

ndonjë fjalë shqipe do të ishte larg realitetit. Zëvendësimi i fjalës *namaz* me “lutje, të luturit”, siç e dëgjojmë kohët e fundit në emisionet televizive dhe në mediat e shkruara, është i paqëndrueshëm. Nuk mund të pajtohem në asnjë mënyrë që, për shembull, për *namazi i xhumasë* të përdoret shprehja “lutja e së premtes”. Fundja, nocionit “lutje” i përgjigjet fjala dua (ar. du’a).

Pejgamber dhe *Profet*. Të dyja fjalët përdoren në gjuhën shqipe. Fjala *Pejgamber* rredh nga persishtja (nga pers. *Pejgam* “lajm” dhe *ber* nga infinitivi *burden* “sjell”). Përkthimi i fjalpërfjalshëm është “ai që sjell lajm”. Sami Frashëri në fjalorin e tij *Kamus-i Turki* fjalën *Pejgamber* e përkufizon kështu: “Personi që sjell lajme nga Zoti dhe komunikon shpalljen e Zotit xh.sh.; I dërguari i Zotit xh. sh.” Fjala *Profet*, ndërkaq, është fjalë e greqishtes (prophetes) ose e latinishtes (propheta), me kuptimin “parashikues” dhe prej saj kemi foljen *profetizoj* “parashikoj”. Fjala *Profet*, ndonëse nuk e dimë me siguri, në literaturën islame shqipe do të ketë filluar të përdoret shumë vonë, ndërsa fjalën *Pejgamber* e gjejmë gjithnjë në shkrimet e hershme shqipe me karakter fetar islam, p.sh. në “*Vehbijen*” e Tahir Efendi Boshnjakut të vitit 1835.¹⁸ Duke u mbështetur në rrethanat e sipërpërmendura, sidomos në aspektin semantik të këtyre dy fjalëve, mbaj qëndrimin që, sidomos në literaturën islame, fjala *Pejgamber* të jetë parësore ndaj fjalës *Profet*.¹⁹

Zeqat, -i. Është fjalë me burim nga arabishtja. *Zeqati* është një nga pesë shtyllat e Islamit, pra është detyrim islam që jepet për pasurinë që ka arritur shkallën e caktuar (nisab). *Zeqati* ka funksion të gjerë, përdoret për qëllime shpirtërore, morale, sociale dhe humane. Prandaj, zëvendësimi a përdorimi i fjalëve “tatim”, “lëmoshë”, “mëshirë” etj. për *zeqat* është i paqëndrueshëm. Për fjalët lëmoshë e mëshirë arabët kanë fjalën *sadaka*, e cila po ashtu ka hyrë në gjuhën shqipe. Lëmosha (*sadaka*) është shprehje e vullnetit të lirë të njeriut dhe mund ta japë në çdo kohë.

Në literaturën islame shqipe, kohët e fundit për fjalën *zeqat* përdoret dhe varianti *zekat*, ose, më tutje, për *Qabe* përdoret *Kabe*, për *reqat* rekat, për *ruqu* ruku, për *hafiz* hafidh, për *hadis* hadith etj., me synim se këto trajtat e dyta janë trajta origjinale të gjuhës dhënëse (arabe). Çështja e pasqyrimin fonetik të tyre është një problem më vete dhe meriton vëmendje

¹⁸ Shih: Dr. Idriz Ajeti, Studime gjuhësore (...) II, Prishtinë, 1985, f. 200.

¹⁹ Shih edhe H. Sherif Ahmeti, “I dërguari I Zotit xh.sh.”, *Edukata islame*, nr.44-45, Prishtinë, 1986, f. 106.

të veçantë, sidomos tek ato arabe, sepse pjesa dërrmuese e tyre janë të kësaj gjuhe dhe, sepse gjuha arabe ka një sistem tingullor shumë të ndryshëm nga ai i gjuhës shqipe.

Në gjuhësi është i njohur fakti se huazimi i fjalëve sjell me vete edhe ndryshimin e tyre fonetik²⁰, domethënë, fjalët kur kalojnë nga një gjuhë në tjetrën pësojnë ndryshime sipas rregullave fonetike të gjuhës në të cilën hyjnë. Përshtatjet fonetike të fjalëve të huazuara janë dukuri gjuhësore që paraqiten zakonisht në forma dhe në mënyra të ndryshme, si p. sh. me zëvendësimin a ndryshimin e fonemave të gjuhës dhënëse me fonema të gjuhës marrëse, me ndërrimin e vendit të theksit, me asimilimin dhe disimilimin, me rënien a shtesën e ndonjë foneme etj. Lidhur me këtë dëshiroj të jem shumë i shkurtër dhe do t'i përmbahem parimit që edhe leksiku islam, ashtu si të gjitha fjalët e tjera të huazuara, duhet të përdoren në trajtat që nuk lëndojnë rregullat fonetike të gjuhës shqipe, të përdoren në trajtat që tashmë i ka përvetësuar populli. E kur dëshirohet të dihet etimologjia e tyre, si për shembull në fjalorë etimologjikë, atëherë duhet të vihet në përdorim transkriptimimi shkencor, duke përdorur shenjat diakritike përkatëse. Pa u zgjatur, për mua është fare e njohur se trajtat e sipërpërmendura: zekat, Kabe, rekat, ruku, hafidh, hadith etj., po të trajtohen në mënyrë të hollësishme nga pikëpamja fonetike, nuk dalin identike me trajtat burimore arabe, p. sh. te fjala zekat, k-ja shqiptohet si një k+j, kurse a-ja, e gjatë; te fjala Kabe, pas K-së, është bashkëtingëllorja karakteristike arabe ajn, e cila në asnjë gjuhë nuk ka barasvlerës; te fjala ruku, u-ja është e gjatë dhe pas saj është bashkëtingëllorja ajn; te fjala hafidh, h-ja është bashkëtingëllore arabe që nuk barazohet për nga shqiptimi me bashkëtingëlloren h të shqipes, a-ja është e gjatë, kurse dh-ja shqiptohet krejt ndryshe nga dh-ja e shqipes. Pra këto pak shpjegime më bëjnë të anoj nga pohimi që thash më sipër. Në këtë kuadër më duhet të them edhe diçka rreth përdorimit të nyjes shquese arabe el-. Si të shkruhet el apo al? Në pjesën dërrmuese të literaturës islame shqiptare përdoret varianti el dhe ky variant, pa u komentuar më gjatë, është fare i drejtë. Variantin el e përdorin edhe turqit. Varianti al, që, pa dyshim, është një ndikim nga gjuhët evropiane, në gjuhën shqipe përdoret vetëm nga një përkthyes i Kur'anit. Ai suret e Kur'anit i shkruan kështu: Suratu al-Bakarat (më drejt është Suretu el-Bekaretu ose Suretu-l-Bekaretu); Suratu at-Tavba (më drejt Suretu-t-Tevbe

²⁰ Eduard Sapir, vep. e cituar, f. 224.

ose Suretu et-Tevbe); Suratu al-Kahf (më drejt Suretu-l-Kehf ose Suretu el-Kehf) etj.

Për sa i përket emërimit të Fesë islame me termat: muhamedanizëm, fe muhamedane, myslimanizëm, fe myslimane, islamizëm, kam shkruar që më parë.²¹ Atëherë, por edhe tashti mbaj të njëjtin qëndrim lidhur me këtë çështje dhe pa hamendje mendoj se për emërtimin e Fesë islame vetëm termi ISLAM është i drejtë dhe pranueshëm nga të gjitha qarqet objektive shkencore. Do theksuar se vetëm termi Islam nuk përfshihet në Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe dhe në Fjalorin e shqipes së sotme!!! Ulemaja shqiptare duhet të ketë kujdes në përdorimin e kësaj terminologjie, siç duhet të ketë kujdes edhe në përdorimin e fjalëve islamizim, islamizoj.²²

Në përmbyllje të këtij punimi vlen të ripohojmë se leksiku islam në gjuhën shqipe është shumë i gjerë; është ndër huazimet më të vjetra orientale; është ndër më të qëndrueshmet, sepse vetë natyra e fesë është e tillë. Zëvendësimi i leksikut islam me fjalë shqipe në shumë raste është i pamundshëm dhe i paarsyeshëm. Lidhur me zëvendësimin e fjalëve të huaja, Prof. Çabej ka shprehur këtë mendim: “Një ndër parimet kryesore të zëvendësimit të fjalëve të huaja do të jetë maturia. Nuk duhet aty të kalohet në ekstrem. Ka rasa – kryesisht në punime të specializuara – ku përdorimi i një fjale a termi të huaj paraqitet i domosdoshëm: aty për hir të saktësisë shkencore, të stilit, a për një tjetër arsye, do të përdoret.”²³

²¹ Mehdi Polisi, *Përdorimi i terminologjisë islame në gjuhën shqipe*, Feja kultura dhe tradita islame ndër shqiptarët.

²² Po aty, f.319.

²³ Eqrem Çabej, *Për pastërtinë e gjuhës*, Gjuha shqipe 3, Prishtinë, 1984, f. 11.

Mr. Qemajl MORINA

PËRPIJEKJE PËR UNIFIKIMIN E TERMINOLOGJISË ISLAME NË GJUHËN SHQIPE

Nuk ka dyshim se në vazhden e ngritjes së kulturës sonë gjuhësore, në veçanti në unifikimin e gjuhës standarde shqipe, janë arritur rezultate të lakmueshme. Në këtë aspekt, vlen të përmendim se një segment me rëndësi i kulturës sonë gjuhësore, për shkak të rrethanave tashmë të njohura, jo vetëm se është anashkaluar, por është trajtuar në mënyrë nënçmuese dhe neveritëse, fjala është për terminologjinë fetare. Këtë më së miri e ilustron këta pak shembuj që janë marrë nga "Fjalori i gjuhës së sotme shqipe", i botuar në Tiranë më 1980, i ribotuar në Prishtinë në vitin 1981, dhe ai i vitit 1984, i cili për fenë thotë:

Fe~ Feja: *"Feja është besim i verbër i dogmës, armik i përparimit dhe shkencës, luftoni fenë. Feja është opium për popullin etj."* (faqe 459, Tiranë)

Në fjalorin e përmendur nuk u shpëtojnë ofendimeve, fyerjeve e përbuzjeve as kisha, xhamia, hoxha, prifti, Bibla, Kur'ani, madje edhe vetë Zoti, qoftë kjo edhe në formë të fjalëve të urta apo proverbave. Kështu për shembull për xhaminë dhe kishën thuhet:

Xhami,~a: *"Kur s'ke bukë në shtëpi pse çon vaj në xhami?"* (f. 2196)

Kishë,~a: *"Kërkon mbrojtje atje ku s'duhet, shkoj të zgjidhë një çështje atje ku nuk ia zgjidhin".* (f. 832)

Kurse për hoxhën dhe priftin shkruan:

Hoxh/ë,~a: *"Kush ha djathë nga hoxha, pëlçet nga uji"*, (f. 693)

Prift,~i: *"Barku i priftit është hambar për të ngrënë e për të marrë."* (f. 1545)

Për librat hyjnorë, Biblën e Kur'anin shkruan:

Bib/ël,~la: *"përmban dogma e mite të përbashkëta për fenë e hebrenjve e për fenë e krishterë"*, (f. 138).

Kuran,~i: *"Libër që përmban dogmat e fesë myslimane dhe legjenda të ndryshme mitike. Suret e kuranit."* (f. 922)

Për Zotin, Krijuesin e gjithësisë, Fjalori i Gjuhës së sotme shqipe, i vitit 1980, i botuar në Tiranë shkruan:

Zot,~i: *"Trilluar nga fetë e ndryshme, s'ka zot,. Nuk i lutemi më zotit."* (f. 2248). Kurse sipas fjalorit drejtshkrimor të gjuhës shqipe fjala zot shkruhej me shkronjë të vogël, ndërsa fjala Parti me shkronjë të madhe.

Botimi i ri me paragjykime te vjetra

Në parathënien e botimit të dytë të "Fjalorit të gjuhës së sotme shqipe", botuar në Tiranë, nga shtëpia botuese Toena, shkruan:

"Janë përmirësuar shpjegime e përkufizime fjalësh e termash duke i shkarkuar nga ngarkesa të panevojshme ose me karakter politizues etj. Ndërsa leksiku fetar është rivlerësuar e trajtuar në përputhje me të drejtën e lirinë e besimit që ekziston sot në vendin tonë".

Po, është e vërtetë se janë përmirësuar shpjegime e përkufizime fjalësh, termash, leksiku fetar, gjithashtu deri diku është rivlerësuar në fjalorin e ri, por ende kanë mbetur shumë gabime e paragjykime të vjetra. Ja disa paragjykime të vjetra që i shënon Fjalori i ri:

"Gjeti kishë (xhami) ku të falet kërkon mbrojtje a ndihmë atje ku nuk duhet ose atje ku nuk jepet", (f. 580). Apo **"Kur nuk ke bukë në shtëpi. pse çon vaj në xhami?!"** (f. 1448).

Bibël,~la: *"Dhiata e vjetër" dhe " Dhiata e re" (e para përmban mësimet e mite të përbashkëta për fenë e hebrenjve e për fenë e krishterë dhe e dyta është vetëm për fenë e krishterë).* (f. 109).

Kuran,~i: *Libër që përmban parimet e fesë myslimane. Suret e kuranit.*(f. 634).

Ne të gjithë e dimë se nëpër kisha e xhami përmendet, adhurohet dhe lavdërohet Zoti, Krijuesi i të gjitha krijesave dhe krijues i botës.

Në kishë u mbajt Kuvendi i Lezhës më 1444, në xhami u zhvilluan kuvendet e njohura shqiptare, si Lidhja Shqiptare e Prizrenit më 1878, Lidhja e Pejës, "Besa Besë" më 1899. Nëpër kisha dhe xhami u edukuan mendjet, zemrat e shpirtrat e shqiptarëve gjatë shekujve dhe u flijuan për fe,

komb dhe atdhe, siç ishin Myderriz Haxh Ymer Prizreni, Myderriz Haxhi Zeka, Myderriz Mulla Idriz Gjilani, Myderriz Haki ef. Sermaxhaj, Papa Kristo Negovani, Atë Anton Harapi, At Shtjefen Gjeçovi e shumë të tjerë.

Me gjithë të metat dhe mangësitë, "Fjalori i Gjuhës së sotme shqipe", i ribotuar në vitin 2002, nga Toena në Tiranë është shumë më i mirë se sa ia i vitit 1980, por ka nevojë për një korrigjim dhe ripunim të leksikut fetar. Sikur autorët të konsultonin "Fjalorin e feve", i botuar në Prishtinë, në vitin 2000, autor i të cilit është Akademik Ekrem Murtezai, nuk do të përsëritnin lëshimet e përmendura.

Me krijimin e rrethanave të reja, në Shqipëri, po ashtu edhe në trojet tjera ku jetojnë dhe veprojnë shqiptarët, me hapjen e kufijve të trojeve shqiptare, si dhe me ndryshimin e statusit të fesë në mesin e shqiptarëve, është krijuar një klimë e mirë që gjuhës shqipe t'i jepet një shtytje edhe në këtë aspekt. Unifikimi dhe shqipërimi i terminologjisë fetare ka një rëndësi të veçantë në zhvillimin e jetës kulturore të shqiptarëve, jo vetëm në aspektin e fesë, por edhe në aspektin kulturor dhe shoqëror në përgjithësi. Feja, nuk është vetëm një segment i ngushtë shpirtëror, por ajo ndërthet në vete edhe shumë aspekte tjera të jetës shoqërore.

Feja ka luajtur një rol të dorës së parë në mbijetesën e kombit shqiptar, në po atë shkallë si për disa popuj tjerë të lashtë. Ishte krishterimi që i dha një identitet më të fortë popullit shqiptar, ashtu siç ishte feja islame ajo që i diferencoi shqiptarët nga politika sllavizuese dhe helenizuese e fqinjëve që synonin asimilimin dhe gllabërimin e trojeve shqiptare. Flaka morale e përbashkët për parinë shqiptare të të gjitha besimeve ishte ajo e një zelli të lashtë, gërshtuar me një ndjenjë patriotike të zjarrtë. Njohja e fesë është domosdoshmëri e kulturës bashkëkohore, sepse nuk mund të njihet njeriu pa njohur fenë e tij. Fetë nuk kanë të bëjnë vetëm me kultin dhe moralin, ato janë thellë të lidhura me artin, letërsinë si dhe organizmin e jetës shoqërore.

Meqenëse, gjuha është njëri prej mjeteve më të rëndësishme që mesazhi islam të arrijë tek të gjitha shtresat e shoqërisë shqiptare, lindi nevoja e unifikimit dhe shqipërimit të terminogjisë fetare. Me fjalën terminologji kuptojmë tërësinë e fjalëve speciale që përdoren në fushatë e ndryshme të shkencës, të arteve, të gjuhësisë, por edhe të fesë. Gjatë periudhës së kaluar 20 vjeçare u kompletua përkthimi i librave të shenjtë në gjuhën shqipe. Vitin që shkoi ishte 10- vjetori i përkthimit të Biblës në tërësi në gjuhën shqipe, nga i ndjeri Don Simon Filipaj. Kurse këtë vit është 20-

vjetori i përkthimit të parë të Kur'anit në tërësi në gjuhën shqipe, nga prof. Dr. Feti Mehdiu.

Përkthimi i dy librave të shenjtë në gjuhën shqipe nuk ka dyshim se është një e arritur e madhe jo vetëm për teologjinë, por edhe një e arritur edhe për gjuhën shqipe. Kjo tregon se gjuha shqipe me kapacitetin e saj leksikografik është në gjendje të gjejë fjalë adekuate për të shprehur edhe ato kuptime të thella që ngërthejnë në vete librat e shenjtë, Bibla dhe Kur'ani. Ashtu siç thotë edhe Madleine Delbre: "Fjalët e librave të njerëzve mund të kuptohen dhe peshohen, kurse fjala e Zotit na peshon ne."

Mungesa e terminologjisë islame

Është e vërtetë se na mungon një terminologji islame e plotë dhe e njëtrajtshme. Dhe ka disa arsye që e bëjnë gjuhën shqipe "të vështirë " për përkthyesit dhe autorët e islamologjisë.

Së pari, përkthimi i teksteve islame në Shqipëri është kryer kryesisht gegërisht, pas shpalljes së pavarësisë së Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, në mesin e dhjetëvjetëshit të dytë të shekullit njëzet, atëherë kur pati edhe një zhvillim të hovshëm të publicistikës dhe mendimit islam në gjuhën shqipe, deri te fillimi i përkthimeve të para të Kur'anit në gjuhën shqipe.

Së dyti, kur gjuha shqipe po merrte tiparet e sotme, pushoi lëvrimi i tekstualitetit fetar në Shqipëri. Pra, periudha e viteve 1945-1990, nëse nuk përjashtohen disa përpjekje që në këtë aspekt u bënë në Kosovë, Maqedoni, në Mal të Zi dhe në diasporë

Së treti, pas rënies së diktaturës në Shqipëri nga shoqata të ndryshme islame u bënë përkthime jo profesionale dhe me nxitim me qëllim të mbulimit të vakumit që kishte mbretërua me vite të tëra. Kështu që kishte ankesa nga lexuesit e rëndomtë se ato tekste nuk ishin të kuptueshme sa duhet. Në këto rrethana, një përkthyes i nivelit mestar, nuk mund të sjellë në jetë asnjë tekst, në qoftë se nuk ka njohuri të thella në gjuhë dhe dije të mjaftueshme në teologjinë islame. Vetëm me një përgatitje të tillë përkthyesit tanë do të mundën të studiojnë tekstet ekzistuese dhe në pikat të fondit terminologjik të vendosin vetë. Hartuesit dhe përkthyesit të teksteve islame lypset që tekstet e tyre t'i përgatisin në atë mënyrë që ato të jenë të kuptueshme edhe për brezat "jofetarë", të cilët u arsimuan në vitet e shqipes standarde, me gjuhën e njëzuar. Bashkëpunimi me filologë shqiptarë jashtë

strukturave të Bashkësisë Islame është profesionalisht i domosdoshëm dhe në aspektin islam i dobishëm.

Këtë e themi se shumica e përkthimeve në gjuhën shqipe bëhet nga gjuha arabe, në të cilën zbriti libri i shenjtë i myslimanëve, Kur'ani, i cili është fjalë Zotit, përplot paraqitje figurative, gjë që nuk është lehtë të përkthehet në gjuhën shqipe. Këtu duhet potencuar edhe dallimet e mëdha që ekzistojnë ndërmjet gjuhës arabe dhe gjuhës shqipe, për shkak se ato i përkasin dy grupeve të ndryshme të gjuhëve si dhe dallimeve strukturore të tyre. Prandaj, me të drejtë thuhet se kur flasim për analogjitë teologjike, asnjë përkthim nuk shpreh plotësisht origjinalin, mbase edhe vetë "originali" nuk është i tillë, ai është një përjasje e atij realiteti, të cilin gjuha e njeriut përpiqet ta përshkruajë, por kurrë nuk mund ta përkthejë tërësisht, dhe aq më pak ta zëvendësojë atë. Pra, përderisa ne besojmë se gjuha e teologjisë është një realitet simbolik, si mund të interpretohen simbolet e dhëna ekzistuese në gjuhën shqipe me simbole të tjera, të huaja për trashëgiminë tonë kulturo-gjuhësore?!

Është një realitet së Bashkësitë Islame, që nga fillimi, pa far hezitimi jo vetëm se janë kyçur në rrjedhat e gjuhës standarde shqipe, por edhe kanë qenë aktive me qëllim që edhe ato ta japin kontributin e tyre modest në unitetin e kombit shqiptar nëpërmes predikimit të fesë islame me gjuhën standarde shqipe.

Me qëllim të çuarjes përpara të projektit të përbashkët të terminologjisë islame propozoj sa vijon:

1. Formimin e një komisioni të përbashkët nga të gjitha institucionet ton relevante për hulumtimin dhe studimin e mëtutjeshëm të terminologjisë islame.

2. Vazhdimin e organizimit të tryezave, konferencave dhe tribunave rreth kësaj tematike.

3. Unifikimin e përdorimit të terminologjisë islame në të gjitha trojet shqiptare dhe në diasporë.

4. Përpilimin e një glosari të terminologjisë islame.

Dr. Abdullah HAMITI

TERMINOLOGJIA ISLAME BEGATI KULTURORE

Me kalimin e Islamit te shqiptarët fillon edhe shtresimi i kulturës islame shpirtërore e materiale te shqiptarët. Për një kohë të shkurtër shqiptarët si shumicë i përkasin kulturës islame dhe thjeshtë fillojnë të jetojnë jetë islame. Shqiptarët fillimisht krijojnë vepra të karakterit islam në gjuhët orientale (shek 16/17) dhe që nga fillimi i shek. 18 krijojnë edhe shqip vepra fetare e kulturore islame dhe prej atëhere në literaturën shqipe fillon të shtresohet edhe terminologjia islame, sikundër që kishte filluar të shtresohet edhe në gjuhën e folur shqipe dhe terminologjia islame ishte bërë pronë egjuhës shqipe dhe përdorej nga të gjitha shtresat shqipfolëse dhe në të gjitha situatat e komunikimit.

Në gjuhën shqipe kemi forma të ndryshme të pranisë së kulturës islame në përgjithësi dhe në veçanti të terminologjisë islame e që paraqet një nga pikat shumë të rëndësishme të cilat meritojnë një rëndësi shumë të madhe kulturore e që si të tilla paraqesin një bazë shumë të volitshme për komunikim më të thellë.

Prandaj është e rëndësishme që ne të merremi edhe me islamin te ne, sepse islami dhe kultura islame te ne egzistojnë qe pesë shekuj, dhe vetëdija e dijet islame ishin përhapur në trojet tona dhe shqiptarët ishin pjesëmarrës aktiv në zhvillimin e atyre dijeve islame dhe të kulturës islame në përgjithësi. Dhe për t'u studiuar thesari kulturor i popullit tonë, i cili ka lind si rezultat i kontaktit të drejtpërdrejtë të lindjes islame dhe të vlerave të saj kulturore e qytetëruese me kulturën autoktone të popullit tonë dhe të bashkëjetesës së tyre pesëshekullore do përgatitje të mirë të njohjes së Islamit dhe të kulturës islame, pra sigurisht që duhet njohje e veçantë e

terminologjisë islame, e nocioneve islame të cilët ishin edhe bartës të mendimit islam.

Meqenëse arsimimi bëhej vetëm në gjuhët orientale, te shqiptarët krijohet një shtresë e mirë e dijetarëve e shkollarëve që njihnin mirë gjuhët orientale të cilët kanë krijuar në to, kanë përkthyer e komentuar nga gjuha arabe, perse e turke vepra të ndryshme të dijeve islame e të artit e të kulturës islame dhe pastaj plot tre shekuj kanë shkruar shqip me grafi arabe. Prandaj, nga njerëz të arsimuar mirë, njohës të letërsisë islame do të trashëgojmë vepra të çmuara të autorëve të njohur të literaturës alhamiade shqiptare. Ato vepra, shumë nga të cilat janë veprat e para të shkruara në ato të folme të shqipes prej nga ishte autori, janë material i mirë për studime gjuhësore për të folmet e caktuara shqipe, por edhe për studime të segmenteve të tjera gjuhësore, si bie fjala për shtresimin e terminologjisë islame në gjuhën shqipe. Gjithashtu studimi i kësaj terminologjile letrare-kulturore të shqiptarëve do të na mundësojë të gjykojmë për shkallën e integritetit të shqiptarëve në jetën krijuese shkencore e artistike orientale-islame. Dhe vetë fakti se kjo krijimtari ishte pëlqyer shumë në popull flet për faktin se kultura islame ishte përhapur në popull, se shqiptarët i përkisnin kësaj kulture. E pikërisht karakteri islam i saj edhe ndoshta ishte pengesë për studiuesit e deritanishëm që të trajtohet e vlerësohet pa paragjykime si pjesë e kulturës sonë.

Sepse, qëndrimin jobjektiv ndaj kësaj krijimtarie e theksojnë edhe studiuesit sot. Kështu J. Bullo konstaton: “Në historiografinë tonë letrare, letërsia e bejtexhinjëve shpesh është marrë e është parë me paragjykime nga mungesa e njohjes së plotë, ose nga një kompleks evrocentrik i shprehur a i nënkuptuar. Së këndejmi kjo trashëgimi letrare shqiptare duhet të publikohet dhe të studiohet shkencërisht në tërësinë e saj si një dukuri komplekse. Ajo meriton të bëhet objekt i një shqyrtimi tërësor dhe si një krijimtari që me lidhjet e saj të brendshme me kulturat e Orientit e me filozofinë islame i dha një dimenzion të ri letërsisë e kulturës shqiptare”.¹

Dhe vërtetë, ky dimenzion i ri që kjo krijimtari i dha letërsisë e kulturës shqiptare ka të bëjë me kulturën islame të shprehur si në jetën shoqërore sociale të shqiptarëve ashtu edhe në krijimtarinë e tyre artistike-

¹ Dr. Jorgo Bullo, *Një aspekt i ndikimit të kulturës islame ndër shqiptarët-poezia e bejtexhinjëve*, në **Feja, kultura dhe tradita islame ndër shqiptarët**, Simpoziumi ndërkombëtar i mbajtur në Prishtinë më 15, 16, 17 tetor 1993, botim i Kryesisë së bashkësisë Islame të Kosovës, Prishtinë, 1995, f. 246.

letrare. Prandaj, që të mund të studiohen këto krijime, duhet të njihet mirë kultura islame, tesavufi e filozofia islame, pra letërsia orientale-islame në përgjithësi, nga e cila janë ndikuar krijuesit e tillë shqiptarë si në teknikën poetike të shkrimit, ashtu edhe në përmbajtjen tematike. Dhe natyrisht se krijimet e tilla letrare që ishin në sferë të letërsisë së njohur islame (arabe, persiane, turke) kanë përdorur terminologjinë standarde të kulturës e krijimtarisë islame, terminologji kjo e cila ishte e përdorur me qëllim të caktuar, pra me funksion poetik.

Tekefundit, dihet se shkenca, arti e filozofia është një çështje qytetërimi, nuk është thjesht një çështje kulturore. Cilit qytetërim t'i përisni shkencën, artin e filozofinë do t'i krijoni me atë terminologji. Dhe gjatë kohës kur është krijuar literatura alhamiada shqiptare është krejt normale që ne i përkisnim qytetërimit lindor, prandaj edhe për ta reflektuar atë qytetërim, atë kulturë, në këtë rast kulturën islame do të duhej të përdoren termat e shprehjet unike të saj. Kështu del se zgjedhja e termave shkencore, artistike e filozofike është një çështje "qytetërimi". Prandaj në poezinë alhamiada për të shprehur shpirtin më të singertë, ndjenjat më origjinale duhej përdorur terminologjia standarde islame.

Dhe, pa dyshim se shembuj të përdorimit të terminologjisë islame dhe të kulturës islame në literaturën alhamiada shqiptare ka sa të duash që janë përdorur vite e shekuj me radhë si në shqipen e folur edhe në atë të shkruar që tregon se terminologjia islame është e ngulitur thellë në qenien e popullit tonë.

Ne këtu do veçojmë vetëm disa terme të zakonshëm që janë thjesht terme fetare islame, por njëkohësisht edhe terme të kulturës islame, si: Allah, pejgamber, namaz, sexhde, kible, sure, ajet, vahj-shpallje, mez-heb, ilm, xhennet, xhehennem, melaqe, hallall, haram, iman, din, dynja, ahiret, kijamet, mahsher, kader, exhel, insan, shejtan, qafir, kurban, taksirat, nur, divan, kaside, gazel, ilahi, sheriat, tarikat, hakikat, marifet, ziqër, mexhnun, abdal, divane, hal, makam, xhan, xhanan, ashk, ashik, sevda, dilber, dushman, munafik, fakir, dervish, xhahil, ibadet, takva-llëk, evlija, murshid, zahid, murid, muhib, saki, xham, behar-i, xhevahir, elmas ...

Por, qysh në kohën e Rilindjes Kombëtare, veçmas pas krijimit të shtetit shqiptar, kjo terminologji kulturore islame fillon të zëvendësohet me fjalë të tjera shqipe, por që kryesisht edhe janë me prejardhje të gjuhëve (neo)latine, e me nuanca kuptimore të kulturës së krishtere. Mendoj se nuk është e këndshme që terminologjia kulturore-islame të shqiptarizohet sepse

ajo tashmë ato ngjyrimë kuptimore e stilistike që i ka në origjinal vështirë se i shpreh me fjalë shqipe. Për të mos e zgjatur shumë unë do të ndalem vetëm në përdorimin e terminologjisë më të zakonshme dhe të nocioneve fetare standarde që zëvendësimi i tyre kujtoj se paraqet deformim të mirfilltë të terminologjisë islame. Prandaj, vlen të theksohet se përdorimi i drejtë i terminologjisë stabile islame dhe atë të qartë si nga aspekti filologjik ashtu edhe nga aspekti fetar e kulturor, si pjesë e kulturës së gjuhës, tregon nivelin kulturor të një populli.

Për shembull në vend të fjalës “Allah” të përdorësh fjalën shqipe “Perëndi”, apo në vend të “sure” të përdorësh “kaptinë”, në vend të “pejgamber” të përdorësh “profet”, në vend të “namaz” të përdorësh “falje/lutje muslimane”, në vend të “xhennet” e “xhehennem” të përdorësh fjalët “parajsë” e “ferr” mendoj se nuk është e drejtë. Sepse, kur këtë terminologji islame e eliminon, fitohet përshtypja sikur duam t’i ikim përkatësisë sonë fetare-islame, apo përkatësisë sonë qytetërimit islam.

Prandaj shqiptarizimi qoftë i terminologjisë thjeshtë fetare islame, qoftë i asaj thjeshtë letrare-kulturore islame e humb qëllimin e vet, sepse ajo terminologji ka shumë nuanca semantike dhe përdorim kontekstual. Kështu nuk mund të përkthehen shprehjet “haram” e “hallall” me fjalët “e ndaluar” dhe “e lejuar”. Sepse haram dhe e ndaluar dallojnë për faktin se e para bart atributin fetar, ndërsa e dyta atë tokësor. Kështu, kur përdorim fjalën “haram” kemi të bëjmë me një term islam që do të thotë se kemi të bëjmë me gjërat – veprimet që sipas rregullave islame janë të ndaluara.

Shumë fjalë të terminologjisë islame përdoren si metafora e simbole dhe shumë vështirë është të dijmë kuptimin shpesh të nijansuar të tyre të cilat nxisin asociacione shumë të ndërlikuara, sidomos ato të përdorura në shkrimet letrare si mjete themelore të shprehjes letrare. Për këtë arsye duke u bojkotuar me qëllim fjalët që duke u përdorur shumë kohë kan fituar shumë suptilitet, finesë e bukuri, dhe duke u përpjekur që në vend të tyre të futen fjalët me prejardhje shqipe apo (neo)latine që në vija të trasha i mbulojnë ato, i japim një goditje të rëndë gjuhës tonë. Andaj e kemi obligim që të mundohemi me shpirt që këto fjalë të cilat janë fryt i një mendimi dhe ndjeshmërie të thellë t’i mbajmë gjallë.

Unë mendoj se terminologjia e kulturës islame edhe pse sot nuk përdoret dendur në komunikim, për shkak të pasurisë së saj në jetën kulturore si dhe tek të gjitha shtresat popullore shekuj me radhë, duhet të standardizohet, të shpjegohet drejtë e mirë në fjalorin shpjegues të gjuhës

shqipe, sepse shumë prej tyre janë bërë pronë e popullit dhe e gjuhës tonë, dhe, këto fjalë tashmë janë bërë terme që përdoren në domene të shkencave islame, kulturore e filozofike.

Këto terme të pranishme në trashëgiminë tonë kulturore islame të shkruar e gojore përshkruajnë edhe nocionet e jetës mendore të krijuesve e ato kanë qenë nocione të qytetërimit e të kulturës islame. Prandaj, është qasje e gabuar, kur te ne entuziastët e kulturës perëndimore mundohen të plasojnë vetëm mendimin kulturor perëndimor duke i mohuar të drejtën e ekzistencës mendimit tjetër. Sigurisht që ne duhet të mendojmë e të veprojmë si evropianë, por ama atë mendim duhet ta ushqejmë me kulturën tonë shumëshekullore. Ai që nuk i del zot të kaluarës së tij historike, nuk mund t'i dal zot as të ardhmes së tij.

Për fund të themi se alhamiada shqiptare shpreh një traditë të mirë të stabilizimit të terminologjisë islame në të folmet shqipe e cila sigurisht se do të shërbente si një bazë për ne në punën për standardizimin e terminologjisë fetare në gjuhën shqipe. Përdorimi i terminologjisë islame për tre shekuj si i tillë në literaturën shqipe me alfabet arab pa dyshim se e përshkruan më besnikërisht gjendjen e gjuhës së folur dhe dëshmon se kjo terminologji islame ishte bërë pronë e ngulitur thellë në mendjen e shqiptarëve dhe leksik i gjuhës shqipe i pashmangshëm, pra ishte bërë edhe begati kulturore, sepse kjo është terminologji që simbolizon një kulturë të tërë, që simbolizon periudhën e përparimit shkencor e kulturor të botës islame, civilizimin islam, e njëkohësisht edhe mënyrën e të menduarit dhe të kuptuarit të asaj periudhe.

Shefkije ISLAMAJ

KULTURA GJUHËSORE DHE SHKRIMET FETARE ISLAME

Për rrethanat e sotme socio-gjuhësore shqiptare çështja e përdorimit të gjuhës standarde në ligjërimin fetar del me shumë interes. Konsiderohet e rëndësishme për gjuhësinë shqiptare edhe çështja - gjuha në shkrimet fetare, duke filluar nga Buzuku e deri te shkrimet më të reja fetare. Gjuhësia historike shqiptare ka traditë të pasur studimi për veprat e hershme të shqipes me karakter fetar, traditë kjo e ndërprerë më pas për arsye objektive. Edhe vetë çështja *feja dhe gjuha* është mjaft komplekse nga ana gjuhësore e jashtëgjuhësore për çdo bashkësi gjuhësore, sidomos për ne, shqiptarët, me shumësi besimesh e me shumësi praktikash fetare. Për fat të keq, në gjuhësinë shqiptare, mungojnë studimet nga kjo fushë, ashtu siç mungojnë edhe studime e vështrime për ligjërimin e sotëm fetar, rrjedhimisht edhe për kulturën gjuhësore të këtyre shkrimeve.

Gjuha fetare, sikur edhe njeriu, mbetet e lirë nga kufijtë gjeografikë e kombëtarë, sepse i përket çdo subjekti e çdo kohe. Siç dihet bashkësitë fetare janë të pakufizuara nga ana hapësinore e kohore, sepse ato nuk parakuptojnë vetëm njerëzit e përfshirë në faltoret, xhamitë ose kishat. Ato shtrihen jashtë kufijve të hapësirës së caktuar dhe përfshijnë besimtarët në rrafsh të gjerë. Shtrihen, gjithashtu, përtej kufijve të caktuar kohorë sepse ndihen të njësura edhe me botën që nuk njih kohë, me botën që gjendet në rrafsh përjetësie. Pavarësisht nga kjo, pavarësisht nga veçantia që karakterizon rrafshin fetar-gjuhësor, duhet ta dimë se pranimi i një gjuhe fetare për një besim në rrafsh kombëtar, do të thotë edhe përpjekje për njësim kombëtar në rrafshin shpirtëror, historik dhe kulturor.

Problematika e funksionimit të gjuhës fetare duhet të shihet si nga ana e parimeve teorike mbi zgjedhjen e gjuhës së shërbimeve fetare, ashtu edhe nga ana e praktikave fetare.

Përdorimi i gjuhës shqipe në jetën fetare është i një rëndësie të madhe shoqërore e rrjedhimisht edhe kulturore. Shikuar historikisht shqipja njeh përdorim në sferën fetare që nga fillimet e dokumentimit të saj, në të vërtetë ajo dokumentohet pikërisht në tekstet fetare dhe pas vetes ka një traditë të pasur e të gjatë të funksionimit të saj si gjuhë fetare. Ajo ka mundur ruajtjen e traditës fetare dhe paraqet lidhëse të gjallë me kulturën tonë të lashtë. Në shqipen, ligjërimi fetar karakterizohet nga veçoritë aktuale gjuhësore që shprehen edhe në ligjërimet e fushave të tjera. Natyrisht se ndjeshmëria gjuhësore e djeshme dallon pakrahasueshëm nga ndjeshmëria gjuhësore e sotme, prandaj nuk mund të flitet për konservim të gjuhës fetare dhe as për absolutizim të traditës, sepse nëse “feja është jeta” atëherë gjuha e saj patjetër do të durojë ndryshimet e kohës. Dhe kjo është më se e dukshme – gjuha fetare shqipe është zhvilluar dhe kultivuar në raport me vetë zhvillimet në gjuhë.

Është pranuar se ligjërimi fetar si një prej stileve të ligjëritimit gjuhësor të shqipes karakterizohet me problemet që pak a shumë i gjejmë edhe në ligjërimet e tjera të shqipes letrare, ndonëse mund të thuhet se në ligjërimin fetar ato janë më të mprehta për shumë arsye, po në rend të parë pse shumica e shkrimeve fetare duke filluar nga *Bibla* e *Kurani* e nga tekstet e tjera bazë, të krishtera e islame, janë përkthime dhe përkthimet vazhdojnë të jenë shënjuese të këtij ligjërimi, ndërsa dihet cilat janë vështirësitë që shoqërojnë përkthimet edhe jashtë shkrimeve fetare, se cilat janë ndikimet e gjuhëve nga na vijnë tekstet fetare në shqipen. Këto probleme e vështirësi kanë ndikuar dhe vazhdojnë të ndikojnë që në shqipen ligjërimet fetare të vazhdojnë të kenë fizionominë e një stili jo shumë të pavarur dhe jo shumë të qëndrueshëm. Problemet që na dalin në këtë ligjërim janë të njohura edhe për gjuhë të tjera dhe të tillat nuk janë zgjidhur as lehtë e as shpejt.

Për shqipen dhe për shqiptarët, problemet e kësaj natyre lidhen, në rend të parë, me ekzistencën e më shumë se një besimi dhe rrjedhimisht me praninë e disa predikimeve dhe disa terminologjive dalluese. Kur t'i shtohen këtyre ndalesat dhe mohimi i tyre për një periudhë jo të shkurtër kohore dhe gjuhësore janë fare të kuptueshme problemet që dalin në këtë ligjërim dhe në tekstet shoqëruese të tij. Prandaj ligjërimi fetar në kontekstin e ligjërimeve të tjera të shqipes sot ballafaqohet me më shumë probleme duke

filluar nga konsolidimi i këtij ligjërimi dhe deri te standardizimi i terminologjisë, një punë kjo sa e vështirë, aq komplekse.

Edhe problemet e kulturës thjeshtë gjuhësore nuk janë pak.

Ajo që bie në sy për të mirë në shkrimet e sotme fetare islame, me gjithë dobësitë që mund të vërehen në to, është përdorimi i gjerë i gjuhës standarde dhe përpjekja për një gjuhë sa më të qartë e sa më të përpiktë nga ana e normës gjuhësore. Mjafton t'u hidhet një vështrim shkrimeve fetare me karaktere e zhanre të ndryshme, duke mos përjashtuar edhe publicistikën islame, të botuara viteve të fundit, që të shihet se kultura gjuhësore në to njeh përpjekjen e shprehjes së më shqipe e sa më të kultivuar. Natyrisht se në këtë përpjekje ndonjëherë hetohen sforcime të cilat ndikojnë ndjeshëm që shprehja gjuhësore të karakterizohet shpesh me jo natyrshmëri si pasojë e të moskuptuarit dhe mosnjohjes së karakterit të këtij ligjërimi. Në këto përpjekje dalin edhe probleme jo të pakta që lidhen me mosnjohjen e duhur të rregullsisë gramatikore të shqipes, të zbatimit joparimor të normës gjuhësore e asaj stilistike, probleme këto të njohura e shumë të pranishme edhe në shkrimet e tjera të përdorimit publik të shqipes së sotme standarde dhe, përgjithësisht, karakteristike për kulturën tonë gjuhësore sot.

Megjithatë mund të thuhet me një siguri të plotë se ligjërimi fetar sot shënon një shkallë zhvillimi që e bën të krahasueshëm me ligjërimet e tjera. Ardhja e një brezi të ri të shkolluar në medresetë e në fakultetet tona islame brendashqiptare, i brezit të ngritur në gjuhën letrare, ka bërë që ligjërimi fetar gojor dhe ai në formën e shkruar të njohë ngritje cilësore të shprehjes, të njohë prirje e përpjekje për zhvillimin dhe konsolidimin e tij. Në kohën kur shqetësimi për kulturën gjuhësore ndër ne është i madh dhe kur ky shqetësim ka përfshirë jo vetëm rrethet gjuhësore, sigurisht që edhe vëmendja e gjuhëtarëve duhet të drejtohet edhe kah ligjërimi fetar, një ligjërim ky shumë i rëndësishëm në kuadër të ligjërimeve të tjera të shqipes.

Terminologjia islame.- Çështja e terminologjisë fetare bie në përgjegjësinë e shkencës gjuhësore. Realiteti i sotëm gjuhësor i shqipes ballafaqohet me probleme të shumta në rrafshin e terminologjisë, pothuajse në të gjitha fushat e dijes, ku më shumë e ku më pak. Prandaj gjuhësisë shqiptare sot i bien detyra jo të lehta dhe jo të zgjidhshme shpejt. Problemet që dalin në ligjërimin fetar në rrafshin e terminologjisë mund të bëhen pengesë për zhvillimin e një ligjërimi kombëtar të predikimit. Natyrisht, kur

them ligjërim fetar kombëtar i predikimit nuk duhet të parakuptohet një funksionim i njësisë të terminologjisë në shkallë të plotë për arsytet e ditura jashtëgjuhësore, në rend të parë fetare, po kam parasysh që brenda për brenda predikimeve tona fetare duhet të bëhen përpjekje më të mëdha për standardizimin e terminologjive përkatëse dhe për një shqipërim të mundshëm të termave që vijnë nga tekstet burimore. Përdorimi i një terminologjie të pa standardizuar dhe me tepri të huaj, si dhe shmangiet në rrafshet e normës gjuhësore, shpesh, e bëjnë të vështirë edhe vetë receptimin teksteve fetare. Receptimin e vështirësojnë edhe problemet që dalin në rrafshin semantik-logjik. Paqartësitë logjike, paqartësitë kuptimore e gjuhësore, janë pasojë më së shpejti e përkthimeve jo të mira ose e përkthimeve nga gjuhët ndërmjetëse. Çështja rëndohet sidomos me përdorimin me shumicë të termave të huaj. Mosnjohja e mirë e gjuhës burimore si edhe mosnjohja e shqipes në masën e duhur janë faktorë keqndihmues për problemet që shfaqen në shkrimet me karakter fetar në shqipen.

Bashkëpunimi midis teologëve dhe gjuhëtarëve do të ndihmonte në masë të madhe zhvillimin dhe konsolidimin e ligjërimit fetar në shqipen, do të ndihmonte cilësinë e këtij ligjërimit, do të ndihmonte afrimin e këtij ligjërimit me gjuhën e popullit dhe, natyrisht, do të ndihmonte standardizimin e terminologjisë. Siç na del pamja në tekstet fetare islame, ende jemi larg konsolidimit të këtij ligjërimit, ende mbetet e dëshiruar cilësia e këtij ligjërimit dhe ende nuk trajtohen seriozisht problemet e terminologjisë fetare. Mungesa e një lëvrimit të mirëfilltë të tekstualitetit fetar, mungesa e vazhdimësisë dhe, rrjedhimisht, edhe mungesa në sasi e trashëgimisë së shkruar fetare, si dhe mungesa e një fjalori teologjik kanë vështirësuar ndjeshëm punën e autorëve dhe përkthyesve të shkrimeve fetare islame. Siç na është e njohur, mungesa të tilla na paraqiten edhe në shkrimet kishtar-teologjike. Për këtë arsye sidomos njësimi i terminologjisë del punë me shumë rëndësi dhe ndërmarrje e pashtyshme nga autoritetet fetare-gjuhësore. Mungesa e një terminologjie të njësuar ka sjellë mbingarkim të sinonimisë. Mbingarkimi me sinonimi terminologjike në tekstet fetare islame, po edhe, përgjithësisht, në tekstet fetare të të gjitha predikimeve tona, është shumë i madh. Një mbingarkim i tillë hetohet sidomos në *Kuranin* e në *Biblën*, në të gjitha variantet e botuara të tyre. Mbetet e dëshirueshme që jo vetëm *Kurani* e *Bibla*, po edhe librat e tjerë bazë të predikimit t'i nënshtrohen një vlerësimi dhe, natyrisht, një botimi të ri, me

trajtim të veçantë për terminologjinë. Këtij vlerësimi e trajtimi duhet t'u prijnë:

- përgjithësimi i përvojës së vlefshme të deritashme në shqipërimin e termave të huaj;
- regjistrimi i problemeve aktuale nga praktika e sotme;
- vënia në dukje e nevojave për zgjidhje të reja në fushën e terminologjisë;
- mënjanimi i termave të huaj të zëvendësueshëm me të shqipes, duke pasur kujdes që të mos bëhen zëvendësime të sforcuara e me çdo kusht;
- mënjanimi i lëkundjeve e i dubleteve terminologjike;
- shfrytëzimi i mundësive e mjeteve gjuhësore të shqipes, sidomos i mundësive e mjeteve fjalëformuese;
- përpjekja për përcaktimin e drejtimeve bazë për punën që duhet të bëhet në këtë fushë duke caktuar parime e kritere të pranueshme nga teologë e gjuhëtarë.

Historia jonë gjuhësore na dëshmon se një prej ndikimeve të mëdha dhe intensive të gjuhëve të tjera mbi shqipen i përket gjuhëve orientale. Numri i orientalizmeve në shqipen sot është i konsiderueshëm, qoftë i atyre që kanë hyrë përmes gjuhës së folur, qoftë përmes gjuhës së shkruar, ndërsa kryet e vendit me to e mban pa dyshim terminologjia fetare islame. Terminologjia islame në përgjithësi është e burimit oriental dhe, ashtu si përgjithësisht terminologjia me burim të huaj në shqipen, ajo i është nënshtruar një zhvillimi e ndryshimi jo të vogël nëpër kohë. Shumë nga termat orientale tashmë konsiderohen të shqipes. Një numër i caktuar i tyre sot i përket shtresës arkaike të gjuhës dhe është pa një funksion në gjuhën e sotme. Me një vështrim më të thellë del në spikamë se një pjesë e termave apo fjalëve me prejardhje nga gjuhët orientale ka pësuar ndryshime semantike në kuptimin bazë dhe në kuptimet e ngjyrimet e tjera në shqipen. Përkthyesit e teksteve fetare duhet të kenë parasysh këto zhvillime e ndryshime semantike, sepse ka mjaft raste kur lexuesi shqiptar gjendet para mëdyshjeve nëse teksti është përkthyer si duhet dhe nëse është cenuar nga ana kuptimore. Një lehtësim për përkthyesit e teksteve fetare ka sjellë botimi i “Fjalorit të orientalizmeve” të Tahir Dizdarit (2005).

Mund të thuhet se në gjuhësinë shqiptare mbeten ende të pasqaruara në këtë kontekst disa çështje si këto: statusi i orientalizmeve në shkrimet fetare shqipe, vlera leksiko-semantike dhe funksionale e tyre, cilat janë

mundësitë e zëvendësimit të tyre me sinonimet e shqipes? Sqarimi i këtyre dhe çështjeve të tjera që nuk u përfshinë këtu, do të ndihmojnë që përkthimet fetare islame në shqipen të marrin pamjen e dëshirueshme gjuhësore.

Në ligjërimet fetare shqipe është e pranishme dukuria e interferencave gjuhësore dhe numri i tyre nuk është i vogël. Duke qenë se në shqipen njohim një terminologji shqipe të besimit të krishterë të ngulitur mirë, terminologjia e re në rrugën e krijimit dhe konsolidimit t saj ka ruajtur shumëçka nga e para. Kështu termat si këta *Zot, Perëndi, frymë, shpirt, i shenjtë, fe, dreq, qiell, ndrikull, lutje, e diel, truaj, krezmim, agjërim* etj. i gjejmë në terminologjitë e të gjitha besimeve tona.

Hetohet po kështu edhe dukuria e konkurrencës midis leksikut fetar me burim të huaj dhe atij me burim të shqipes. Përpyekja e zëvendësimit të termave të huaj, sidomos e termave abstraktë me burim nga gjuhët orientale, me terma të shqipes është intensifikuar shumë në shkrimet islame. Ruajtja e termave orientale ndodh me termat që shënojnë koncepte të përgjithshme, subjekte e objekte me karakter fetar, rite e ceremoni fetare, si bie fjala: *mysliman, iman, xhemat, xhami, melaqe, shejtan, ramazan, agjërim, natë e madhe, Bajram* etj.

Terminologjia fetare shqipe, pavarësisht nga burimi, është mbrujtur e zhvilluar nëpër breza shqipfolës dhe duhet të konsiderohet pjesë e traditës sonë kulturore fetare.

Çështje të përkthimit.- Për arsye që dihen, trashëgimia në shqip e shkrimeve me karakter filozofik e fetar vazhdon të shprehë varfëri në sasi e cilësi. Të tillë e bën edhe terminologjia e saj e papërcaktuar qartë. Përkthimet dhe krijimet nga ky rrafsh në kohët e fundit kanë marrë një zhvillim të caktuar. Përvoja në këtë kontekst mbetet për t'u dëshiruar, sepse turri për të përkthyer sa më shumë literaturë nga kjo fushë ka përfshirë edhe njerëz joprofesionalë në përkthimet dhe njerëz me njohuri të pakta gjuhësore të shqipes. Për rrjedhojë sot kemi numër të konsiderueshëm shkrimesh me përdorim jo të saktë të termave të ndryshëm, me përdorim të tepruar të fjalëve të huaja, me mosshfrytëzim të potencialit terminologjik të shqipes. Arsyeja kryesore e krijimit të një morie shkrimesh me vlera të pakta gjuhësore nuk vjen vetëm nga mungesa e kultivimit për një kohë të gjatë të mendimit fetar-filozofik, as nga mungesa e mjeteve gjuhësore të shqipes për

tekste të kësaj natyre, sepse gjuha shqipe është e pasur me fjalë që japin kuptime e ngjyresa të ndryshme, po më shumë nga mungesa e përpjekjes për të sjellë në shqipen shkrime korrekte gjuhësore ose nga mungesa e përfshirjes së njerëzve jokompetentë ose të pajisur me njohuri të pamjaftueshme fetare e gjuhësore për këto shkrime. Një lëvrime dhe përcaktim i terminologjisë si dhe një përpjekje më e frytshme për fjalëkrijim janë më të paktat që duhet të bëhen në fushën e përkthimeve me karakter fetar. Një lëvrime dhe një përcaktim i këtillë duhet të fillojë nga termat bazë, në mënyrë që gjuha e mendimit fetar-filozofik të ngrihet në standardin e gjuhëve të tjera të kultivuara.

Përkthimet e teksteve fetare, ashtu si përgjithësisht përkthimet, duhet të nisin mbi përpjekjet që gjuha të jetë sa më e kuptueshme, sa më e afërt e sa më besnike në raport me tekstin burimor. Duhet të kihet parasysh se asnjë përkthim, aq më pak fetar, nuk shpreh plotësisht origjinalin, po është rezultat i një përpjekje për të sjellë një realitet të caktuar. Kjo duhet të vlejë sidomos për tekstet që sjellin fjalën e Zotit. Përkthimi i teksteve që lidhen me mësimet kuranore, me etikën islame, me shërbesat fetare ose me shkrimet e tjera filozofiko fetare, duhet të kenë parasysh, në rend të parë, përdoruesin e tyre shpirtëror. Prandaj, çdo përkthim duhet të parakuptojë njohjen e mirë të gjuhës burimore dhe natyrën e saj, sepse, siç dihet, natyra e shqipes qëndron larg nga natyra e gjuhëve nga na vijnë tekste fetare islame. Pikërisht kjo largesë gjuhësore ka qenë arsyeja që botimet e *Kuranit* e të teksteve të tjera bazë të shoqërohen me dobësi të ndryshme. Për rrjedhojë vazhdon të na mungojë një variant i denjë gjuhësisht i *Kuranit*. Variantet që i kemi të *Kuranit* duhet të konsiderohen më shumë si përpjekje për gjetjen e formës më të përshtatshme të tij në shqipen. Ideali gjuhësor, sidomos për librin kryesor fetar – *Kuranin*, duhet të mbetet synim për të gjithë ata që i rreken punës së vështirë për ta sjellë *Kuranin* në shqip. Për përkthyesin nuk mjafton njohja e gjuhës burimore. Kusht thelbësor është edhe njohja e shqipes. Edhe për redaktorin gjuhësor nuk mjaftojnë vetëm njohuritë gjuhësore. Njohuritë fetare duhet të jenë në shkallën e duhur.

Përkthimi i tekstit fetar edhe në rast se i afrohet maksimalisht gjuhës së gjallë, gjuhës së popullit, vetvetiu nuk siguron të kuptuarit. Receptimi i tekstit fetar gjithmonë parakupton jo vetëm anën gjuhësore, po edhe anën kuptimore. Shumë nga shprehjet e formulat në librat e shenjtë, edhe në rast se plotësojnë këto kushte, nuk do të kuptohen pa shtresën përkatëse teologjike, pa nëntekstin e parakuptuar. Prandaj duhet të kihet parasysh se

vetëm përkthimi i teksteve fetare nuk mund të sigurojë automatikisht edhe të kuptuarit e tyre. Përkthyesit duhet të depërtojnë shpirtërisht, emocionalisht dhe intelektualisht në tekstet burimore në mënyrë që kultura shpirtërore të shfaqet në dritën e duhur përmes gjuhës së sotme shqipe. Vetëm gjuha e kuptueshme, e afërt, e bindshme do të pranohet gjerësisht dhe do të mund të realizohej misioni i paravënë.

Përkthyesit e teksteve fetare duhet ta kenë parasysh edhe faktin se gjuha e fesë është një ligjërim i veçantë dhe zbatimi shumë i rreptë i normës gjuhësore prek natyrën e karakterin e saj. Shprehja gjuhësore fetare duhet ta ruajë ngjyrimin e mistikës, të së shenjtës, të së panjohurës, të së përrjetshmes. Përzgjedhja në rrafshin stilistik, variacionet në rrafshin sinonimik, variantet fjalëformuese, përdorimi sa më i matur i fjalëve të reja e të huaja, përdorimi sa më i paktë i leksikut publicistik, do të ndihmojnë që shprehja gjuhësore e ligjërimin fetar të jetë më e pranueshme prej atyre të cilëve u drejtohet.

Siç dihet, në jetën liturgjike është e domosdoshme të synohet sendërtimi i lidhjes midis fjalës dhe vetëdijes. Të kuptuarit e përmbajtjes dhe të aspektit fetar-ndikues është kusht për zhvillimin e përgjithshëm të jetës shpirtërore të besimtarëve. Prandaj me fjalën e duhur, me gjuhën e saktë e të kuptueshme gjithçka duket më e afërt dhe më e pranueshme. Cilësia e pranimin, e pranimin ndërpersonal, varet pikërisht nga shkalla e njohjes së përmbajtjeve fetare-ndikuese dhe e shprehjes gjuhësore. Të kuptuarit e rrafshit gjuhësor, prandaj, është parakusht për të kuptuarit dhe për njohjen e vetë thelbit, ndonëse është e njohur se në teologji “asnjë fjalë, asnjë paraqitje nuk është e mjaftueshme dhe nuk mund të depërtojë tek e vërteta”.

Sa të kuptueshme na dalin tekstet fetare për bartësit e shqipes nga ana nocionore dhe nga ana gjuhësore ose sa janë të dekodueshme morfema e fjalë të caktuara me burim jo shqip - janë çështje të një rëndësie jo të vogël, por që ende nuk shtrohen as si duhet e as sa duhet. Vështruar nga ky kënd problemi nuk është i vogël. Vështirësitë në të kuptuarit dhe në të shpjeguarit që na shprehen në tekstet e shumta fetare janë karakteristikë e shumicës së tyre. Në vijim po sjellim një tekst të nxjerrë nga *Kurani* i vitit 1978 i botuar në Prishtinë për të parë se shpesh, jo vetëm në këtë përkthim të *Kuranit*, na dalin tekste jo të qarta nga ana kuptimore, se shpesh na dalin tekste me gabime të shumta drejtshkrimore, morfologjike, sintaksore e stilistike:

“A nuk i shohin ata se ne i sjellim pakësimin e tokës (së tyre) nga të gjitha anët e saj.” !!!

“Jo, pse, sikur ta dinit me një dije të sigurt (nuk do të bënit ashtu).” (f.729) - në vend të - *sikur ta dinit sigurt ju nuk do të bënit ashtu*, etj. etj.

“Juve u (ju) preokupoi përpjekja për shumimin (e pasurisë, të fëmijëve, të pozitës)!” (f. 729) - në vend të – *Ju u morët më shumë me rritjen a shtimin e pasurisë, për lindjen e sa më shumë fëmijëve, për zënien e sa më shumë pozitave*, etj. etj.

“Mandej pas tij *dërguam të dërguar* te popujt e tyre ...” (f. 254).

“**Vërtet**, Allahu ju pat *premtuar premtim të vërtetë*, e unë ju pata *premtuar* dhe, qe, nuk zbatova *premtimin* ndaj jush” (f. 299).

ose: “Po ju nënshtroi diellin dhe hënën që në mënyrë të zakonshme vazhdimisht udhëtojnë.”?!!! (f. 300).

Tekstet e dhëna provojnë se autorët e përkthimeve të Kuranit në shqipen në të shumtën e herës nuk kanë arritur të depërtojnë në shkallën e duhur në thelbin e lëndës fetare; provojnë se njohja e gjuhës burimore nuk është në shkallën e duhur; dëshmojnë se edhe njohuritë gjuhësore të shqipes nuk janë të dëshirueshmet; dëshmojnë ndjenjë të munguar gjuhësore e fetare..

Një problem të veçantë në këtë tekste paraqet edhe përdorimi i tepruar i fjalëve të huaja dhe shpesh përdorimi i pavend i tyre.

“Allahu i ofron *furnizim* me bollëk atij që do dhe ia kufizon.” (f. 294).

“*Obligimi* yt është vetëm kumtimi, kurse jona është *llogaria*.” (f. 294).

“Ai (Jusufi) tha” “A e dini çka keni bërë me Jusufin dhe vëllain e tij, kur ishit *injorantë*.” (f. 285) – me gjasë fjala është për .kuptimin “të pa informuar”.

“”E kur e humbën shpresën prej tij, u veçuan për t’u *konsultuar*.” (f. 284).

Ç’do fjala *furnizim* në Kuran, apo fjala *llogari*, apo më në fund edhe *obligim* në vend të sinonimeve shqipe më të afërta për gjuhën e pranueshme sidomos për besimtarët? Sinonimi *peshoj* ashtu si edhe bisedorja *bëj hesap* do të ishin më të pranueshme se fjala *llogaris* në një tekst si ai që sollëm, ashtu si edhe sinonimet *detyrë* a *zotim* në vend të fjalës *obligim*, pastaj *të painformuar*, *të padijshëm*, ose *të paudhëzuar* në vend të *injorantë* apo për t’u marrë vesh në vend të për t’u *konsultuar*.

Po sjellim edhe një shembull për të parë se në ç'masë e vështirëson kuptimin përdorimi i tepruar i fjalëve të huaja:

“Nëse hyj në *saff* me *namazlitë* do të shqiptoj tekbinin e parë, nëse janë në *ruku*, në sexhde ose të ulur do ta shqiptoj tekbinin e dytë ...” (“Ta mësojmë islamin”, Prishtinë 2004, f.55.)

Receptimi i këtij teksti del i vështirë, pikërisht për arsye të pranisë së fjalëve të panjohura. Natyrisht, ky problem lehtësohet shpesh me aktivizimin e mekanizmit psikologjik të parandjenjes për vënien e lidhjeve kuptimore dhe për vënien e analogjive brenda e ndërgjuhësore. Duke pasur parasysh se në shqipen leksiku oriental ka shtrirje të gjerë në të folmet dialektore, për një shtresë të caktuar njerëzish, teksti del pak a shumë më i pranueshëm se për brezin e ri të ngritur e të shkolluar në gjuhën letrare.

Megjithatë mund të themi se nga shkrimet e shumta që përkthehen sot mund të veçojmë botime që shquhen me kujdesin e duhur gjuhësor e stilistik. Në këtë rast po i veçoj vetëm disa nga ato: *Besimi* (bazat, esenca, negacionet), *Etika islame*, *Ta mësojmë islamin*, *Mrekullitë shkencore në Kuran* etj.

Një receptim më të mirë të teksteve fetare do të mund ta ndihmonte ndërhyrja edhe në rrafshin e sintaksës, në të vërtetë në aspekte të caktuara të sintaksës së shqipes kuranore, para se gjithash në kontekstin e ndërrimit në rendin e fjalëve dhe të gjymtyrëve të fjalisë, pastaj ndërhyrjet në shenjat e pikësimit; zëvendësimet me mjete të barasvlershme; zëvendësimi i rrethit të caktuar leksemor dhe i leksemave të shënuara si sinonime theksueshëm arkaike, me të tjera pa këtë shënjim etj. etj.

Një prej detyrave me përparësi në fushën e ligjërimit fetar do të ishte, siç e theksuam edhe më lart, vlerësimi shkencor i shkrimeve të shenjta, kjo do të thotë se tekstet fetare bazë duhet të rimerren nga teologë e nga gjuhëtarë profesionistë, në mënyrë që ato të bëhen edhe tekste bazë standardologjike gjuhësore për shkrimet e ndryshme me karakter fetar e filozofik që botohen me shumicë sot. Edhe vetë tekstet burimore në gjuhën arabe kanë pësuar shumë redaktime, përmirësim ose botime kritike, botime të tilla kritike që në shqipen, fatkeqësisht, janë të papërfillshme ose mungojnë. Përkthimet duhet të shoqërohen patjetër me punë të vëllimshme tekstologjike, me shkrime kritike, të tilla që kanë shoqëruar botimin e Kuranit e të teksteve të tjera të rëndësishme fetare në gjuhë të tjera kombëtare, me rastin e përkthimit të tyre. Përcaktimi i metodologjisë së

punës duhet të shoqërojë domosdo përkthimet fetare në shqipen, metodologji që tashmë është konsoliduar në shumë gjuhë kombëtare të pasura me përkthime nga fusha e teologjisë. Duhet të shfrytëzohet një përvojë e tillë.

Përfundim.- Në këtë vështrim të shkurtër kemi synuar të prekim disa nga problemet me të cilat ndeshen shkrimet fetare në shqipen dhe, si përfundim, mund të themi se diskutimet për gjuhën në shkrimet fetare dhe, sidomos, për çështjen e terminologjisë duhet të hapen, të zhvillohen e të bëhen gjithëpërfshirëse nga një rreth më i gjerë. Ligjërimi fetar shqip duhet të shoqërojë qartësimin e konsolidimin e mendimit fetar shqiptar. Ka ardhur koha e hartimit të një fjalori të termave filozofikë e fetarë nga specialistë të fushave në bashkëpunim me gjuhëtarët.

Gjuha fetare është një realitet simbolik. Interpretimi i simboleve ekzistuese në shqipen duhet të bëhet sa më besnikërisht dhe në pajtim me trashëgiminë tonë kulturore e gjuhësore. Gjuha standarde është realitet gjuhësor i shqiptarëve. Shkrimet fetare duhet të jenë në shqipen standarde, sepse numri më i madh i besimtarëve të rinj sot u formua gjuhësisht në shqipen standarde, prandaj është më së e natyrshme që brenda saj të zhvillohet edhe jeta shpirtërore e folësve të saj.

Ligjërimi fetar shqip duhet të përjetohet si pasuri e shqipes dhe si e tillë duhet ta ketë vendin që i takon në rrafshin e ligjërimeve të tjera të saj. Gjuha shqipe ka dëshmuar se ka mundësi për të përthekuar kërkesat shpirtërore e materiale të shqiptarëve, edhe ndër kohë të mëdha ka dëshmuar se ka mundësitë për t'ua afruar besimtarëve botën hyjnore, jo vetëm me potencialin e vet po edhe me prirjen për asimilimin, modifikimin dhe shqipërimin e lëndës së huaj gjuhësore.

Shkurt 2006

Isa BAJÇINCA

PROBLEME TË TERMINOLOGJISË FETARE DHE TË KULTURËS SË GJUHËS

(Pa e ditur temën e kësaj konference, unë kisha vendosur të merresha me gjuhën e përkthimeve të Kuranit në gjuhën shqipe, një temë që e kam pasë diskutuar gjerësisht në një artikull botuar tek revista “Dituria Islame” – në vitin 1994, por, sa mësova saktësisht temën e kësaj konference, vendosa të shtroj disa çështje që lidhen pikërisht me terminologjinë, gjithnjë vështruar edhe në kuadër të një fushe të gjerë të kulturës, siç është kultura e gjuhës.)

Diskutimi i një çështjeje kaq të rëndësishme të dijes e të kulturës në përgjithësi në një veprimtari shumë serioze, sikur është kjo konferencë e sotme, për mendimin tim, shtrohet në tryezë në një kohë si përpjekjesh për të ngritur shkallën e zotërimit e të zbatimit të shqipes standarde në fusha të ndryshme të jetës mendore e shpirtërore, ashtu edhe dilemash, në qoftë se mund t’i quaja kështu, ose të paktën hamendjesh që kanë prodhuar disa qëndrime e pikëpamje deri në shpërfillje të standardit, nga disa autorë, me kërkesën që problemi i standardizimit të shqipes të rishtrohet, gjithnjë me arsyetimin se shqipja na qenkësh standardizuar në kushtet kur të gjitha veprimtaritë kulturore, letrare e shkencore na u zhvilluakëshin nën shtypjen e një pushteti totalitar të skajshëm!

Krahas përfilljes e tolerancës ndaj qëndrimeve të tilla lidhur me standardin, të cilat janë krejtësisht të kundërta me qëndrimet dhe me bindjet e mia pse jo, më duket sikur nuk është theksuar ku, sa dhe si duhet, rëndësia e jashtëzakonshme, në fund të fundit, edhe shpresat e mëdha që kishin mbështetur shqiptarët jashtë Shqipërisë tek standardizimi i shqipes në vitet shtatëdhjetë të shekullit të kaluar, sepse ajo ngjarje kulturore sikur

sendërtonte një nga synimet dhe aspiratat që kishin ushqyer shqiptarët për një kohë të gjatë – për t'u bashkuar, dhe kjo ndodhte në gjuhën, një veçori kjo e popujve të qytetëruar. Dhe jo vetëm kaq, veçse, pavarësisht nga kërcënimet që mund të prodhonin ndëshkime të ashpra nga ana e Partisë Komuniste të Serbisë, - jo një grusht intelektualësh, po të gjithë intelektualët shqiptarë të Kosovës (e të viseve të tjera shqiptare këndeje), të lidhur ngushtë **për litarin** (dua të përdor një figurë nga Kurani), të mbështetur deri në shkallën e një entuziazmi të veçantë nga tërë populli, - e përqaftuan atë standard dhe u zotuan të bashkoheshin në përpjekjet për të ngritur shkallën e kulturës jo vetëm të gjuhës.

Duhet vënë në dukje gjithashtu se edhe prijësit fetarë të të gjitha besimeve, e kjo ka të bëjë kryesisht me prijësit fetarë në Kosovë dhe në viset e tjera shqiptare jashtë kufijve shtetërorë të Shqipërisë, pa ngurruar fare u inkadruan në ato përpjekje, për të zotëruar e për të zbatuar standardin, qoftë në sistemin e edukimit – në shkollat fetare, qoftë në ligjërata e në komunikime me publikun dhe qoftë në revista e botime të tjera fetare e në dokumentacionin administrativ.

Tek përqaftimi i standardit nga ana e prijësve fetarë shqiptarë, jam i prirur të zbuloj jo vetëm lidhjen e ngushtë të tyre me grupin e intelektualëve, le t'i quaj shekullarë, po edhe më shumë, gatishmërinë e tyre, ashtu sikur edhe gjatë historisë sonë, që prijësit fetarë të gjenden gjithmonë brenda lëvizjeve përparimtare. Le të ketë qenë kjo pjesëmarrje dhe jo aq aktive në ndonjë mes të caktuar fetar, po mjafton që nuk u vunë të kundërshtonin këtë arritje të kulturës sonë drejt bashkimit, ashtu sikur kishin trumbetuar për një kohë komunistë aktivistë për, gjoja, përpjekjet e klerit (në qendra të veçanta) për të përçarë dhe për të penguar përparimin kulturor të shqiptarëve!

Jo vetëm përndjekjet dhe ndalesat që u zbatuan një kohë të gjatë ndaj klerikëve intelektualë në Shqipëri, po ndoshta edhe injorimi deri në shpërfillje i klerikëve intelektualë dhe i veprimtarisë fetare në Kosovë e në viset e tjera shqiptare këndeje, - përbëjnë një çështje që duhet studiuar e shpjeguar – si një e keqe e madhe e regjimeve të kohës.

Kujtoj që është meritë e prijësve fetarë të religjioneve tona që, pavarësisht nga trysnia dhe pësimet e shumta, pas shembjes së shoqërive totalitare, morën veten shumë shpejt dhe, me tërë forcën që mund të ushqejë vetëm besimi me bindjen e thellë tek Krijuesi, - të gjithë si një, u vunë në radhët e intelektualëve përparimtarë dhe nuk kursyen asgjë për ta nxjerrë popullin nga mashtrimi i madh – në dritën e së Vërtetës, në kushtet që njeriu

t'i kthehet vetvetes dhe besimit. Në këto përpjekje unë shoh edhe këmbënguljen që në botimet fetare, qofshin përkthime të librave të shenjtë dhe qofshin studime për probleme të veçanta të religjionit, të moralit e të nevojës për të mbjellë dashurinë dhe besimin tek populli, - gjithandej të bëheshin përpjekje serioze për të zbatuar shqipen standarde, pavarësisht nga prejardhja dialektore ose nëse do ta kishin arritur edukimin e tyre në gjuhën shqipe ose në ndonjë gjuhë tjetër!

Terminologjia përbën një nga fushat më të ndërlikuara në të gjitha fushat e dijes, dhe kjo është një gjë e ditur. Veçse terminologjia fetare ngërthen edhe vështirësi shtesë, sidomos në kushtet kur një popull ka disa religjione, sikur është populli shqiptar. Dhe kjo jo vetëm për faktin se në religjione të ndryshme vijnë ndikime të ndryshme nga shkencat fetare në gjuhët, le t'i quaj, burimore ose të mëdha, po edhe për faktin se traditat nuk janë të njëjta ndër besime të ndryshme dhe sepse, krahas ndikimeve të drejtpërdrejta, shumë terma kanë ardhur të përthyer nëpërmjet ndonjë gjuhe tjetër, siç ka ndodhur, po e zëmë, me disa terma fetarë islamë – që në shqipen kanë hyrë nga turqishtja.

Pavarësisht nga këto rrethana, mendoj që duhen kërkuar mundësi që në të gjitha besimet tona – në gjuhën shqipe të përdoren sa më shumë terma të njëjtë, dhe kjo vlen duke nisur që nga nocionet kryesore, sikur janë *Perëndi/Zot/Allah, Engjëll/Melek, Profet/Pejgamber/I dërguar, Paajsë/Xhenet, Ferr/Xhehenem, Mëkat/Gjynah* e të tjera, natyrisht duke ruajtur mundësinë e përdorimit të tyre, herë-herë të dyfishtë, po edhe për qëllime stilistike...

Dua t'jua kujtoj se në përkthimet e Kuranit është përdorur edhe fjala Allah, edhe fjala Zot – për Krijuesin, përkatësisht – Allah në përkthimin: *"Shpjegimi i kuptimeve të Kur'anit të Lartë në gjuhën shqipe"* (Përkthyes, Dr. Muhamed Taki-ud-DinEl-Hilali dhe Dr. Muhamed Muhsin Khan); krahas Allah/Zot (sigurisht jo pa arsye) – në përkthimet: *"Kur'ani dhe hija e tij"* (Skup, Stamboll 1999, përkthyes Dr. Feti Mehdiu): *"All-llahu i ka vulosur zemrat e tyre dhe veshët e tyre... (sure El-Bekare, 7) dhe: "O njerëz! Adhuroni Zotin tuaj, i cili ju ka krijuar ju(ve) edhe ata përpara jush..."* (Po aty, 21) –; **"Kurani Kerim"** (përkthyes, Zakharia Khan, 2003): *"Vërtet Allahu kurrë nuk vepron kundër premtimit të Tij"*. (sure Ali-Imran, 10) dhe: *"Vërtet, Zoti yt e furnizon me bollëk atë të cilin e do Ai..."* (sure Isra, 31) dhe **"Kur'ani"** – përkthim me komentim në gjuhën shqipe" (përkthyes Haxhi Sherif Ahmeti, botuar në Prishtinë dhe ribotuar disa herë): *"Thuaj: "Zoti*

ynë na tubon neve dhe juve..." (sure Sebe, 26); "*Është e vërtetë se Allahu dhe engjëjt e Tij me madhërim e mëshirojnë Pejgamberin.*" (sure El-Ahzab, 56).

Duke mbajtur parasysh kërkesën për një terminologji të njësuar dhe këto që u thanë, po sidomos shkallën e kulturës së gjuhës në përkthimet e Kuranit (ndonëse në disa pjesë kjo vlen edhe për përkthimin e Biblës nga Simon Filipaj, redaktuar nga disa studiues), del kërkesa që përkthimet e veprave kapitale, dhe kjo sidomos për përkthimet e librave të shenjtë, ashtu sikur në kulturat e tjera, edhe në kulturën tonë, - të jenë jo pasqyrë e kulturës që ka arritur përkthyesi, bashkë me redaktorët a korrektorët letrarë, po të jenë përkthimet më të mira të mundshme, do të thotë të jenë pasqyrë e shkallës së zhvillimit që ka arritur gjuha në kohën e botimit, prandaj redaktimi duhet t'u besohet ekspertëve të mirëfilltë!

Për ta përfunduar dua të theksoj se janë dy arsye pse shqipja e përdorur në veprimtarinë e në botimet fetare – duhet të jetë pikërisht shqipja standarde jo dosido, po e zbatuar me saktësi: **E para**, shkrimet, po dhe ligjërimi fetar në përgjithësi, do të jenë të thithshme për një masë më të gjerë jo vetëm besimtarësh (nuk është e rëndësishme të cilët religjion), po edhe intelektualësh përgjithësisht, të cilët duan të njihen sa më hollësisht me probleme që diskutohen në këtë fushë të rëndësishme të jetës së njeriut jo vetëm të kohës sonë; **E dyta**, sepse secili autor, le të jetë ligjërues ose shkruer, si intelektual, mban përgjegjësinë për edukimin gjuhësor, sidomos të brezit të ri, prandaj edhe botimet fetare duhet të jenë të tilla që të ushtrojnë ndikimin e tyre në ngritjen e kulturës së gjuhës, - një kërkesë dhe një shqetësim që vjen e bëhet gjithnjë e më i mprehtë sidomos në kohën e shthurjeve të mëdha – nga lëvizjet e një pjese të madhe të shqiptarëve në vise të ndryshme të botës, sot të vogël!

Ismail BARDHI

TERMINOLOGJIA TEOLOGJIKE SI PROBLEM

“Dhe (Allahu) ia mësoi Ademit emërtimet e të gjitha sendeve e pastaj ua prezatoi engjujve dhe u tha: ‘Më informoni për emrat e tyre, nëse flisni të vërtetën!’”

(el-Bekare, 31)

Çdo gjë filloi me fjalën “*ve al-leme Ademe’l esma’e kul-leha...*” (“Dhe ia mësoi Ademit emërtimet e të gjitha sendeve...”). Këtu fjala “el-esma” nënkupton qenësinë e brendshme dhe karakteristikat e sendeve dhe se në ato “sende” është përfshirë si e prekshmja ashtu edhe ndjenja (Ibn Kethir). Aftësia që të krijuarën ta emërtojë dhe ta kuptojë është çelësi i njeriut për mëkëmbësinë në tokë... (Sejjid Kutb). Në filozofi për këtë do të thuhej koncept (Bejdaviu). Kurse me shprehjen “simbole” mundemi ta gjejmë në interpretimin e Ibn Arebisë.

Përpjekja rreth gjetjes së të shprehurit sa më të përshtatshëm gjuhësor për mendimin teologjik është e vjetër sa edhe vetë teologjia, por ajo di që kohë pas kohe të forcohet dhe mprehet dhe atë në situatat të cilat karakterizohen ose me depërtimin e ideve dhe drejtimeve zhvillimore të reja, ose në ato në të cilat sapo fillon të shprehurit teologjik në gjuhën e ndonjë grupi të caktuar etnik. Kjo vlen për ato mjedise ku kultura nuk ka përjetuar ndërprerjet historike, politike, shoqërore e fetare në zhvillimin e saj. Në situatën tonë, nëse vetëm përciptazi i bëjmë një vështirësi asaj, vërejmë llojlojshmërinë e madhe të synimeve dhe ndryshimin e zgjidhjeve terminologjike, edhe pse në mesin tonë ka edhe të atilla që janë më shumë të orientuara sociologjikisht dhe mëtojnë kuptimësinë sa më të mirë shoqërore, mbisundimin e tendencës individuale, gjegjësisht që individi sipas dëshirës

së vet t'i zgjedhë terminet për të cilat mendon se i përgjigjen më së miri. Konsideroj se kjo është e arsyeshme, nëse gjatë kësaj jepet arsyeimi për dallimin nga përdorimi i zakonshëm i terminit, e jo si, për fat të keq, kur nocionet fetare në fjalorin zyrtar dallohen shumë nga kuptimi i tyre burimor, i cili lehtë gjendet nëpër fjalorë të huaj. Një karakteristikë pozitive e situatës bashkëkohore terminologjike në të vërtetë është ajo që është e hapur: mundësia për gjetjen e vetëpërgjegjshme të termineve, e që në një periudhë më të gjatë do të ketë për rezultat faktin se gjithnjë e më tepër në përdorim do të mbeten ato më të përshtatshmet, ndërsa të papërshtatshmet, të shumëkuptimtat apo ngjashëm, do të zhduken. Përcaktimi dogmatik i terminologjisë nuk do të jepte rezultate të tilla, por, me siguri, të kundërtën. Kështu me llojllojshmërinë e lirë të orientimit terminologjik arrihet deri te harmonia gjithnjë e më e madhe, përkrah ruajtjes së linjave të reja zhvillimore.

Terminologjia teologjike nuk krijohet ndryshe pos në vetë teologjizimin, e që këtu ata të cilët merren vetëm me çështjen e terminologjisë teologjike nuk mundën të bëjnë gjë pos t'i regjistrojnë rezultatet e vet teologjizimit. Asnjë forum nuk mund ta përcaktojë apo urdhërojë terminologjinë teologjike, sepse terminologjia nuk përcaktohet por krijohet.

Në teologjizimin tonë islam, përkundër disa përpjekjeve të pakta të cilave megjithatë duhet t'u falënderohemi, akoma në tërësi dhe në mënyrë shkencore nuk është hulumtuar dhe shqyrtuar emërtimi teologjik. Ky pohim vlen edhe për shkencën gjuhësore. Këtu duhet thënë se edhe fjalorët tanë filozofikë, të cilët në vete përmbajnë edhe terme teologjike, gjithashtu janë përpjekje e mirë e evidentimit, përshkrimit dhe themelimit të emërimit qoftë filozofik qoftë teologjik. Mirëpo, sado që këta fjalorë në vete paraqesin lëvizje në sferën e emërimit filozofik e teologjik, aq më tepër sot nevojitet një qasje më e thellë, më përmbajtësore dhe më përfshirëse ndaj çështjes së emërimit. Si njëfarë pikë referimi në këtë drejtim mund të na shërbejnë fjalorët ekzistues të fushave të ndryshme teologjike islame në gjuhë të tjera, qofshin ato të periudhave më të hershme ashtu edhe të atyre bashkëkohore, si p.sh. *Ta'rifat*, nga Ali ibn Muahammed al-Xhurxhani; *Mefatih-ul-Ulum*, nga Muhammed ibn Ahmed al-Hvarizmi; *Lexique de la Langue philosophique t'Ibn Sina*, nga A.M. Goichon (Guashon), *Makasid el-Felasife*, nga Imam el-Ghazaliu; pastaj *The Easy Dictionary of Qur'aan*, nga Shaikh Abdul Karim Parekh, *Islamic Encyclopedia*, *Leksikon Islama*,

nga Nerkez Smailagiq, etj. Këtu gjithsesi duhet t'i veçojmë edhe veprat *Fjalori i feve* dhe *Fjalori i filozofisë*, të akademik Ekrem Murtezait si një hap nismëtar në këtë fushë tek ne.

Para se të nisim me orvatjen e kontributit personal për shqyrtimin dhe zbërthimin e terminologjisë teologjike, nevojitet që në mënyrë preliminare t'i tematizojmë supozimet apo hipotezat teologjike të problemit të terminologjisë teologjike. Në vend të punimit konstruktiv-themelues në krijimin dhe “ndërtimin” e saj, neve vetë “terminologjia teologjike” na del si një *problem* fillestar dhe burimor. Në harmoni me këtë, si detyrë parësore na paraqitet pyetja se ç’është terminologjia në përgjithësi dhe si në të vërtetë kuptohet dhe përjetohet vetë teologjizimi gjatë kërkesës për themelimin dhe ndërtimin e saj. Përfundimisht, duke kërkuar përgjigjen ndaj këtyre pyetjeve do të jetë e domosdoshme që deri në një masë të futemi edhe në atë që është më e thellë dhe më e rëndësishme: cili është në përgjithësi raporti i vërtetë i gjuhës/të folurit kundrejt teologjizimit, ose, thënë me formulën e zakonshme: çka dhe sa do të thotë “*fjala*” për “*mendimin*”?

Rrënjën e nocionit “terminologji” e përbën fjala latine *terminus*, kuptimi fillestar dhe i lashtë latin i të cilit ka qenë përafërsisht “kufi, shenjë kufitare, qëllim, pëfundim”, duke shënuar në rend të parë megjet e forta dhe të pandryshueshme, të amshueshme dhe të pacënueshme të Tokës hyjnore të ndarë në paralashtësi.

Në latinishten e mesjetës u bë më e përshtatshme që ky kuptim fillestar në vete ta pranojë edhe kuptimin më të përgjithësuar, “abstrakt” të “dispozitës, përcaktimit, nocionit të kufizuar dhe fortë të caktuar”. Me këtë *terminus* në takimin e romakëve me trashëgiminë teologjike të grekëve mbi vete merr kuptimin që pothuajse ishte i njëjtë me atë të fjalëve *finis* dhe *definitio*.

Fjala *terminus* më tutje gradualisht do të kufizohet në fushën e logjikës si mjedis parësor i përdorimit të saj dhe aty gjithnjë e më tepër do ta marrë kuptimin e kumtimit të jashtëm, që në fund, në logjikën metafizike të skolastikës, në skolastikën e lartë dhe në neoskolastikën njëtrajtësisht të kuptohet dhe interpretohet si *terminus oralis*, në kuptimin e shprehjes së jashtme për nocionin. Ndërkaq gjurma e kumtimit burimor të *terminus*-it të vjetër do të mbetet edhe këtu deridiku i ruajtur në nevojën që nocioni (*conceptus*) të quhet edhe *terminus mentalis*.

Në shek. 16 fjala *terminus* merret si fjalë e huaj në gjuhën gjermanishte, tashmë në kuptim krejtësisht të “shprehjes së jashtme për nocionin në përgjithësi”. Kjo masë e madhe e abstraktivitetit do ta bëjë më tutje tejet të përshtatshme për ta marrë kuptimin i cilin e kërkonte asokohe zbërthimi progresiv i tërësisë së diturisë dhe pavarësimi i fushave të veçanta të saj në formën e të ashtuquajturave shkenca të veçanta. Tani *term* bëhet “shprehje profesionale” i ndonjë fushe të veçantë të diturisë, të shpërblyer me nocione “profesionale” dhe gjuhë personale.

Në pajtim me këtë, fjala e përbërë e mëvonshme *terminologji* do ta shënojë tërësinë e zbërthimit të ndërsjellë të shprehjeve profesionale për nocionet profesionale brenda ndonjë fushe të veçantë profesionale dhe pikërisht në këtë kuptim do të zbrazet deri në vetëkuptimësinë e patejdukshme njëkohësisht e ndjekur me paraqitjen e pandalshme në epokën e sundimit modern internacional-planetar universal.

Pra dy janë supozimet detyrimisht të implikuara në vetë nocionin e terminologjisë teologjike.

- ✓ E para, ajo se çdo mendim dhe çdo formë diturie, e që këtu edhe teologjia, mbështetet mbi koncepte të përcaktuara, të përhershme dhe në thelb të pandryshueshme, të cilat sipas natyrës së tyre janë qenësisht të pavarura nga të folurit dhe gjuha dhe në të kanë vetëm shprehjen e tyre të jashtme.
- ✓ E dyta, se a ekziston në përgjithësi diçka e tillë si “gjuhë e teologjisë”, në kuptimin e një gjuhe të veçantë, profesionale dhe “speciale”, raporti i së cilës ndaj gjuhës së gjallë, të a.q. të zakonshme dhe “të natyrshme” në atë rast bëhet sipas rregullit të papërcaktuar si njëfarë dallimi mes ndonjë gjuhe “konkrete” dhe “abstrakte”.

Problemi i terminologjisë teologjike është shumë më i madh sesa që mendojnë shumica – madje edhe ekspertët. Kjo mënyrë e të menduarit vërehet në tërë historinë e fushave teologjike, gjegjësisht të teologjisë muslimane, e konkretisht te kelamistët muslimanë, duke filluar prej përkufizimit të *ruhit*, *el-esma-së*, e sidomos te çështja e *halku-l Kur'an*, krijimit të Kur'anit – Fjalës së Zotit. Mënyra dhe shkalla, e para së gjithash drejtimi në të cilin precizimi nocionor në çdo situatë zbatohet në bazë të gjuhës së përditshme, gjithnjë ndryshojnë duke pasur parasysh lidhjen e parashtrimeve të ndryshme të problemit.

“Filozofia nuk ka nevojë... aspak për ndonjë terminologji të veçantë”, konstaton Hegeli (“Logjika”) në përpjekjen që para fundit të jetës së tij edhe një herë t’i japë llogari vetes për raportin e gjuhës ndaj “asaj logjike”, si të vërtetës së saj më të thellë dhe natyrës së vërtetë të brendshme. Dhe pothuajse pa hezitim mund të konfirmohet se qëndrimin e njëjtë e ndan në qenësi e tërë filozofia e madhe. Nëse për filozofinë është vështirë, atëherë ç’të thuhet për përcaktimin e terminologjisë teologjike, e cila është mbi filozofinë, etikën dhe urtësinë?!

Si fakt i sigurt historik mund të konsiderohet ajo se me filozofimin e stoikëve në të menduarit me vendosmëri fillon të dominojë ajo masë e fiksacionit nocionor i cili përgjithësisht lejon të folurit për ekzistimin e terminologjisë filozofike në kuptimin e plotë të fjalës (Zh. Paviq). Me këtë bëhet edhe vendosja e gramatikës filozofike, e cila pastaj si interpretim i besueshëm i të a.q. anës formale të gjuhës mbetet dominuese deri në ditët e sotme, si dhe me analizën përfundimtare të sferave të ndara dhe mes vete ndërmjetësuese të gjërave, gjuhës dhe nocionit, duke nxitur kështu për herë të parë fiksimin eksplicit të mendimit dhe të folurit të asaj që historia e mëvonshme e mendimit e njeh me emrin “relacionet subjekt-objekt” apo “kryefjalë-kallëzues”. E gjithë kjo një reflektimi të mëtejshëm historik-filozofik-teologjik i jep mjaft për të përsiatur. (Farabiu, *Et-Tembih ila Sebili Se’ade*).

Që këtu, nga ajo që u tha deri më tani a mund të kuptohet ashtu që për mendimin dhe teologjizimin fjala a do të ishte diçka e parëndësishme dhe në thelb indiferente? Assesi, sepse shumë mirë e dimë se sa vëmendje, përpjekje dhe kujdes për të shprehurit me vete mban secili mendim, sidomos ai radikal dhe themelor. Pikërisht e kundërta, themi: i sjellur në dritën e “problemit të terminologjisë teologjike”, ai raport vendimtar mes mendimit dhe fjalës është interpretuar në mënyrë të njëanshme dhe teknikiste dhe është zgjidhur tepër shpejt dhe lehtë, madje në të vërtetë edhe para se të parashtrahet si problem.

Atëherë, le të përipiqemi, nga ana e imperativit të imponuar të terminologjisë, ta hapim çështjen e këtij raporti aq të rëndësishëm. Gjatë kësaj udhëzimit kompetent dhe orientimin e duhur rreth thelbit dhe natyrës së vërtetë të gjuhës/të folurit nuk do ta kërkojmë në shkencën moderne për gjuhën, me degëzimin e saj të pakufishëm, por njëkohësisht edhe me orientimin themelor të njëtrajtshëm dominant struktural-antropologjik dhe

funksional-sociologjik, por as në rezultatet e pasura dhe aq nxitëse të atij hulumtimi mjaft impresiv.

Në vend të kësaj, do të drejtohem i aty ku gjuha/të folurit përjetohej, konceptohej dhe interpretohej nga vetë qendra e sistemit të tërësishëm dhe gjithunifikues i diturisë qenësore, gjegjësisht te kelamistët muslimanë, te të cilët nuk vërejmë ndonjë “gjuhë të sistematizuar” të teologjisë. Por do të mund të ishte që te ata, si edhe në tërë traditën e teologjizimit qenësor deri tek ata, gjuha/të folurit kurrë nuk e ka pasur atë “fat” që ta marrë statusin e “lëndës së veçantë të hulumtimit”, pikërisht për shkak se ishte pothuajse pa u vërejtur e thurur në çështjet më të thella themelore të teologjizimit të tërësishëm. Nëse kjo qëndron, atëherë edhe sot, në kohën e tërësisë shumëfishtë të copëtuar së të jetuarit dhe të menduarit, e vërteta e gjuhës/të folurit, si dhe e çdo gjëje tjetër qenësore, mundet dhe duhet të kërkohet në rend të parë aty ku në vepër është zbatuar dhe ku deri në sendërtimin e plotë është prezentuar njohja se teologjia si edhe gjithësia është e *rrethuar* në vete; nuk ka kurrfarë të pari dhe kurrfarë të fundit, por çdo gjë është e bartur dhe e mbajtur – *ndërsjellshëm* dhe në *një*.

Qenësia dhe natyra e vërtetë e gjuhës/të folurit paraqitet si ajo që kushtëzon dhe mundëson kalimin përparues të *shfaqjes*, e kjo do të thotë shkallës së dytë të *shpirtit*, gjegjësisht *inteligjencës* (fjalë e huaj kjo me të cilën Hegeli me vetëdije e mban në njëfarë papërcaktueshmërie atë më të thellën që si burim, lëvizës dhe njëkohësisht si qëllim i procesit të tërësishëm shtrihet në fundin e tij) në të tretin dhe përfundimtarin, gjegjësisht në vetë *mendimin*. Ky kalim ngjan përmes vargut të mes-shkallëve dhe ndërmjetësimeve, të cilat vetëm në njëfarë domosdoshmërie të raporteve të ndërsjella zbulojnë të vërtetën personale.

Hapi i parë në atë pjesë drejt udhës së tërësishme të vetëmanifestimit të shpirtit është transformimi i *zorit* në *fotografi*. *Zor-i*, i cili në të vërtetën e vet nuk është gjë tjetër pos një dije shqisore e orientuar me këtë kalim në imazhin e fotografisë humb përcaktimin e vet të jashtëm, i nënshtrohet vetëvullnetit të lirë të shpirtit dhe izohet nga vendi dhe koha e jashtme dhe nga struktura e tërësishme në të cilën qëndron burimisht. Nga ana tjetër, pikërisht me këtë tërheqje dhe izolim nga të gjitha individualitetet e rastësishme ai rrëmbehet nga nevoja e zhdukjes dhe kalueshmërisë, të cilës i nënshtrohet e gjithë ajo që është individuale, konkrete dhe shqisore, dhe me këtë fiton vazhdimësinë, përhershmërinë dhe pakalueshmërinë, që më tutje do t'i ndihmojë *kujtesës* që vetes me vullnetin e lirë rishtas dhe rishtas t'ia

thërrasë fotografinë e njëjtë, pavarësisht nga ndërlidhja e saj për *këtu*-në momentale dhe *zor*-in e pranishëm tani.

Hapi i dytë në udhën e njëjtë përbëhet nga kalimi i fotografisë në imazhin e *shenjës*, që është pjesë e *imagjinatës*. Thelbi i këtij kalimi qëndron në atë se vëmendja e shpirtit, deri atëherë si e lidhur dhe e ngulitur me përmbajtjen e fotografisë, lirohet nga ajo dhe largohet, bëhet indiferente ndaj saj dhe i drejtohet raportit të ndërsjellë mes fotografive dhe renditjes së përmbajtjeve të tyre njëri me tjetrin. Me këtë largim atëherë zhduket dhe shmanget edhe ajo mbetje e fundit e ndijësisht konkretes, i cili në përmbajtjen e fotografisë u fut i marrë nga *zori*. Raportet e ndërsjella të fotografive tani lindin në shfaqjen e asaj të përbashkëtës dhe të përgjithmes, shfaqjen e përgjithshme, gjegjësisht abstrakte.

Nëse tani shpirti në vendin e përmbajtjes burimore të fotografisë vendos një përmbajtje të re, të huaj për të, një të tillë funksioni i tërë i së cilës qëndron në atë që ta paraqesë dhe shprehë formën ideale të shfaqjes së përgjithshme, atëherë nga fotografia bëhet shenjë. “Shenja duhet manifestuar si diçka e madhe. Kur inteligjenca të ketë shënuar diçka, atëherë ka përfunduar me përmbajtjen e *zor*-it dhe materies ndijuese si shpirt i ka dhënë një kuptim të *huaj* për të” (Zhelko Paviq – *Metafizika i Hermeneutika*).

Nga thelbi i shenjës së kuptuar kësisoji tani kuptohet dhe interpretohet gjuha/të folurit. Përhershmëria e shtangur dhe e nxjerrur nga kalueshmëria e përmbajtjes së *zor*-it me fotografinë fiton përhershmëri në hapësirë. E me zhdukjen e asaj përmbajtjeje fotografia kalon në shenjë dhe prandaj njëkohësisht bartet në atë medium i cili, për dallim nga hapësira, është zhdukja vetë e ekzistencës në përgjithësi, gjegjësisht në kohë. Shenja e pastër në kohë është tingulli, gjegjësisht *toni*, kështu që në harmoni me këtë përcaktimi i plotë i gjuhës/të folurit tani do të thoshte: *sistem i artikullimit të tonit për shënimin e shfaqjeve*. E kjo quhet *emër* ose *fjalë*, pa insistuar në dallimin e rreptë të tyre.

Mirëpo, nëse fjala kuptohet si shenjë tingullore, atëherë është e qartë se në të akoma mbetet diçka në përmbajtjen e fotografisë. Në të vërtetë, fjala si shenjë akoma ka të bëjë me diçka të jashtme që shënohet me të, ashtu si, nga ana tjetër, *kuptimi*, si një përmbajtje e re e ngulitur në fjalën, nuk është gjë tjetër pos manifestim i gjallë e konkret i sjelljes së shpirtit në imazhin e subjektit natyror ndaj asaj që shënohet.

Për ne qenësore është kjo: parimi i çfarëdo “gjuhe speciale” apo “terminologjie speciale”, qëndron në izolimin e një aspekti të caktuar nga shumëkuptimësia dhe shumaspëktësia origjinale e çdo fjale dhe çdo të foluri të gjallë, në fiksimin dhe absolutizimin e tij. Përcaktimi, e me këtë edhe përdorshmëria në komunikimin dhe kumtimin këtu gjithmonë është arritur me çmimin e mbyjtjes së asaj metaforikes së gjuhës/të folurit, e cila edhe e përbëne gjallërinë e çdo gjuhe të gjallë. Njëherë, brenda gjuhësisë, por edhe jashtë saj, do të duhet që nën këtë pikëpamje në shikim negativ sërish të matet e vërteta e vlerësimit të zakonshëm të raportit mes gjuhës së shkruar dhe të folur, mes të a.q. gjuhë të lartë dhe të përditshme, letrare dhe rajonale, të përkufizuar si “dialekt”, e në fund mes cilësdo dhe secilës gjuhë speciale dhe të folurit të gjallë.

A nuk kemi ardhur tani në pozitë që “terminologjisë” t’ia mohojmë çdo të vërtetë dhe vlerë gjatë teologjizimit? Është koha për përgjigje në mënyrë të përcaktuar: në rast se me terminologji nënkuptohet emërtimi special i gjuhës speciale të teologjisë, atëherë atë e konsiderojmë për grackë dhe rrezik për teologjinë. Në atë rast, në të vërtetë, me terminologji detyrimisht kuptohet përbërja e shprehjeve teknike, në thelb të çliuara nga ajo metaforë vazhdimisht ringjallëse e gjuhës së gjallë dhe kundrejt saj indiferenteve, të atillave që pranë saj ndërtojnë një botë të përhershme, të pavarur të ndërraporteve të pastra. Atëherë nuk është aspak për t’u habitur se pikërisht llojet e tilla kryekëput johistorike të teologjizimit më tepër se të gjithë kanë insistuar në kuptimin dhe domosdoshmërinë e terminologjisë tejet të fiksuar.

Nga ana tjetër, a do të nënkuptohet me terminologji ajo *përkohësisht* e detyrueshme dhe e pashmangshme në çdo mendim dhe të folur, e kjo do të thotë gjithnjë ndalim i shikimit të shpirtit në një pikëpamje? Sepse, kemi parë se e tërë natyra e tij është pikërisht në atë që gjithnjë dhe detyrimisht të zgjedhë dhe të vlerësojë, t’i theksojë pikëpamjet e caktuara, duke thurur pastaj nga ato rrjetin e konceptuar të domethënies.

Paradoksi si i mendimit ashtu edhe i të folurit, natyra e tyre e thellë ambivalente edhe qëndron në atë që ato nga njëra anë duhet që gjithnjë në njërën nga mënyrat e mundshme për një çast ta ngurrtesojnë lojën e pafundme të shumëkuptimësisë, në të cilën nuk ka asgjë të përhershme dhe të fortë, e pastaj mbi atë të konsoliduarën të ndërtojnë botë të një orientimi më të besueshëm. Por, njësoj, nga ana tjetër, pikërisht me atë të konsoliduarën dhe ndërtimin e fushës së orientuar të së sigurtës tani arrijnë

në rrezik që përgjithmonë ta humbin kontaktin me atë ndërthurjen e gjallë origjinale të lojës së pafundme të shumëkuptimësisë dhe të konsolidohen në aparaturën qenësisht të mbytur. Thelbi i teologjizimit të vërtetë, si dhe i çdo të foluri të thjeshtë e të përmbledhur, në këtë pikëpamje nuk është asgjë tjetër pos ruajtje e mjedisit dhe masë e vërtetë mes këtyre dy ekstremeve, që padyshim nënkupton pjekurinë e guximit për përvojën e secilës prej tyre në tërë fuqinë e saj dhe tërësinë e momenteve të përkatësisë. Ndërsa ajo që mund t'i ndihmojë kësaj ruajtjeje është njohja e thjeshtë se “krijimi i nocioneve... është vazhdimisht i kushtëzuar nga gjuha që flitet”.

Shkup, 09.11.2005

Dr. Metin IZETI

RËNDËSIA DHE SFIDAT E KRIJIMIT TË TERMINOLOGJISË ISLAME NË GJUHËN SHQIPE

*“... Allahu të shpalli ty, librin dhe sheriatin, të mësoi çka nuk dije. Dhuntia e Allahut ndaj teje është shumë e madhe”.
(Nisaë, 4:113)*

*“... Zoti, nëse për Të flet pa virtyte reale është vetëm një emër”.
(Plotini)*

*“Fol në përputhje me natyrën, në këshill dhe me cilindo të jesh: fol hijshëm e pa naze; përdor një gjuhë të çiltër”.
(Marco Aurelio)*

Bota bashkëkohore, si hapësirë e përqëndruar në trijumfin e arsyes shkencore dhe teknike, përfaqëson, si rend krejtësisht të ri shoqëroro-historik, teorinë/praktikën e mbijetesës sonë brenda modernitetit. Fuqitë institucionale dhe trajtëdhënëse - duke filluar prej atyre ekonomiko-tregtare deri te ato politiko-fetare - i përcaktojnë kornizat e “*lojrave gjuhësore*” (*language game*)¹ (Witgenstein) dhe parashtrojnë pyetjet për konceptin dhe qëllimet e diciplinave jetësore të sodit.

¹ Witgenstein'i gjuhën ia përngjanë një qyteti i cili është i përbërë prej rrugëve, lagjeve dhe ndërtesave të reja e të vjetra. Gjuha, thotë Witgensteini, artificializohet nëse kufizohet në disa shabllone. Ka më shumë lojra të gjuhës e jo vetëm një. Në veprën e tij *Hulumtime Filozofike* ai thotë kështu: “Ka lloje të panumërta: lloje të panumërta të ndryshme të përdorimit të gjithë asaj që quajmë “shenja”, “fjalë”, “fjali”. Dhe kjo larmi nuk është asgjë e fiksuar, e dhënë një herë e përgjithmonë, por, tipe të reja të ligjërimit, siç mund të thoshim, krijohen të rejtat e të tjerat vjetërohen dhe bien në harresë”. Wittgenstein, Ludvig, *Hulumtime Filozofike*, f. 26-27.

Përvoja e re e të menduarit filozofik mundohet të përjashtojë prej kornizës shumë trajta të tëhuajësimit dhe sklleverimit, të asaj fuqie trajtëdhënëse që e ngatërron modernitetin dhe që bën të pamundshëm lirinë dhe pjekurinë, atë “*domosdoshmëri paralizuese të kohës*”. Kjo përvojë filozofike në relacionin e saj ndaj realitetit shkon edhe më larg, prej ideologjshmërisë dhe dogmatikës deri te institucionet e tëhuajësura.²

Një problem të ngjasjshëm kemi edhe me krijimin dhe vetëvendosjen e terminologjisë fetare Islame në përgjithësi dhe të asaj në gjuhën shqipe në veçanti. Çështja e krijimit të saj qëndron në dilemën e shpëtimit nga robëria dhe tëhuajësimi i kulturave që e rrethojnë dhe janë pishtarë të realitetit modern njerëzor dhe klithmës së atyre të cilët janë jashtë proceseve dhe nuk mund t’i përgjigjen nevojave dhe koncepteve të njeriut modern.

Terminologjia shkencore islame në gjuhën shqipe nga aspekti ideor do të duhej të përballohet me sfidën e krijimit dhe trajtësimit të termeve të cilët do të kenë mundësi të zënë vendin e duhur në kulturën e mendimit dhe shkrimit si në kuadër të gjuhës dhe kulturës shqiptare ashtu edhe të ndikimit të saj në rrjedhat e përgjithshme të mendimit dhe fjalës muslimane. Gjithsesi për një rrugë të frytshme në këtë lëmi nevojiten formacione gjithpërfshirëse në diciplinat filozofike, sociologjike, fenomenologjike etj.

Unë në këtë shkrim do të ndalem në tre çështje të rëndësishme në lidhje me krijimin e gjuhës konceptuale gjegjësisht terminologjisë brenda korpusit musliman-shqiptar, edhe atë:

1. Gjuha dhe edukimi i koncepteve

Edukimi i koncepteve gjuhësore origjinën e saj e ka në tekstet e shejta të secilës prej religjioneve të shpallura; e ka në *logosin* por e ka edhe në *esmanë*. Në çdo diskutim të revelatës hasim në vërtetimin e asaj se edukimi natyror i koncepteve, i cili ec së bashku me gjuhën, nuk e ndjek rendin ontologjik të qenies, por edukimin e fjalëve e bën në bazë të akcidenteve dhe relacioneve. Ne në krijimin e koncepteve e ndjekim këtë akcidence për shkak se vetëm atë e njohim, edhe pse në të shumtën e rasteve ajo paraqitet si mëngësi e shpirtit tonë përfundimtar. Për rrjedhojë në këtë proces të

² Për këtë, thotë Abdullah Sharçeviçi, parashtrohet çështja e *arsyes në botën e modernes*, për njëpërmasshmërinë e qytetërimit botëror modern, për fatin e traditave mijëvjeçare, për numrin e madh të kulturave ose sistemeve kulturore nacionale, për kulturën dhe përparimin. Shiko: Sharçeviçi, Abdullah, *Iskustvo i Vrijeme*, f. 7-9.

trajtësimi të koncepteve gjegjësisht termeve prezentohej liria për edukimin e pafundtë të tyre dhe kristalizimin e pandërprerë të mendimit. Nga ky aspekt në qendër të vëmendjes tonë do të jetë diçka e re: trajtësimi gjuhësor i koncepteve të cilat shpirti i njeriut me fundshmërinë e tij, në një mënyrë të re, i ndërmjetëson me amshueshmërinë hyjnore. Këtu deshtëm ose nuk deshtëm do të ballafaqohemi me njërin prej problemeve më të vjetra dhe dhe më themelore të filozofisë, *problemin e universaleve*. Ai zakonisht është interpretuar si një problem thjesht metafizik, por të gjithë do të pajtohemi se pasardhësi i saj është formulimi metodologjik dhe konceptual i çështjeve universale metafizike. Çdo shkencë përdor terma universale, si *drejtësi, etikë, estetikë, poezi*, etj. por edhe terme individuale si, *poezia e bejtexhinjve*. Rreth natyrës së termave universale, që në masë të madhe është çështje boshte e diskutimit tonë, një diskutim i gjatë dhe herë herë i hidhur është bërë ndërmjet dy palëve, *nominalistëve* dhe *realistëve*.³

Shkolla realiste nga aspekti metodologjik është i prirur, që mendoj se edhe në rastin e krijimit të terminologjisë në suazat tona është më se e nevojshme, që të zbulojë kuptimin real ose thelbësor të termave universale dhe prej këndeje edhe natyrën reale ose të vërtetë të thelbeve të shënuara prej tyre. Proçes i cili është një parakusht i nevojshëm i kërkimit shkencor metodologjik, në mos detyrë e tij kryesore. Posaqërisht për sa i përket shkencave shoqërore, ku bëjnë pjesë edhe diciplinat religjioze, qasja esencialiste dhe realiste ndaj koncepteve universale dhe trajtësimit të tyre është i pashmangshëm. Shkencat shoqërore kanë detyrë kryesore të kuptojnë dhe shpjegojnë entitete dhe koncepte komplekse dhe kjo mund të bëhet vetëm duke depërtuar në thelbet e tyre. Çdo koncept i rëndësishëm fetar parakupton termat universale për përshkrimin e tij dhe do të ishte e palogjikshme të futeshin lirisht terma të rinj, siç bëhet në shkencat natyrore. Detyra e teologëve është që t'i përshkruajnë qartësisht kuptimet, të dallojnë thelbësoren prej të rastësishmes; por kjo kërkon njohjen e thelbeve të tyre. Në çdo ndryshim duhet të ketë diçka që ka ndryshuar. Madje në qoftë se

³ Nominalistët thonin se universalet ndryshojnë prej emrave të përveçëm, se u ngjiten përbërësve të një bashkësie ose klase sendesh të veçanta. Termi universal “i bardhë” për shembull, kësaj pale i duket që nuk është gjë tjetër veçse një etiketë që i ngjitet një bashkësie me shumë sende të ndryshme si, flokëve të borës, mbulesave të tryezës etj. Ndërsa realistët mohojnë se ne në fillim grumbullojmë një grup sendesh të veçanta dhe pastaj i etiketojmë ata “të bardhë”. Kjo veti e shënuar prej termit universal shqyrtohet si një objekt i cili meriton të hetohet po aq sa vetë sendet individuale. Shiko: Popper, Karl, *Mjerimi i historicit, f. 42-43*.

kurgjë nuk mbetet e pandryshuar, duhet të identifikohet çfarë ka ndryshuar. Duke zbatuar këtë parim vijmë në përfundim se thelbi ose karakteri real i një koncepti mund të zbulojë vetveten dhe të njihet vetëm nëpërmjet të vetvetes së tij.⁴

Gjuhët janë prodhime të “*fuqisë shpirtërore*” të njeriut dhe çdo gjuhë ka mundësi që të arrijë këtë forcë. Të gjitha gjuhët kanë një synim të përbashkët që në përkryerjen e gjuhës së tyre të përkapin mbijetesën në realitetin. Struktura e gjuhëve njerëzore nuk e përmbys individualitetin e një gjuhe të caktuar, që d.t.th. nuk e mohon përkryerjen relative të çdo gjuhe. V. Fon Humbolti mëson se çdo gjuhë duhet të nënkuptohet si një këndvështrim i veçantë për botën dhe në këtë kontekst ai flet për individualitetin e sensit të brendshëm. Për pasojë edhe gjuha shqipe në këtë kontekst e ka individualitetin e saj dhe edukimi konceptual i saj duhet të bëhet në koordinim me vlerat universale historike mbarëbotërore por me theks të posaçëm në individualitetin e fuqisë së shpirtit shqiptar.

2. Mundësia e gjuhës fetare

A kemi mundësi të pohojmë se ekziston “*gjuhë fetare*” ashtu siç themi se ekziston “*gjuhë shkencore*” ose “*gjuhë juridike*”? Në këtë drejtim kemi dy mendime. Mendimi i parë thotë, edhe pse feja ka shumë terme të veçanta nuk është e drejtë që të flitet për një gjuhë të veçantë fetare, pasi edhe në shumë sisteme filozofike mund të haset në “*konceptin e Zotit*” i cili duket se është i ngjashëm me atë teist, por si të shembulli i filozofisë së Spinozës thelbësisht dallohet nga koncepti i Zotit në Kur’anin famëlartë.

Vallë kur kemi dëshirë të konkludojmë diçka në aspekt fetar, çka kemi dëshirë të themi? Kemi dëshirë që këta konkluzat t’i shprehim si konkluzione shkencore, të cilat janë deskriptive? Ose nëpërmjet të tyre dëshirojmë t’ju japim njohuri të caktuara njerëzve në trajtë kognitive? Filozofët e *Qarkut të Vijenës* ishin të mendimit se konkluzionet të cilat nuk verifikohen në aspekt shkencor ose si prodhim i një tautologjie mendore (*principle of verification*) nuk kemi mundësi t’i pranojmë si reale dhe për ta gjuha nuk ka mundësi të bisedojë. Ndërsa Karl Popper’i do të kundërshtojë këtë mendim me pretendimin se vetë zbulimi i elementeve të cilat i mohon një konkluzion ose premisë na mundëson të dijme se çfarë ajo në të vërtetë verifikon.⁵

⁴ Kuçuk, Hasan, *Islam ve Batı Felsefelerinde Sistematik Problemler*, f. 276.

⁵ Shiko: Azdin Mehmet, *Din Felsefesi*, f. 112-114.

Gabimi kryesor i mendimtarëve të Qarkut të Vijenës, të cilët ishin pozitivistë në logjikë, është se ata gjuhën e shkencave natyrore u munduan ta gjeneralizojnë dhe ta konsulltojnë edhe në përkufizimin e koncepteve fetare. Gabimin e njëjtë e ka bërë edhe bota islame posaçërisht në identifikimin e terminologjisë fetare me të arriturat shkencore të një periudhe të caktuar historike. Shembull i tillë është përkthimi i termit kuranor “*sulltan*” me “*teknologji*”, ose *gurrët e hudhura nga goja e ehabilëve si bomba*. Kur’ani në ajetet ku flet për ekzistencën e Allahut ose për relacionin Zot- njeri, nuk i përdorë principet e verifikimit logjik, por flet në aspekt të besimit në transcendentalen, në të pëртејshmen (*ju’minune bi’l-gajbi*).

Një çështje tjetër në të cilën duhet të kihet kujdes është edhe ajo se konceptet fetare nuk janë temë empirike në trajtë të gjuhës sonë të përditshme. Në hulumtimet empirike ka mundësi që të mos ekzistojë objekti, mirëpo në logjikën e të besuarit kjo nuk është e mundshme, p.sh. besimtari asnjëherë nuk ka mundësi të mendojë se “*Nuk ka Zot*”. Në disa raste gjuha fetare ka mundësi që të konsiderohet edhe si paradoksale, mirëpo paradoksaliteti i koncepteve fetare paraqitet për shkak të paafësisë së gjuhës ditore dhe pamundësisë së saj të përmbledh në një kornizë dallimet e nuancave dhe motiveve shpirtërore. Pikërisht për këtë edhe shumica e shprehjeve analogjike dhe simbolike duken si paradoksale. Ka mundësi që mos të kuptojmë një paradoks, por kjo nuk do të thotë se nuk kemi mundësi të kemi një qasje për të. Për shembull, Kur’ani kur e përshkruan Qenien e Zotit thotë: “*Ai është evvel (i pari), është ahir (i fundit), dhahir (i dukshëm) dhe batin (i padukshëm)...*” (Hadid, 57:3). Është mjaft rëndë që kjo shprehje kuranore të kuptohet në tërësi. Mirëpo prapsepapë ajeti na jep një fotografi për diturnë dhe fuqinë e pafundtë të Zotit.

Terminologjia fetare në dallim prej të tjerave konfigurohet edhe në praktikën adhuruese të njeriut në relacion me Zotin. Elementet e termeve të devotshmërisë fetare konceptohen në ibadet, në përvojën mistike etj. Feja nuk përbëhet vetëm prej një grupi të termeve të cilat kuptimin e tyre e konstatojnë vetëm prej kriterëve në të cilat thirren. Terme të caktuara fetare jashtë nënshtrimit adhurues duken krejtësisht të pakuptimta. Në shenjtërinë e adhurimit, për dallim nga proceset shkencore, fjalët dhe emocionet derdhen në të njëjtin realitet ku ata bëjnë pjesë. Si p.sh. *Zekati* dallohet prej tatimit të thjeshtë për shkak se në vehte përmban përmasën e emocionimit hyjnor të solidaritetit shoqëror.

Çështjet eskatologjike janë ndër më komplekset në krijimin e një terminologjie praktike dhe të shëndoshë fetare. Ata sa janë komplekse po aq janë edhe të rëndësishme. Disa prej këtyre termeve ndoshta kanë mundësi që të futen brenda një rezonimi logjik dhe empirik. P.sh. prej termit *ahiret* ne mund të kuptojmë se bëhet fjalë për një botë tjetër e cila nga ana e besimtarit shihet si botë e ballafaqimit me përgjegjësinë përfundimtare repesktivisht, shpërblimin dhe dënimin. Ndërsa për të argumentuar vërtetësinë e këtij termi ndaj atyre që nuk besojnë na duhet të themi “*vdis e shih*”. D.t.th. që termet eskatologjike mund të modifikohen vetëm nëpërmjet të besimit në vërtetësinë e tyre, ndërsa verifikimi i tyre nga aspekti i përvojës bëhet pas vdekjes. Komplexiviteti i këtyre koncepteve paraqitet në dypërmasshmërinë e terminologjisë fetare e cila ka të bëjë me këtë dhe me botën tjetër. Si, *Halik (Fuqia krijuese hyjnore permanenete)*.

Në konstituimin e terminologjisë fetare gjithsesi kujdes i veçantë duhet t'i kushtohet edhe analizës linguistike të termeve fetare. Është me rëndësi pse termi gjegjës përdoret, si përdoret dhe çfarë funksioni ka në kontekstin ku përdoret. Terminologjisë fetare islame, në të gjitha gjuhët tjera përveç arabishtes, i nevojitet *analizë funksionale*.⁶ P.sh. termin *Kerim* në fjalinë “*Zoti është Kerim (fisnik)*” nëse e analizojmë dhe e definojmë nga aspekti funksional atëherë do të jetë e mundshme që konceptet e revelatës t'i përkufizojmë ashtu si është më e drejtë. *Esbabi nuzuli* (Shkaqet e zbritjes së ajeteve) është një shembull i analizës funksionale të koncepteve islame.

Mendoj se të gjithë pajtohemi se gjuha fetare është komplekse dhe e rëndë për përkufizime shabllonike. Pikërisht për këtë në krijimin e terminologjisë fetare islame në gjuhën shqipe konceptet islame duhet të mbështeten me analiza fenomenologjike dhe ekzistencialiste.

⁶ Botëkuptimin e analizës funksionale të terminologjisë fetare në botën perëndimore e ka aktualizuar filozofi Ludvig Witgenstein'i në veprën etij *Tractatus Logico-Philosophicus* ku pohonte se çështjet që kanë të bëjnë me Zotin dhe gjërat trascendentale nuk kanë mundësi të kenë analizën e tyre funksionale dhe pikërisht për këtë për ta nuk mund të folët. Ndërsa në pjesën e dytë të filozofisë së tij ai ndryshoi këtë mendim dhe në veprën e tij *Philosophical Investigations* siç u përmend edhe në fillim të këtij teksti ia përngjau një qyteti me rrugë dhe lagje të llojllojshme. Shiko: Witgenstein, Ludvig, *Tractatus logico-philosophicus*, përkth. në serbokroatisht. Gajo Petroviç, Sarajevë 1987 dhe *Hulumtime Filozofike*, përkth. Kristë Shtufi, Tiranë 2002.

3. Krijimi i terminologjisë së tesavvufit (mistikës islame)

Feja është sistem jetësor i cili njeriut ia tregon qëllimin final të ekzistencës së tij. Njëkohësisht, feja e mëson njeriun si ka mundësi që të gjitha sferat jetësore t'i konsiderojë si një tërësi vlerash të jetës. Në fillim feja njeriut i mundëson një filozofi jetësore nga aspekti individual, ndërsa më vonë me thellimin e përmasave fetare në jetën sociale të njerëzve kjo filozofi jetësore shndërrohet në kulturë shoqërore. Në mesin e elementeve sintetizuese të një shoqërie motivet dhe simbolet fetare janë ndër më të rëndësishmet në ndikimin për përkapjen e realitetit të gjërave në atë hapësirë dhe vend. Një fotografi të tillë të përkapjes shoqërore e hasim edhe te ne shqiptarët. Feja dhe terminologjia fetare është pjesë e kulturës tonë të përgjithshme.⁷ Ndërsa në anën tjetër nga aspekti hapësinor dhe kohor ne jemi pjesëtarë të një epoke historike të modernizmit ose postmodernizmit, kurse nga aspekti real aspak nuk përkojmë ma aktualitetin e tyre. Në realitetin tonë kulturor dhe fetar, për fat të keq ka një mëngësi alarmante të aktualitetit shkencor-diciplinor.

Problemi në vendosjen e terminologjisë fetare nuk mund të tejkalohet me kalimin tonë në rradhët moderne ose anti-moderne, e as me ballafaqimin e modernitetit me tradicionalen. Është e pashmangshme që në fillim duke mos e konsideruar konceptologjinë dhe frazeologjinë moderne si pol të kundërt të bëhet një vlerësim i gjendjes sonë të përgjithshme. Më pas, duke vlerësuar dhe analizuar karakterin doktrinor dhe funksional të koncepteve islame të zhvillohet një terminologji e shëndoshë. Një terminologji fetare, që nëse jo sot në të ardhmen do të motivojë kulturën fetare ndër ne, nuk mund të jetë e përsosur nëse nuk ka kaluar nëpër sitën e arsyes dhe dijes së mirëfilltë.

Unë këtu do të them disa fjalë në lidhje me parapërgaditjet dhe krijimin e terminologjisë së tesavvufit në suaza të gjuhës shqipe. Si çdo disiplinë tjetër teologjike ashtu edhe Tesavvufi ka zhvilluar mënyra dhe trajta nëpërmjet të cilave do të ketë mundësi të afrohet deri te qëllimi final e që është vendosja e lidhjes me thelbin e njeriut. Sufijtë në vrojtimin dhe përkapjen e realitetit të qenësisë dhe në afrimin me Zotin, si dy qëllime parësore të disiplinës së Tesavvufit, kanë zhvilluar një terminologji të

⁷ Ramazani, Bajrami, Namazi, Zeqati, Mashallahi, Bismillahi sa janë terme fetare aq janë edhe nuansa kulturore të nënqiellit shqiptar.

vrullshme, e cila njëkohësisht paraqet edhe karakteristikat themelore të Tesavvufit.

Klasifikimi i karakteristikave dhe terminologjisë së Tesavvufit duke filluar prej burimeve klasike e deri te ato të sotmet është bërë në mënyra të ndryshme⁸ por nëse bëhet një klasifikim eklektik i literaturës së Tesavvufit në lidhje me këtë çështje terminologjinë e Tesavvufit do të kishim mundësi ta klasifikojmë në dy grupe:

1. Termet psikologjike të Tesavvufit.- Arsyeja (akl), shpirti (ruh, zemra (kalb) dhe uni (nefs) janë nocione që përmenden në Kur'an dhe koncepte kryesore të psikologjisë njerëzore, që në çdo shkencë shoqërore janë diskutuar në bazë të funksionit të tyre në hierarkinë e shkencës gjegjëse. Tesavvufti këtyre termave u kushton rëndësi të posaçme në vendosjen e relacionit ndërmjet Zotit, njeriut dhe gjithësisë. Disa prej sufijve në qendër të sistemit të tyre kanë vendosur zemrën, disa të tjerë un'in, ndërsa të tretët kanë vendosur shpirtin dhe në bazë të kësaj kanë zhvilluar metodologjinë e procesit edukativ-arsimor të tyre.

2. Termet e gjendjeve dhe pozicionimeve sufike (makamet dhe halet)

Pjesën dërmuese të terminologjisë së Tesavvufit e përbëjnë termat që kanë të bëjnë me pozicionimet kuptimore dhe gjendjet shpirtërore të sufijve gjatë procesit edukativo-arsimor sufik. Pasi platformat e përjetuara nga ana e udhëtarit shpirtëror (salik) gjatë përvojës mistike janë shumë të ngjashme me njëra tjetrën dhe në nuanca shumë të holla dallohen prej njëra-tjetrës, shpeshherë letrarët e Tesavvufit dhe rrugët e ndryshme të Tesavvufit i kanë përzier *halet* dhe *makamet*. Si rrjedhim, përderisa për njërën palë një pedestal kuptimor është konsideruar *hal*, për një grup tjetër ka mund të konsiderohet si *makam* dhe anasjelltas. Pikërisht për këtë nuk mund të bëhet një dallim i përpiktë ndërmjet *halit* dhe *makamit* dhe si pasojë e kësaj ekziston një numër i madh përkufizimesh për to. Në korpusin ekëtyre

⁸ Në lidhje me terminologjinë e Tesavvufit, për më gjerë shih: Kushejri, *er-Risale*, f. 200; Huxhvir, *Keshfu'l-Mahxhub*, f. 517; Kashani, Abdurrezak, *Istilahatu's-Sufijje*, f. 43 e tutje; Serraxh, *el-Luma'*, f. 171-172; Eraydin, Selçuk, *Tesavvufti dhe Tarikatet*, f. 75 e në vazhdim; Yilmaz, H. Kamil, *Hyrje në Tesavvuf*, f. 127 e tutje.

termeve bëjnë pjesë: *Dhikri* (përkujtimi), *Tevbe* (pendimi), *Zuhd* (askeza), *Mehabbet* (dashuria kuptimore), *Havf* (frika), *Vexhd* (ekstaza)etj.

Për krijimin e një terminologjie esenciale të tesavvufit në gjuhën shqipe dhe që ato terme të kenë kualitetin sufik **së pari** duhet të kthehemi në rrënjët e kësaj disipline në historinë islame. Ky kthim do të na mundësojë vendosjen e kontaktit të duhur ndërmjet nesh si studjues dhe sufiut të caktuar dhe do të na mundësojë këndvështrim fetar dhe eksperiencial. Për rrjedhojë do të kemi mundësi të bëjmë dallimin mes përvojës sufike dhe shprehjen e saj në fjalë. Eksperienca sufike e përjetuar nga ana e sufiut në paralelen e dashurisë dhe dijes është larg prej shkronjave, fjalëve dhe shprehjeve. Ajo është një eksperiencë dinamike e cila përjetohet në korniza subjektive. Kur bëhet fjalë për të shprehurit e kësaj përvoje, automatikisht kalohet prej subjektivitetit në tjetrin. Thënë ndryshe prej rrugës në thellësitë e sufiut kalohet në një udhëtim përmasor. Këtu subjektiviteti fiton trajta të reja dhe përfiton nocionin e të tjerëve.

Në veçanti me Ibn Arabiun përvoja sufike ka përfituar aftësinë e shprehjes dhe transferimit. Tek ai takohemi me terme të cilat shprehin një mendim të tërë si dhe me termin si objekt i cili e ndërton mendimin e jo vetëm si kallëp për shprehjen e tij. Si rrjedhojë termi largohet prej domethënies së dyfishtë dhe duke e shndëruar thelbin në veten merr formën e njëshit. Në terminologjinë sufike të sistematizuar nga ana e Ibn Arabiut të gjiha termet e simbolizojnë një realitet të vetëm dhe kanë vetëm se një përmbajtje. Një eksperiencë e tillë e prezentuar në faqet plotë perla të Ibn Arabiut është trajta më esenciale e formimit të terminologjisë fetare në një gjuhë, kurse në rastin tonë, të gjuhës shqipe. Fjala do të shprehë atë që kërkohet prej saj dhe pikërisht për këtë nuk do të ketë nevojë që koncepti të formulohet me disa fjalë.

Harmonia ndërmjet gjuhës dhe përvojës së caktuar nuk mbërrihet nëse kjo përvojë nuk ka arritur gradën e pjekurisë. Pjekuria eksperienciale në vehte ngërthen dy botëra: botën e subjektivitetit të përvojës dhe objektivitetit të saj. Bota e dytë vehten e tregon në prezentimit e akcioneve mendore nëpërmjet të një gjuhe dhe frazeologjie të gjallë.

Terminologjia e tesavvufit e paraqitur pas Ibn Arabiut është sintezë e metodës intelektuale, përvojës gjashtë shekullore islame dhe i një botëkuptimi përfshirës ekzistencialist. Ky botëkuptim metodologjik dhe terminologjik bazat i ka në një origjinalitet universal. Përpjekjet e Ibn Arabiut që çdo gjendjeje (hal) ose pozicionimi (makam) sufik t'i gjejë një

emër adekuat ka krijuar një gjuhë të posaçme të tesavvufit. Kjo gjuhë e bën të mundshme emërtimin e mendimeve sufike të cilat ishin prezente në botën islame edhe para tij.

Ibn Arabiu termet e praktikës sufike si *istikamet* (përqëndrim) *tevekkul* (mbështetje) i bart prej platformës logjike në atë pragmatike. Ai p.sh. mbështetjen në Zotin e sheh si një realitet gjithpërfshirës dhe pragmatik, pasi në realitet tërë ajo që ekziston është në mbështetje e sipër dhe madhërim të Fuqisë Krijuese. Ndërsa termet të cilat kanë domethënie psikologjike, shkencore, sociale dhe etike i largon prej paragjytimeve dhe paradigmave të ndryshme dhe i bartë në platformën ontologjike gjegjësisht në platformën ekzistencialisto-krijuese. P.sh. tek ai *kemali* (përsosshmëria) nuk e shpreh përkryerjen e idesë etike por bashkësinë kualitative-etike të dukshmërisë.

Termet në sistemin terminologjik të Ibn Arabiut dhe pas tij të tesavvufit islam janë në lëvizje të pandërprerë brenda kornizave të tyre mendore dhe çdo fjalë e termizuar ose e përkufizuar përjeton ngritjen (miraxhin) e saj drejtë përpkyerjes.

Shembulli i Ibn Arabiut në krijimin dhe përkryerjen e terminologjisë së tesavvuffit ka shërbyer si ilustrim bazor në krijimin e terminologjisë mistike jo vetëm në suaza të shoqërive muslimane por edhe jashtë saj. Në veçanti tradicionalizmi dhe filozofia perenniale në trendet moderne tërë terminologjinë e saj e ka të bazuar në këtë përvojë metahistorike longitudale të Ibn Arabiut. Krijimi i terminologjisë islame në gjuhën shqipe në përgjithësi nga spektri i metodës së krijimit të termeve adekuate si një prej shembujve duhet të ketë parasysh edhe këtë metodologji të punës. Ndërsa për sa i përket lëmit të tesavvufit dhe krijimit të terminologjisë sufike në gjuhën shqipe Ibn Arabiu si kryeplaku i metodologjisë së tesavvufit dhe terminologjia e vendosur pas tij do të jenë pishtarë kryesor në sendërtimin real dhe objektiv të kësaj dëshire.

Rezyme

Problemi në vendosjen e terminologjisë fetare nuk mund të tejkalohet me kalimin tonë në rradhët moderne ose anti-moderne, e as me ballafaqimin e modernitetit me tradicionalen. Është e pashmangshme që në fillim duke mos e konsideruar konceptologjinë dhe frazeologjinë moderne si pol të kundërt të bëhet një vlerësim i gjendjes sonë të përgjithshme. Më pas, duke

vlerësuar dhe analizuar karakterin doktrinor dhe funksional të koncepteve islame të zhvillohet një terminologji e shëndoshë. Një terminologji fetare, që nëse jo sot në të ardhmen do të motivojë kulturën fetare ndër ne, nuk mund të jetë e përsosur nëse nuk ka kaluar nëpër sitën e arsyes dhe dijes së mirrëfilltë.

Mr. Elez ISMAILI

TERMINOLOGJIA ISLAME ËSHTË NGULITUR THELLË NË QENIEN E POPULLIT TONË

- bazuar më tepër në publikimet fetare islame në Maqedoni -

Sivjet u mbushën 20 vjet nga botimi komplet i përkthimit të Kur'anit në gjuhën shqipe, që paraqet një ngjarje të shënuar në rrafshin fetar e kulturor, por në të njëjtën kohë zë fill edhe botimi i veprave dhe revistave të mirëfillta me përmbajtje islame.¹ Kjo u arrit falë angazhimit të drejtpërdrejtë të Bashkësive islame në Kosovë, në Maqedoni e në Mal të Zi në realizimin e projekteve të këtilla madhore që edhe lexuesi shqiptar të ketë në duart e veta veprat më kapitale të proveniencës islame. Për dallim nga ato pak botime të mëhershme që kryesisht ishin ilmihe, në botimet e kësaj kohe norma e gjuhës së sotme letrare shqipe kishte marrë fizionominë e gjuhës së njësuar, dhe i përmbushte të gjitha kriteret që këto botime të jenë sa më të kapshme për lexuesin dhe të mund të përcillen mesazhet universale për të njohur Zotin, për të njohur vetveten dhe për t'u bërë zëdhënëse të ndërgjegjjes së pastër për një jetë sa më dinjitoze, edhe përkundër trysnive të shumta nga e gjithë ajo veprimtari botuese e veshur me petkun ideologjik të kohës.

¹ Kur'ani Fisnik, përkthim i Feti Mehdiut, Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës, Prishtinë 1985; Muhammed Hamidullah, Hyrje në Islam, Kryesia e Bashkësisë Islame e Maqedonisë, Shkup 1985; Jusuf Ramiq, Shkaqet e shpalljes së Kur'ani Kerimit, Lidhja e Shoqatave Ilmije e Bashkësisë Islame të Maqedonisë, Shkup 1990; Halid Muhamed Halid, Humaniteti i Muhammedit a.s., Lidhja e Shoqatave Ilmije në RSM-Shkup 1990/1411; Husein Gjozo, Islami në kohë, Biblioteka Ikre e Meshihatit të Bashkësisë Islame të Maqedonisë, Shkup 1994; Hëna e Re, Gazetë kulturore informative islame, Mexhlisi Shura i Bashkësisë Islame të Maqedonisë, Shkup 1987; Ikre, Revistë e Shoqatës së nxënësve të SHMI "Medreseja Isa Beu", Shkup 1993.

Terminologjia islame është mishëruar me qenien e popullit tonë, ashtu siç është mishëruar dhe bërë pjesë integrale e fjalorit të muslimanëve në mbarë botën, pa marrë parasysh gjuhën të cilën ata e flasin ose e shkruajnë. E veçanta e kësaj terminologjie në gjuhën shqipe është se i përket arealit gjuhësor mbarëshqiptar. Madje kjo terminologji haset edhe te disa popuj jomuslimanë, që ne i njohim, dhe se fjalët bereqet, selamet, kudret, hakikat, fukara, katil, xhahil, haram, hallall, mekteb, medrese, Xhennet, Xhehennem, ezan dhe sa e sa fjalë tjera janë begati (por jo edhe përherë të domosdoshme) që i kanë rënë hise edhe gjuhës sonë dhe se në krijimtarinë popullore hasen dendur dhe dihet se çfarë efektesh poetike e stilistike arrihet me to, madje kjo terminologji vihet në funksion të muzikalitetit të gjuhës poetike.

Në Maqedoni, si promotore e zbatimit të terminologjisë islame për disa vjet me rradhë ishte gazeta Hëna e Re, në kuadër të së cilës qenë angazhuar bashkëpunëtorë që kishin mbaruar Medresenë “Alaud-din” të Prishtinës, kurse studimet ose në Prishtinë, ose në botën arabe. Këtij grupi iu bashkangjiten edhe një plejadë studiuesish, publicistësh, gazetarësh etj. të cilët, krahas shkrimeve origjinale botuan një sërë shkrimesh të përkthyer nga boshnjakishtja e dikur edhe nga arabishtja. Në fillim të punës sonë, qoftë në kuadër të redaksisë së Hënës së Re apo me rastin e redaktimit dhe botimit të veprave me përmbajtje fetare, nuk hartuam ndonjë platformë se si do të shkruhen fjalët e kësaj provenience, por askush nga rrethi ynë nuk kishte qëndrim tjetër, nga ai që ne e konsideruam si më parimorin: që fjalët të jenë sa më afër origjinalit të arabishtes, dhe nuk është e tepërt të them se nuk ka gjë më banale kur dëgjon dikë të lexojë “arabisht” në formën e transkribuar e s’ka erë me arabishten. Hëna e Re, përveç karakterit informativ që kishte, pikësynim të veçantë pati përdorimin e një terminologjie fetare që do të qëndronte sa më afër origjinalit të gjuhës së Kur’anit, duke përdorur konstrukte që nuk kishin të bëjnë as me turqishten, as me persishten, as me boshnjakishten, e as me ndonjë gjuhë tjetër, sepse gjuha shqipe, për nga fondi i shkronjave që ka, është e zonja që më së miri se në cilëndo gjuhë tjetër të bëjë transkribimin e fjalëve të gjuhës arabe, pasi i kemi ca shkronja që gjuhët tjera nuk i kanë. Fjalën e kemi për shkronjat th dhe dh që te turqit dhe boshnjakët na dalin s dhe z dhe mund ta merni me mend se çfarë lajthitje gjuhësore do të ishte po t’i përdornin edhe në gjuhën shqipe.

Fatmirësisht, nisma e filluar nga redaksia e Hënës së Re u përkrah sidomos nga Shtëpia botuese Logos, pastaj shtëpitë tjera botuese, si Furkan,

NUN, ASR si dhe revistat Vepra, Ftesa, El-Medina, Ikre, Dritarja, që dalin në Shkup, Tetovë e Gostivar.

Nuk ishte vetëm dëshira jonë që në përdorimin e terminologjisë islame të jemi sa më afër arabishtes, por ishin edhe disa arsye tjera, siç ishte përdorimi i kësaj terminologjie me të njejtat tendenca edhe në disa gjuhë tjera, si në anglisht, frengjisht, gjermanisht etj. si dhe tradita e ndritshme e filluar që nga koha e Pavarësisë e deri në shuarjen e Mbretërisë Shqiptare. Sipas kësaj që u tha mund të konstatojmë se dëshira për të përdorur një terminologji islame që buron nga gjuha e Kur'anit, krahasimi i kësaj terminologjie me termat që përdoren në gjuhët perëndimore, tradita e krijuar në kohën e Mbretërisë dhe puna përkushtimore e figurave më të shquara të kësaj periudhe (Hafiz Ali Korça, Hafiz Ibrahim Dalliu, Behxhet Shapati, Hafiz Ismet Dibra, Ferit Vokopola, si dhe veprimtaria e bujshme e ish-medresantëve të Medresesë së Përgjithshme të Tiranës), pastaj përdorimi i shprehjeve frazeologjike me rastin e përkthimit të filmave të ndryshëm, veçanërisht filmat e përkthyer në Shqipëri, të cilën gjë ne e hetojmë shumë lehtë, por, në anën tjetër edhe përdorimi banal i kësaj terminologjie nga disa individë edhe atë në formën më të bastarduar (bile ka edhe arsye tjera që besoj se do t'i përmendë dikush tjetër) do të jenë shtytësit (indikatorët) kryesorë që na kanë detyruar të kërkojmë që sa kohë që të organizohet një tubim shkencor si ky i sotshmi, që të shtrohen me një taban të shëndoshë shkencorë, madje nga njerëzit që duhet të jenë më përgjegjës në këtë lëmi, sidomos ata që që një kohë të gjatë mirren me studimet islamologjike, orientalistike dhe që e njohin edhe shqipen, edhe arabishten. Tashmë mund të themi pa droje se është krijuar një bazë solide kuadrash që në fushën e gjuhësisë e kanë dëshmuar veten dhe mund t'u qasen të gjitha çështjeve të gjuhësisë së përgjithshme, por edhe të terminologjisë gjuhësore. Ky tubim ma merr mendja se është i pari i kësaj natyre në historinë e gjuhësisë dhe kulturologjisë shqiptare dhe rezultatet do të jenë evidente, por njëkohësisht do të jetë moment për të hapur shtigje të reja për njohjen e terminologjisë islame në të gjitha fushat e veprimtarisë mendore, siç është filozofia, mjekësia, poetika, oratoria, kaligrafia etj. Pra, përgjegjësia më e madhe bie mbi ne ish-medresantët që vazhdimisht jemi të lidhur ngushtë me këtë problematikë. Kemi të drejtë të mendojmë dhe të themi kështu sepse në punën tonë më se 20-vjeçare, për këto çështje ne kemi pasë nevojë të konsultohemi dhe jemi konsultuar me njohës të mirë të çështjeve gjuhësore e kulturologjike këtu në Prishtinë, në Tiranë, në Shkodër e në Shkup, disa

prej të cilëve janë deklaruar se kjo është një çështje mjaft e ndijshme por edhe sublime dhe nuk duan të mbajnë përgjegjësi në rradhë të parë shkencore, por kanë shprehur gatishmëri që të japin ndihmesën e tyre, ashtu siç kanë vepruar dhe veprojnë në jetësimin e normës së gjuhës së sotme letrare shqipe dhe radhitjen e gjuhës sonë në varganin e gjuhëve të standardizuara. Besoj se edhe konkluzat që do të dalin nga ky tubim do ta çojnë edhe më lartë këtë ngrehinë të vetëdijes sonë shoqërore, kombëtare e fetare dhe kisha pasur dëshirë që me kontributet tona shkencore të përcjellim mesazhin që i takon kohës në të cilën jetojmë, që të dëshmojmë pjekurinë tonë dhe të themi se kjo terminologji duhet të ketë atë formë që do të na afrojë sa më afër Zotit, po edhe të hiqen dilemat që na kanë rënduar edhe neve por edhe lexuesit e rëndomtë se si do të duhej të shkruhen shumë fjalë, që, bazuar në Fjalorin drejshkrimor, nuk ke alternativë tjetër dhe fjalët All-llah dhe Zot duhet t'i shkruash me a të vogël gjegjësisht me z të vogël që nuk besoj më të ketë gjuhë në botë të kishte parapëlqyer diç të këtillë. Me këtë rast ne duhet t'u bëjmë ballë edhe atyre tendencave retrograde pseudoshkencore kur dikush merr guximin që emrin e Pejgamberit tonë ta zbërthejë nga "muva" dhe "med". Me keqardhje më duhet të them se këso xhevahirësh kemi edhe nga autorët tanë: togfjalëshin Ibnul Kelb (personazh i dramës së Faik Konicës) një studiues yni e lidh me fjalën shqipe qelb, që s'ka të bëjë as për së afërmi me këtë fjalë. F. Konica, si njohës i mirë i arabishtes, e ka pasur lehtë ta merr këtë emërtim për të bërë individualizimin e personazhit në fjalë, sepse edhe në gjuhën shqipe e ka ekuivalentin e fjalëpërfjalshëm I biri i Qenit (kelb, arabisht do të thotë qen). Nuk e shoh të arsyeshme të zbërthej sajime të këtilla, por le të shërbejë vetëm si vërejtje për ata që me çdo kusht tentojnë që çdo huazim ta shqiptarizojnë, dhe pastaj ato fjalë na dalin me kuptime qesharake.

Në vazhdim, sipas një rendi alfabetik do të marr në shqyrtim fjalët që i hasim më së tepërmi, në rradhë të parë në literaturën islame, por edhe në publikimet e tjera. Fjalët që s'kanë asnjë shënim përcjellës i pranojmë në formën e dhënë dhe si të tilla propozojmë të përdoren.

* Fjala All-llah-u, sipas Drejtshkrimit duhet të shkruhet me a të vogël dhe pa teshdid (pa dyfishimin e llë-së). Që nga shkrimi i parë e gjer më sot, përfshirë edhe përkthimin e Kur'anit nga dr. Feti Mehdiu Prishtinë 1985, e kemi përdorur në formën All-llah. Kështu e hasim edhe në literaturën mes dy luftërave botërore. Kështu shkruhet edhe në gjuhët e tjera. Kjo duhet të jetë forma e vetme e pranueshme për përdorimin e drejtë të këtij emri. Por te

emrat e përbërë me origjinë arabe, si Bejtull-llah, Sejfull-llah, Hamidull-llah, Hajrull-llah etj. nistorja a rëgjohet. Këta emra në gjuhën shqipe a do të shkruhen me dy ll apo me një duhet të diskutohet dhe të dilet me një qëndrim konstant.

* Fjala abdes-i (pers.) Në fjalorët e deritashëm haset në format abdes, avdes, abdest.

* Ajet-i, -et. Për këtë fjalë besoj se nuk ka nevojë të përdoret fjala verset.

* Akide-ja

* Alejhisselam-i

* As'habe-t (të përdoret me apostrof)

* Asër - duhet t'i përmbahemi parimit fonetik sepse ndërmjet së-së dhe rë-së, hetohet një ë (jo e zëshme).

* Bismil-lahi (në lit. e hasim edhe Besmeleja)

* Bajram-i, -et. Gjatë vitit festojmë Fitër Bajramin dhe Kurban Bajramin. Kështu edhe duhet të jetë forma e drejtë e përdorimit të këtyre dy festave.²

* Da'i (fhirrës në fe)

* Da've – da'veja (thirrja e njerëzve në Islam); da'vet-i (ftesa e rëndomtë).

* Dua-ja (lutja drejtuar All-llahut)

* Dunja, -ja; dunjallëku. Forma popullore durnja të mos përdoret fare.

* Dovë-a, -ët (ka kuptimin e duave por edhe të sureve të shkurtëra)

* Dhikër-i (të kujtuarit e All-llahut). Forma popullore është zikër ose ziqër.

* Estagfirull-llah (lypja falje nga All-llahu)

* El-hamdulil-lah

² Propozoj që urimi i Bajramit të jetë E gëzofshi Bajramin, sepse është forma më e përhapur te ne dhe se kjo formë kishte qenë e përhapur edhe në Shqipëri, dikur (krahas Për shumë vjet Bajramin, Me fat Bajramin, Për hajr Mubareq Bajrami). Në kohën e sotme, institucionet dhe firmat e ndryshme, me rastin e kësaj feste, urimet që i japin përmes radios e televizionit i formulojnë kështu: Të gjithë besimtarëve muslimanë ua urojmë festën e Fitër Bajramit. Dihet se ithtarët e feve tjera nuk e festojnë Bajramin. Pra mund t'u urohet mbarë besimtarëve, miqve afaristë-kljentëve, nxënësve, studentëve etj. Përcaktori muslimanë është i tepërt.

* Farz-i, -et (origj. fard); veprim i detyrueshëm. Për hir të traditës që ka formuar kjo fjalë dhe përdorimit të shpeshtë në tekstet fetare, duhet të mbetet me z fundore.

* Fetva-ja, -të (mendim juridik për ndonjë çështje fetare). Në gjuhën popullore e hasim me f, fetfa.

* Fexhër-i (agu, sabahu).

* Fikh-u (shkenca që merret me jurisprudencën islame). Si nxënës këtë fjalë e shkruanin me apostrof-fik'h, por nuk ka nevojë. Edhe në boshnjakisht e turqisht përdoret pa apostrof.

* Gajb-i (sfera transcendentale e njohurisë). Gjithnjë duhet të shkruhet me j (si në origj.) e jo gaib.

* Gurbet. Kjo fjalë me origjinë arabe në Fjalorin drejtshkrimor ka formën kurbet. Nuk mund ta kuptoj pse i hiket origjinalit të arabshtes mbasi edhe turqisht, edhe në disa gjuhë tjera është me g .Madje edhe përftesat e kësaj fjale janë me g, p.sh. fjala garib; gurabaë etj.

* Gjunah (jo gjynah). Gjunahqarët.

* Hadith-i, -et (thëniet e Muhammedit a. s.). Në popull e hasim në formën me s, nga ndikimi i turqishtes. Vazhdimisht në shkrimet tona i jemi përmbajtur formës së origj. arabisht. Këtu shpesh gabohet në përcaktorët që i ndajvihen; nuk respektohet ndërrimi i gjinisë së përcaktorit pas emrit që e formon shumësin me e.

* Hallall-i, -et (ar. halal). Kuptimi i kësaj fjale është i njohur dhe haset shpesh në gjuhën e folur. Por kuptimi parësor është: gjithçka që All-llahu e ka lejuar. Ka individë që kanë studiuar në botën arabe dhe, duke dashur ta japin këtë fjalë në origjinal e shkruajnë halal, por nuk besoj edhe ta shqiptojnë me l.

* El hamdu lil-lah-i te disa autorë e hasim el Hamdu li-l-Lah (lypi falje për çdo fjalë që e marr për ilustrim, si formë të gabueshme, nëse është gabim shtypi. Shih Udhëzuesin përgatitor, f. 420) por mos bëjmë fjalë për formën e palejueshme elhamdurilah!

* Haram-i, -et, e kundërta e hallallit. Mund të haset si formë nëndialektore harëm, por në gjuhën e shkruar jo.

* Haxh-i (si shart i besimit islam) duhet përdorur me teshdid, kurse rrjedhojat e kësaj fjale si haxhi-u, haxhillëk-u, haxhilerë-t, haxhinjtë pa teshdid.

* Hixhreti (shpërngulja e Muhammedit a. s. nga Mekka në Medine; datënisja e kalendarit islam). E hasim hixhra e hexhira. Duhet të ruhet origjinali Hixhret-i, ashtu siç njihet në popull. Të shkruhet me H të madhe. Kur të shkruhet pas vitit miladi, si në shkrimet e mëhershme pas vitit të shënohet H (2005/1426H), si alternativë.

* Hafiz-i (arab. hafidh). Format hafës(z), hafus të mos përdoren.

* Halif-i (mëkëmbësi). Përdorimi i drejtë është me h e jo me k (kalif). Shumësi këtij emri të formohet me mbaresën ë të shumësit. Te togfjalëshat e tipit Hulefai rashidinë, të përdoret forma e shumësit të arabishtes hulefa-të. Ndërsa fjala hilafet-i të përdoret në kuptimin e fjalës mëkëmbësi-a.

* Hutbe-ja. E hasim edhe formën hydbe. Lexohet në vendin e veçantë të ngritur në xhami që quhet minber.

* Ibadet-i, -et.

* Islam-i. Kjo fjalë, si emër i përveçëm, të përdoret me i (nistore) të madhe (në kuptimin e Fesë Islame), kurse si përcaktor me të vogël: Pushteti islam, Besimi islam, Edukata islame, Legjislatura islame. Nëpër shkrime të ndryshme, në togfjalëshat e këtij tipi përcaktorin islam-e e hasim me të madhe, kurse fjalën drejtuese me të vogël. Si duket është nga ndikimi i përkthimeve nga boshnjakishtja, ku fjala Islamski, Islamska është fjalë drejtuese dhe shkruhet me të madhe. Poashtu edhe togfjalëshi Feja Islame, gjithnjë të shkruhet me të mëdha.

* Ikamet-i. Në gjuhën e folur e hasim formën kamet (thirrja që e bën muezini për të hyrë në namaz).

* Ikindi. Në popull por edhe në shkrime përdoret forma iqindi.

* Inshall-llah (in shae All-llahu). Në popull ishalla. Përkthimi i kësaj shprehje duhet të jetë: Në dashtë All-llahu ose Dashtë All-llahu!

* Ixhtihad-i (hulumtimi). Muxhtehid-i, -ët.

* Kada-ja (eda dhe kaza) - shpagimi i borxhit. Falja e namazit në kohë dhe pas kohës së përcaktuar.

* Kible-ja. E hasim edhe këblja. Si shprehje frazeologjike njeri pa këble: i pacipë, i sorollatur.

* Kijamet-i (në kuptimin e Ditës së Gjykimit). Të përdoret me të madhe.

* Magrib-i-perëndimi. Togfjalëshi Vendet e Magrebit, duhet të përdoret me i e jo me e.

* Mashall-llah (arab. ma shae All-llahu: Si ka dashur All-llahu). Forma popullore marshallah të hiqet nga përdorimi.

* Medrese. Medresja apo medreseja, për t'u diskutuar. Medreze-jo.

* Medhheb-i, -et (shkollat juridike sipas fikhut). Kjo fjalë këto dy dhjetëvjetëshat e fundit është përdorur me dh, përkundër formale tradicionale mes-heb, mes-hep, mez-heb.

* Mesxhid. Te ne përdoret në kuptimin e xhamisë. Forma e gabueshme mezxhid.

* Mihrab-i, -et

* Minber-i, -et

* Mu'min-i, -ët (besimtarët)

* Musliman-ët. Të flaket forma me y,që është nën ndikimin e turqishtes dhe që bie në sy më së tepërmi.

* Musned-i, -et (libër hadithi i përpiluar nga Imam Ahmed ibën Hanbeli).

* Muezin-ët

* Namaz-i, -et (sharti i dytë i besimit islam). Fjalë me prejardhje turke ose persiane. Arab. -salat-i.

* Nasihat-i, -et (këshillat)

* Nijet-i, -et (qëllimet). Origj. arabisht është me teshdid: nijjetun.

* Pejgamber-i,-ët (pers.). Duhet të ketë përparësi absolute ndaj sinonimeve tjera, qoftë të gjuhës shqipe apo të gjuhëve tjera.

* Qafir (arab. kafir, femohues). Forma e shumësit qufarët të përdoret vetëm për shumës e jo qufar-i.

* Radijall-llahu anhu (All-llahu qoftë i kënaqur me të). Shkurtesa r.a.

* Rekat (pjesë e namazit). Haset edhe me q reqat.

* Rizk-u (furnizimi). E hasim edhe me s risku si dhe në formën rëzku ose rësku.

* Sabër-i (durimi). Por jo sabr.

* Sadaka-ja (dhënia sadaka, për bamirësi). E hasim edhe formën sadakë-sadaka. (E ka shpëtuar sadaka).

* Sahih-u, -ët (librat më autentikë të hadithit).

* Selamun alejkum (Paqja e All-llahut qoftë mbi ju). Forma më e drejtë: Esselamu alejkum. Format tradicionale të gabueshme selam aliqim dhe selam alejqym. (Te Udhëzuesi përgatitor, f. 290: Es-Selamu alejkum).

* Sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem. Shkurtesa: s. a. v. s. (Shpëtimi dhe paqja e All-llahut qofshin mbi të). Shkurtesa të shkruhet me shkronja të vogla dhe jo, siç haset, s. a. v. (Shih: Udhëzues..., f. 422).

* Sunnet-i, -et (dhe jo sinetet e as synetet). Tradita e M. a. s., por suneti-a pa teshdid.

* Shehadeti (dëshmia se nuk ka zot tjetër, pos All-llahut xh. sh. dhe se Muhammedi a. s. është Pejgamber i Tij. Forma e papranueshme shadeti.

* Shejh (Shejhul Az-her apo Az-har). Titull udhëheqësi fetar por edhe t. akademik.

* Sheriati (ose Sheri'ati... për ta theksuar ajnin).

* Shura-ja (Mexhlisi Shura, Shuraja Evroaziatike). Këshillim i ndërsjellë.

* Taharet-i (pastërtia). Format e gabueshme: tareti dhe tehareti që hasen në popull. Është mirë që të futet në përdorim, analogjikisht me shprehjet merr abdes, merr gusëll edhe shprehja merr taharet ose merr teharet, me atë kuptim që njihet në popull.

* Teravi-a, -të. Namazi që falet gjatë netëve të Ramazanit. Jo: taravi-të. Forma më e plotë është: teraviih namaz-i.

* Tesbih (i bën tesbih All-llahut, e lavdëron). Ndërsa tespihët të përdoret me p.

* Tevhid-i (Njëjësia e All-llahut). E hasim të shkruar edhe me dubël v(w), që duhet të jetë një tingull ndërmjet vavit dhe u-së.

* Ulema-ja, -të (dijetarë-t).

* Ummet-i, -et. Në literaturën islame përdoret për ithtarët e Islamit. Por përdoret edhe në kuptimin popull (ummetet e mëhershme).

* Vahj-i, -et (Shpallja hyjnore, Kur'ani).

* Vakëf (ar. vakf - pronë e destinuar për xhaminë dhe institucionet e tjera fetare).

* Xhahilij(j)eti (Periudha paraislamike, p. e injorancës). Në shkrimet e paraluftës e hasim edhe me j të dyfishuar.

* Xhehennem (ferri). Të shkruhet me shkronjë të madhe nistore dhe me n të dyfishuar.

* Xhema(a)t (grup njerëzish) em. përmbledhës.

* Xhennet (parajsë, kopsht).

* Xhihad-i (vetëflijimi për hir të All-llahut).

* Zekat-i, -et (ndarja e obligueshme e një pjese të pasurisë atyre që u takon). Dy dhjetëvjetshat e fundit forma me k ka pasur përdorim më të madh, edhe pse në popull mund ta dëgjosh vetëm me q.

* Zot-i. Ky emër në Fjalorin drejtshkrimor nuk figuron fare, edhe sikur të ishte do ta kishim me z të vogël.

* Zotni-a.

* Zotrote. Tf. Zoti Filani sa të ketë mundësi të hiqet nga përdorimi. Gjuhësisht nuk ka kurrfarë pengesash por në aspektin fetar është shprehje mjaft irituese.

PËRFUNDIM

Në një tubim si ky i sotmi është e pamundshme që të shqyrtohen të gjitha çështjet që i takojnë kësaj sfere, por ato më qenësoret ishte e pamundur të anashkalohen. Le të më lejohet të propozoj që t'u sugjerohet institucioneve relevante arsimore e shkencore që urgjentisht fjalët për të cilat u bisedua sot të përdoren në formën e drejtë, kurse masmediat nëse në shtëpitë e tyre informative nuk kanë njerëz që e dinë sadopak arabishten, bile le të konsultohen me institucionet fetare, ku përdoren format e kristalizuara të kësaj terminologjie. Merrnie me mend emrin e qytetit Qerbela-ja, ta dëgjosh Karballa e sa e sa emra tjerë që na servirin në formën angleze, është gjë e padurueshme. Pastaj sot të shqiptosh dhe të shkruash Omer Khajami ose Kajami (duhet Hajami) dhe Imam Komeini ose Khomeini (duhet Homeini), ambasadori Khaled (ar. Halid), madje emrin e përveçëm Muhammed e hasim si Mohamed, Mohammad, këto trajta për ne janë të papranueshme dhe nuk i kanë hije gjuhës sonë.

Këtë kumtesë do ta përfundoj me një konstatim që është me interes për këtë tubim. Në Maqedoni pothuajse kanë ngelur pak hoxhallarë pleq të cilët në vazet e tyre vazhdojnë në të folmen popullore. Kurse që nga gjenerata e parë e nxënësve të Medresesë së këtushme, madje edhe ish-nxënësit e Medresesë "Isa Beu" vazet e tyre i mbajnë ekskluzivisht në

gjuhën letrare,edhe pse nga xhemati në moshë nuk kuptohen sa duhet.Ky konstatim na jepë të drejtë të themi se në predikimet fetare,si në Maqedoni po edhe në Kosovë,nuk kemi dukurinë e diglosisë ose bilinguizmit, pra të përdorimit paralel të gjuhës letrare dhe të asaj sakrale. Ky sukses është arritur në sajë të punës konsekuente të mësimdhënësve të medreseve dhe fakulteteve tona islame në mbëltimin e normës së sotme letrare shqipe.

Le të më lejohet që në frymën e këtij tubimi të shpreh mirënjohjet më të thella institucioneve bartëse të kësaj Tryeze të rrumbullakët, Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës dhe Bashkësisë Islame të Kosovës, përfaqësuesit eminentë të këtyre institucioneve që na nderuan edhe neve edhe institucionet që përfaqsojnë dhe, dashtë All-llahu, që ky takim të jetë një ndihmesë për promovimin dhe pasurimin e thesarit leksikor të shqipes me terminologji të pastër islame.

Mr. Elez ISMAILI

Medreseja “Isa Beu” Shkup

TERMINOLOGJIA ISLAME NË MEVLUDIN

E HAFIZ IBRAHIM DALLIUT

All-llahu f. 3

Resulull-llahu Alejhisselam

Muhammedi

Bismil-lahi’rr-rrah’mani’rr-rrahim

Dhylxhelal (duhet: Dhulxhelal) f. 6

Elhamdu lil-lah

Bismil-lah

La ilahe il-lall-llah

Rabbyl aalemin

Xhennet-Xhehnem

Hajjyl kajjum

Zoti f. 7

Kiamet

Kur-anin e All-llahut

Meqqe f. 9

Qabe-ja

Bejtull-llah f. 10

Kur leu Resuli

Abdyl Myttalibi

Abdyl Abdull-llah

Alijjylmurtezas f. 11

Abbas Amine (e ëma e Resulull-llahut)

Rexheb (muaj i vitit) f. 12

Regaib

Rebiul-evvel f. 13

Rahmeten lil alemin

Qevtheri (kupt. ar. Shumica) f. 14

Meqqasit

Ell-llahumme sal-li aala sejjidina Muhammedinin nebijjil ymmijji ve aala alihi ve sahbihi ve sel-lim.

Idhullatrinë f. 19

Xhehalet

Hadixhe f. 23

Ebylkasim (Babai i Kasimit, Pejgamberi a.s.)

Haxherul-Esvedi f. 24

El-emini

Xhebrail f. 25

Xhibrili

Qyfri (për qufër, kufër) f. 29

Kur-ani Qerim f. 30

Ahdi Kadim, Ahdi Xhedid (Tevrati e Ungjilli; Dhjata e Vjetër dhe Dhjata e Re)

Ebu Beqri, Bilali Habeshi f. 31

Xhybe f. 32

....n'fen Islame f. 38

teqbir (për tekbir) f. 40

Abisini, Habesh f. 43
Mesxhidi Aksa f. 53
Sidrei Mynteha f. 56
Ymmeti f. 57
Kudus
Pejgamberi Alejhisselam f. 59
Qole-qolja f. 72
Bylyzykët e Qisraes f. 73
Kurr-rra (lexues Kur'ani) f. 77
Myrshid
Muhaxhirët dhe Ensarët f. 78
Abdyrr-rrahman bin Aufi f. 79
Kan falë Bajram f. 94
Mysibet f. 101
Dignitetin e grues Islame f. 121
Hydejbije f. 124
Ahiret f. 126
All-llahu azze ve xhel f. 129
Rahman e Rahim f. 136
Zot f. 150
Sejfull-llah (Halid bin Velidi) f. 151
Haxhillarët f. 153
Xhidde-ja f. 156
Lufta e Tebuqit f. 169
Haxh-xhetylvedai f. 182

HAFIZ IBRAHIM DALLIU, E LEMJA E TË MADHIT PROFIT DHE JETA E TIJ, Shtypur në Shtypshkronjën “SHKODRA” në Tiranë më 1934.

SHËNIM: Terminologjia islame në Mevludin e H.I. Dalliut dhe në Fjalorin drejtshkrimor po ua dërgoj si materiale krahasuese për të vërtetuar tezat e paraqitura në kumtesën time.

LITERATURA E KONSULTUAR

- Kur'ani Fisnik (përkthim i Feti Mehdiut), Kryesia e Bashkësisë Islame, Prishtinë 1985.
- Gjendja e terminologjisë shqipe në Jugosllavi, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë 1988.
- Rexhep Ismajli, Gjuhë standarde dhe histori identitetesh, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë 2005.
- Fjalori drejtshkrimor i gjuhës shqipe, Rilindja, Prishtinë 1983 (32000 fjalë).
- Dr. Ismail Ahmedi, Hafiz Ali Korça-Jeta dhe vepra, Logos-A , Shkup 1419/1999.
- Dr. Ismail Bardhi, Hafiz Ibrahim Dalliu dhe ekzegjeza e tij kur'anore, Logos-A, Shkup 1419/1998.
- Haki Sharofi dhe vepra e tij, botim i AIITC, Tiranë 2000.
- Isak Ibishi, Ibadetet sipas Fikhut hanefi, Oslo 1998.
- Hadithe të zgjedhura të Pejgamberit a.s., Sh. B. Çabej, Tetovë 2004.
- Udhëzues përgatitor për punonjësit islamikë (Hisham Et-Talib), Logos-A, Shkup 1419/1998.

TERMINOLOGJIA ISLAME

Botues

AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS
FAKULTETI I STUDIMEVE ISLAME

Lektor:

Sheremet Krasniqi

Redaktor teknik:

Valon Fetahu

Realizimi kompjuterik:

ASHAK

Madhësia: 10 tabakë shtypi

Tirazhi: 300 copë

Formati: 17x24 cm

Shtypi:

“ADNAN R Co”

Prishtinë

Katalogimi në publikim - (CIP)

Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës

297.001.4 (063)

Tryezë shkencore Terminologjia Islame. 2005. Prishtinë
Terminologjia Islame (Tryezë shkencore - Prishtinë,
nëntor, 2005) / Këshilli organizues Ekrem Murtezai ... [et
al]- Prishtinë : Akademia e Shkencave dhe e Arteve e
Kosovës, Fakulteti i Shkencave Islame, 2006 (Prishtinë :
Shtypshkronja “Adnan R. Co”).- 154 f. : ilustr. ; 24 cm.

1. Terminologjia Islame

2. Murtezai, Ekrem

ISBN 9951-413-39-0